



Udhëzues për vëzhgimin dhe promovimin e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje



UDHËZUES PËR VËZHGIMIN DHE PROMOVIMIN E PJESËMARRJES SË GRAVE NË ZGJEDHJE




Ky dokument është botuar fillimisht nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut në gjuhën angleze, në vitin 2023, me titullin “Handbook on Observing and Promoting Women’s Electoral Participation”. Versioni në gjuhën shqipe është përkthim i përgatitur dhe i botuar në kuadër të Projektit “Mbështetje për reformat zgjedhore në Ballkanin Perëndimor”, me financim të Bashkimit Evropian dhe të Agjencisë Austriake për Zhvillim. Në rast mospërputhjes, jeni të lutur t’i referoheni versionit origjinal në anglisht. Për më shumë informacion rreth këtij projekti dhe për të hyrë në bibliotekën e tij, jeni të lutur të vizitoni: <http://www.osce.org/odih/wb>



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Me financim nga  Austrian
Development
Agency



Udhëzues për Vëzhgimin dhe Promovimin e Pjesëmarrjes së Grave në Zgjedhje

Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
(ODIHR)
UL. Miodowa 10
00-557 Warsaw
Poland

www.osce.org/odih/wb

© OSCE/ODIHR 2023

ISBN 978-92-9271-178-8

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe kopjohet lirisht për qëllime edukative dhe qëllime të tjera jotregtare, me kusht që një riprodhim i tillë të shoqërohet me një shënim, ku të thuhet se burimi është ODIHR-i.

Formulimi grafik nga Filip Andronik
Kapaku nga Filip Andronik



PASQYRA E LËNDËS

Hyrje	9
A. Qëllimi i këtij manuali	9
B. Si ta përdorim manualin	11
Kapitulli 1 Angazhimet përkatëse të OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare	13
A. Angazhimet e OSBE-së	13
B. Detyrimet dhe standardet ndërkombëtare	16
C. Detyrimet dhe standardet rajonale	20
D. Instrumente të tjera ndërkombëtare	23
Kapitulli 2 Fushat e fokusit të aktiviteteve të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve	25
A. Konteksti	25
B. Kuadri Ligjor	29
C. Sistemet zgjedhore dhe elementet që lidhen me to	32
D. Administrata zgjedhore	39
E. Regjistrimi i votuesve	42
F. Caktimi dhe regjistrimi i kandidatëve	45
G. Fushata	50
H. Financimi i fushatës	54

I. Media	58
J. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve zgjedhore	61
K. Dita e zgjedhjeve	63
Kapitulli 3 Dhuna ndaj grave në zgjedhje	67
Kapitulli 4 Pjesëmarrja e grupeve Më pak të përfaqësuara	74
Kapitulli 5 Roli i misioneve dhe vëzhguesve të ODIHR-it	81
A. Misionet e vlerësimit të nevojave	81
B. Aktivitetet për vëzhgimin e zgjedhjeve	86
C. Hartimi i rekomandimeve duke pasur parasysh barazinë gjinore	92
D. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet nga këndvështrimi gjinor	93
SHTOJCA A Standarde Ndërkombëtare të Përzgjedhura	96
SHTOJCA B Burime të dobishme shtesë	104

PARATHËNIE

Pjesëmarrja e ekuilibruar e grave dhe e burrave në procesin parazgjedhor dhe atë zgjedhor është kusht thelbësor për shoqëritë që kanë në themel drejtësinë dhe demokracinë. Respektimi i të drejtës së votës dhe zgjedhjes në funksione politike apo publike që kanë shtetasit, pa u diskriminuar për shkak të gjinisë, është një angazhim që e kanë marrë prej kohësh shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së; përmbushja e këtij angazhimi presupozon zbatimin e detyrimeve dhe standardeve ekzistuese, si dhe mbështetjen e politikave për arritjen e barazisë. Megjithatë, edhe pse ka pasur rritje të konsiderueshme të përqindjes së grave në postet e zgjedhura - mesatarisht 25 për qind e mandateve parlamentare në mbarë botën dhe 26.1 për qind në rajonin e OSBE-së – kjo është larg objektivit prej 30 për qind që parashikohet në Deklaratën e Pekinit.¹

Në nivel ndërkombëtar, ekziston një numër instrumentesh detyruese ligjore dhe mjetesh të tjera në ndihmë të juridiksioneve në përpjekje për të rritur pjesëmarrjen e grave në zgjedhje, përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre si votuese, si kandidatë dhe si përfaqësuese të organeve të administrimit të zgjedhjeve. Ndër to vlen të përmendet Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDNG), e cila kërkon nga shtetet palë që “të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit”, përfshirë edhe përmes miratimit të masave të përkohshme të veçanta, të cilat duhet të ndërpriten kur të jenë arritur objektivat e barazisë së mundësive dhe të trajtimit.

1 Shih faqen e internetit të Unionit Ndërparlamentar (vizituar për herë të fundit më datë 19 shtator 2022), mesatarja botërore për vitin 2019, <<http://archive.ipu.org/wmn-e/world.htm>>.

Ndërkohë, mund të mos mjaftojë thjesht adresimi i çështjeve të barazisë mes grave dhe burrave vetëm përmes kanaleve ligjore (*de jure*), por mund të kërkohet edhe marrja e masave të tjera praktike për përmirësimin e situatës *de facto*. Meqenëse përfshirja në zgjedhje është një nga rrugët kryesore për hyrjen e grave në politikë, është e rëndësishme të kujdesemi që në të gjitha proceset zgjedhore të merren parasysh si duhet nevojat e këtij grupi më pak të përfaqësuar. Kjo vlen për sistemin zgjedhor që zgjidhet të përdoret, për procedurat e regjistrimit të zgjedhësve dhe të kandidatëve, për përbërjen e administratës zgjedhore, për rregullat dhe praktikat e fushatës, si dhe për financimet, modalitetet e votimit dhe aspektet e tjera që lidhen me to.

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) ka hartuar një metodologji sistematike dhe gjithëpërfshirëse për vëzhgimin e zgjedhjeve. Megjithëse, që nga botimi i udhëzuesit të parë në vitin 2004, në metodologjinë e ODIHR-it për vlerësimin e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje nuk ka pasur ndryshime të mëdha, ky botim i dytë bazohet te përvoja e fituar përgjatë tri dekadave të vëzhgimit të përfshirjes së grave në proceset zgjedhore. Në këtë udhëzues merret parasysh edhe *acquis*-ja në lidhje me barazinë gjinore, vështirësitë lidhur me vëzhgimin në këtë fushë tematike, si dhe përpjekjet e ODIHR-it, në përgjithësi, për promovimin e pjesëmarrjes së grave në jetën publike. Në këtë udhëzues shqyrtohen disa fusha të reja ku mund të fokusohen vëzhguesit e ODIHR-it, të tilla si: gjithëpërfshirja e personave me aftësi të kufizuara, pakicave kombëtare dhe të rinjve, sfidat sa i takon financimit të fushatave zgjedhore dhe diskriminimi ose dhuna ndaj kandidateve gra, përfshirë edhe në rrjetet sociale.

Unë kam besim se ky udhëzues do të shërbejë për përmirësimin më tej të metodologjisë sonë të vëzhgimit të zgjedhjeve dhe, përfundimisht, për avancimin e të drejtave të grave si zgjedhëse, si kandidate dhe si anëtare të administratave zgjedhore. ODIHR-i vlerëson kontributin e rëndësishëm të të gjithë ekspertëve dhe organizatave, që kanë ofruar opinione vlerësuese në faza të ndryshme të hartimit të këtij udhëzuesi.

Matteo Mecacci
Drejtore i ODIHR-it

LISTA E SHKURTESAVE

MAV	Metodë alternative e votimit
KZD	Këshilli për Zgjedhje Demokratike
KEDNG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KSHP	Komënuelthi i Shteteve të Pavarura
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
OSHC	Organizatë e shoqërisë civile
EK	Ekipi kryesor i vëzhgimit
ZSHM	Zëvendëshefi i misionit
DeP	Deklarata e Parimeve
MVLZ	Misioni i vlerësimit të zgjedhjeve
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
ZMZ	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve zgjedhore
EVZ	Ekipi i vëzhgimit të zgjedhjeve
OAZ	Organet e administrimit të zgjedhjeve
AVZ	Aktivitetet për vëzhgimin e zgjedhjeve
MVZ	Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve

KKMPK	Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
PNDPCP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
PZHBV	Person i zhvendosur brenda vendit
IFES	Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore
UNP	Unioni Ndërparlamentar
VAGJ	Vëzhgues afatgjatë
MVN	Misioni i vlerësimit të nevojave
IKD	Instituti Kombëtar Demokratik
OJQ	Organizatë joqeveritare
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SHP	Shtet pjesëmarrës i OSBE-së
OZHQ	Objektivë e zhvillimit të qëndrueshëm
VASH	Vëzhgues afatshkurtër
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
KDNJ	Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
DHNGZ	Dhuna ndaj grave në zgjedhje

HYRJE

A. QËLLIMI I KËTIJ MANUALI

Në kuadër të metodologjisë së përgjithshme për vëzhgimin e zgjedhjeve, në botimin e dytë të Udhëzuesit për Vëzhgimin dhe Promovimin e Pjesëmarrjes së Grave në Zgjedhje, që bazohet në botimin e parë të vitit 2004, shtjellohet më tej metodologjia e ODIHR-it për vlerësimin dhe dhënien e rekomandimeve për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje. Përveçse ofron udhëzime për aktivitetet e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve (AVZ-të), ky manual mund të ndihmojë edhe në informimin e shteteve pjesëmarrëse – organeve të tyre të administrimit të zgjedhjeve, partive politike, zgjedhësve, kandidatëve, mediave dhe shoqërisë civile – në lidhje me angazhimet e OSBE-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe me praktikën e mira për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje. Ai bazohet në përvojën e fituar gjatë pothuajse tri dekadave të vëzhgimit të zgjedhjeve dhe në të merren parasysh aktivitetet e shteteve pjesëmarrëse dhe të ODIHR-it për të promovuar pjesëmarrjen e grave në jetën politike, përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje.²

ODIHR-i është i përkushtuar të rishikojë dhe të përsosë rregullisht metodologjinë e tij të vëzhgimit të zgjedhjeve, në përputhje me detyrat e shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së.³ Në këtë botim të ri merren parasysh

- 2 Shih, për shembull, raportimin nga konferenca rajonale e ODIHR-it, e vitit 2019, me temë “Adresimi i rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet nga perspektiva gjinore”, Sarajevë, 10 tetor 2019, <<https://www.osce.org/odihr/elections/435158>>, pjesë e Projektit të ODIHR-it mbi Mbështetjen e Zgjedhjeve në Ballkanin Perëndimor, <<https://www.osce.org/odihr/support-to-elections-in-western-balkans>>.
- 3 Siç u la detyrë nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së (Vendimi i Këshillit Ministror 19/06), ky botim u bë i mundur me kontributet jashtëbuxhetore të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së.

çështje të reja, si dhe standardet e reja dhe praktikat e mira.⁴ Ndër to përfshihen edhe zhvillimet në lidhje me grupet më pak të përfaqësuara politikisht (përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, pakicat kombëtare dhe të rinjtë), financimi i fushatave, dhuna ndaj grave në zgjedhje (DHNGZ), metodat alternative të votimit dhe ndikimi i mediave elektronike dhe i rrjeteve sociale.⁵ Përveç kësaj, ka një fokus të shtuar në çështjet që duhen parë gjatë misionëve të ODIHR-it për vlerësimin e nevojave (MVN-ve), të cilat rekomandojnë si llojin e aktivitetit të vëzhgimit të zgjedhjeve, ashtu edhe aktivitetet që duhet të zhvillohen më pas për të mbështetur zbatimin e rekomandimeve të vëzhgimit të zgjedhjeve.

Ky manual vazhdon në të njëjtën linjë me botimin e parë, duke u fokusuar te pjesëmarrja e grave në zgjedhje, sepse gratë vazhdojnë të jenë më pak të përfaqësuara në proceset zgjedhore në të gjithë rajonin e OSBE-së dhe instrumente të ndryshme ndërkombëtare (shih kapitullin vijues) përmbajnë dispozita të qarta për përmirësimin e situatës. Si pjesë e çështjeve më të gjera që lidhen me gjithëpërfshirjen e proceseve zgjedhore, në manual trajtohen edhe disa aspekte të tjera të kategorizimit gjinor, të tilla si: identiteti gjinor dhe diversiteti gjinor, ndonëse në mënyrë joshteruese.⁶

4 Përfshirë angazhimet e fundit të OSBE-së, si Vendimet e Këshillit Ministror të OSBE-së mbi pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe publike (Athinë, 2009), <<https://www.osce.org/mc/40710>>, mbi sigurinë e gazetarëve (Romë, 2018), <<https://www.osce.org/Chairmanship/406538>>, mbi parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave (Romë, 2018), <<https://www.osce.org/Chairmanship/406019>>.

5 Disa zhvillime janë përfshirë edhe në botime të tjera të ODIHR-it. Për shembull, tek “Manuali për vëzhgimin e financimit të fushatave”, 21 janar 2015, <<https://www.osce.org/odihr/elections/135516>>, “Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve zgjedhore”, 6 qershor 2016, <<https://www.osce.org/odihr/elections/244941>>, “Udhëzime për ofruesit e sigurisë publike në zgjedhje”, 12 shtator 2017, <<https://www.osce.org/odihr/elections/339581>> dhe “Udhëzues për vëzhgimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore”, 17 shtator 2019, <<https://www.osce.org/odihr/elections/429566>>, i kushtohet vëmendje e veçantë monitorimit të çështjeve gjinore përmes kapitujve të posaçëm mbi pjesëmarrjen e grave. Shih edhe Paketën e ardhshme të Instrumenteve të ODIHR-it kundër Dhunës ndaj Grave në Politikë, e vitit 2022.

6 Sipas Fjalorthit të OSBE-së mbi termat që kanë të bëjnë me gjininë, <<https://www.osce.org/gender/26397>>, “Gjinia është një term që përdoret për të përshkruar rolet e ndërtuara në shoqëri për gratë dhe burrat. Gjinia është një identitet i fituar që mësohet, ndryshon me kalimin e kohës dhe ndryshon gjerësisht brendapërbrenda kulturave dhe nga një kulturë në tjetrën.”

B. SI TA PËRDORIM MANUALIN

Ky manual është hartuar si një mjet pune kryesisht për të ndihmuar OAZ-të e ODIHR-it në vlerësimin e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje, në hartimin e rekomandimeve për përmirësimin e përfaqësimit të tyre dhe në promovimin e barazisë gjinore.⁷ Në të përfshihen pikëpyetje lidhur me aspekte të ndryshme të pjesëmarrjes së grave në procesin zgjedhor. Listat e çështjeve që duhet të analizohen nga një AVZ janë treguese dhe vënë në dukje disa nga fushat, që mund të shqyrtohen, dhe do të aplikohen në mënyra të ndryshme duke iu përshtatur kontekstit specifik. Këto lista nuk janë shteruese dhe nuk duhet t'i pengojnë AVZ-të që të shqyrtojnë edhe të tjera çështje që mund të lindin.

Në Kapitullin 1 jepet një përmbledhje e angazhimeve të OSBE-së dhe e detyrimeve dhe standardeve të tjera ndërkombëtare dhe rajonale, përfshirë edhe Konventës së OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDNG). Në Kapitullin 2 trajtohen vështirësitë që mund të dalin lidhur me pjesëmarrjen e grave në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Këtu përfshihet kuadri ligjor dhe sistemi zgjedhor, administrata zgjedhore, regjistrimi i zgjedhësve dhe i kandidatëve, mekanizmat e votimit, fushatat dhe financimi i tyre, media, zgjidhja e mosmarrëveshjeve zgjedhore (ZMZ) dhe procedurat në ditën e zgjedhjeve.

Në Kapitullin 3 trajtohet dhuna ndaj grave në zgjedhje. Në Kapitullin 4 shqyrtohet gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja e grave nga grupet më pak të përfaqësuara, përfshirë edhe gratë me aftësi të kufizuara, të rinjtë dhe pakicat, duke trajtuar edhe disa aspekte të identitetit gjinor.

Në Kapitullin 5 trajtohen MVN-të, të cilat përcaktojnë qëllimin dhe formatin e aktiviteteve të vëzhgimit të zgjedhjeve, si dhe rolet e vëzhguesve afatgjatë dhe afatshkurtër (VAGJ-ve dhe VASH-ve), dhe hartimin e rekomandimeve në lidhje me çështjet gjinore. Aty shtjellohen

7 Në Deklaratën e Parimeve (DeP) për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve, të vitit 2005, <<https://www.osce.org/odihr/elections/215556>>, thuhet se vëzhguesit kanë përgjegjësinë të "shqyrtojnë diskriminimin ose pengesat e tjera që mund të pengojnë pjesëmarrjen në proceset zgjedhore."

gjithashtu edhe aktivitetet paszgjedhore për të mbështetur vendet në marrjen e masave lidhur me vlerësimet e zgjedhjeve dhe zbatimin e rekomandimeve të ODIHR-it nga perspektiva gjinore. Te shtojcat japen pjesë të shkëputura nga instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe rajonale, që lidhen me barazinë gjinore, si dhe një përmbledhje e burimeve të dobishme.



KAPITULLI 1

ANGAZHIMET PËRKATËSE TË OSBE-SË DHE DETYRIMET DHE STANDARDET E TJERA NDËRKOMBËTARE

A. ANGAZHIMET E OSBE-SË

Brendapërbrenda zonës së OSBE-së, angazhimet për akses të barabartë në të drejtat politike janë të përfshira kryesisht në Dokumentin e Kopenhagenit, të vitit 1990.⁸ Në paragrafin 5.9 në veçanti, shtetet pjesëmarrëse angazhohen «të ndalojnë çdo diskriminim dhe për të gjithë njerëzit të garantojnë mbrojtje të barabartë dhe efektive nga diskriminimi për çfarëdo shkak». Në paragrafin 7.5, shtetet pjesëmarrëse angazhohen se “do të respektojnë të drejtën e qytetarëve për të synuar funksione politike ose publike pa u diskriminuar, qoftë si individë ose si përfaqësues të partive apo organizatave politike”. Në përgjithësi, në paragrafin 40, shtetet pjesëmarrëse “dënojnë në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje [...] diskriminimin ndaj kujtdo...”. Në këtë kontekst, ato “njojnë të drejtën e individit për zgjidhje juridike efektive dhe përpiqen të njojnë, në përputhje me legjislacionin vendës, të drejtën e personave dhe grupeve të interesuara për të iniciuar dhe për të mbështetur ankesat ndaj akteve të diskriminimit” (40.5).

Më tej në Dokumentin e Kopenhagenit u bëhet thirrje shteteve pjesëmarrëse që, nëse nuk e kanë bërë ende, të marrin në shqyrtim

8 Dokumenti i Takimit të Kopenhagenit i Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të OSBE-së, i vitit 1990. Teksti i këtij dokumenti dhe i dokumenteve të tjera të OSBE-së gjenden në faqen e internetit të ODIHR-it: <www.osce.org/odihr>.

“aderimin në instrumentet ndërkombëtare që trajtojnë problemin e diskriminimit dhe të marrin masa për përmbushjen e plotë të detyrimeve të parashikuara në to, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me paraqitjen e raporteve periodike” (40.6), si dhe të pranojnë «ato mekanizma ndërkombëtare që u lejojnë shteteve dhe individëve që t’i dërgojnë komunikimet në lidhje me diskriminimin në organet ndërkombëtare” (40.7).

Angazhimet e OSBE-së për barazinë mes grave dhe burrave janë gjithashtu të përfshira edhe në Dokumentin e Moskës, të vitit 1991, dhe në Kartën për Sigurinë Evropiane, të vitit 1999, dhe në të dy këto dokumente shtetet pjesëmarrëse angazhohen që të promovojnë barazinë mes grave dhe burrave në të gjitha nivelet.⁹ Në paragrafin 40 të Dokumentit të Moskës, shtetet pjesëmarrëse ftohen që të pranojnë se “barazia e plotë dhe e vërtetë ndërmjet burrave dhe grave është aspekt themelor i një shoqërie të drejtë dhe demokratike, që bazohet tek sundimi i ligjit”.¹⁰ Në të, shtetet pjesëmarrëse gjithashtu ftohen që të zbatojnë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDNG). Më tej, në paragrafin 23 të Kartës për Sigurinë Evropiane, shtetet pjesëmarrëse angazhohen që ta bëjnë barazinë midis burrave dhe grave pjesë integrale të politikave në nivel shtetëror dhe brendapërbrenda OSBE-së.

Në dekadat e fundit, organizatat e ndryshme janë fokusuar gjithnjë e më shumë tek adresimi i diskriminimit dhe nevojave specifike që lidhen me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje. Në këtë aspekt, në Vendimin nr. 7/09 të Këshillit Ministror të OSBE-së “Për pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe publike” u bëhet thirrje shteteve pjesëmarrëse që “të marrin në shqyrtim masa legjislative për të mundësuar pjesëmarrjen e ekuilibruar në jetën politike dhe publike”.¹¹ Në Vendimin nr. 4/18 të Këshillit Ministror “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave” u bëhet thirrje shteteve pjesëmarrëse që “të

9 Karta për Sigurinë Evropiane, e vitit 1999, <<https://www.osce.org/files/f/documents/4/2/17502.pdf>>.

10 Dokumenti i Moskës i OSBE-së, i vitit 1991, <<https://www.osce.org/files/f/documents/2/3/14310.pdf>>.

11 Vendimi nr. 7/09 i Këshillit Ministror n, <<https://www.osce.org/files/f/documents/2/a/40710.pdf>>.

inkurajojnë të gjithë aktorët e rëndësishëm... që të kontribuojnë për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave, përfshirë edhe ata aktorë që janë të përfshirë në aktivitete profesionale të njohura për publikun dhe/ose në interes të shoqërisë”.¹² Në Vendimin nr. 3/18 të Këshillit Ministror “Për sigurinë e gazetarëve”, që njihet “rolin vendimtar të gazetarëve në mbulimin e zgjedhjeve”, vihen në dukje “rreziqet e dallueshme me të cilat përballen gazetarët gra në punën e tyre, përfshirë edhe punën përmes teknologjive dixhitale”.¹³

Në lidhje me grupet specifike, në Planin e Veprimit të OSBE-së për Përmirësimin e Situatës së Romëve dhe Sintit brenda Zonës së OSBE-së, të vitit 2003, shtetet pjesëmarrëse inkurajohen që “të marrin masa për të garantuar të drejtat e barabarta të votimit për gratë, përfshirë edhe ndalimin e të ashtuquajturit votim familjar”, dhe që “të nxisin pjesëmarrjen e grave romë në jetën publike dhe politike”.¹⁴

Plani i Veprimit i OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore, i vitit 2004, e ngarkoi posaçërisht Departamentin Zgjedhor të ODIHR-it me “monitorimin dhe raportimin mbi pjesëmarrjen politike të grave në proceset zgjedhore”.¹⁵ Në të, theksohet gjithashtu se: “kur është mundësia, ODIHR-i duhet të porosisë dhe të publikojë raporte ku analizohet posaçërisht situata e grave në proceset zgjedhore. Përveç kësaj, institucionet dhe misionet e ndryshme duhet të inkurajojnë një raportim të balancuar sa i përket aspektit të barazisë gjinore... lidhur me zbatimin e angazhimeve të OSBE-së për barazinë gjinore”. Në vendimet e tjera të Këshillit Ministror, u bëhet thirrje shteteve pjesëmarrëse që t’u sigurojnë të drejta të barabarta grave dhe burrave dhe të adresojnë diskriminimin.¹⁶

12 Vendimi nr. 4/18 i Këshillit Ministror, <<https://www.osce.org/files/f/documents/e/e/406019.pdf>>.

13 Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror, <<https://www.osce.org/files/mcdec0003%20safety%20of%20journalists%20en.pdf>>.

14 Plani i Veprimit për Përmirësimin e Situatës së Romëve dhe Sintit brenda Zonës së OSBE-së, OSBE, 27 nëntor 2002, <<http://www.osce.org/odihr/17554>>.

15 Vendimi nr. 14/04 i Këshillit Ministror, OSBE, i datës 7 dhjetor 2004, <<https://www.osce.org/mc/23295>>.

16 Në Dokumentin e Madridit, të vitit 1983, <<https://www.osce.org/mc/40871>>, shtetet pjesëmarrëse theksuan “rëndësinë e sigurimit të të drejtave të barabarta të

B. DETYRIMET DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Neni 3 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), të vitit 1966, parashikon “të drejtën e barabartë të burrit dhe të gruas lidhur me gëzimin e të gjitha të drejtave civile dhe politike të përcaktuara në këtë Pakt”, përfshirë edhe nenin 25 mbi të drejtën e zgjedhjes.¹⁷ Në vitin 2000, në Komentin e tij të Përgjithshëm 28, organi monitorues i traktatit, Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (KDNJ), nxori një interpretim zyrtar të nenit 3. Kjo tregon se: “[D]iskriminimi ndaj grave, shpeshherë, është i ndërthurur me diskriminimin për shkaqe të tjera si raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet politike ose opinione të tjera, origjina kombëtare ose shoqërore, prona, statusi në lindje apo ndonjë status tjetër”. Ai u bën thirrje nënshkruesve të traktatit që “jo vetëm të marrin masa mbrojtëse, por edhe masa pozitive në të gjitha fushat për të arritur një fuqizim efektiv dhe të barabartë të grave”.¹⁸ Ai gjithashtu i inkurajon nënshkruesit “të rishikojnë legjislacionin dhe praktikën e tyre dhe të jenë në krye të zbatimit të të gjitha masave të nevojshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha fushat, për shembull, duke ndaluar diskriminimin [...] në fusha si [...] aktivitetet politike”.

burrave dhe grave” dhe ranë dakord të “marrin të gjitha masat e nevojshme për të promovuar pjesëmarrjen njëjlojtë të efektshme të burrave dhe grave në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore”. Në Dokumentin e Vjenës, të vitit 1989, <<https://www.osce.org/mc/40881>>, ata konfirmuan “vendosmërinë e tyre për t’u garantuar të drejta të barabarta burrave dhe grave” dhe u zotuan që “të marrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë edhe masa legjislative, për të promovuar pjesëmarrjen njëjlojtë të efektshme të burrave dhe grave në jetën politike [...]”. Në Vendimin nr. 13/06 të Këshillit Ministror të datës 6 dhjetor 2006, <<https://www.osce.org/mc/23114>> “Për luftën ndaj intolerancës dhe diskriminimit dhe për promovimin e respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë”, vlerësohet rëndësia e mundësive të barabarta për pjesëmarrje të efektshme në shoqëritë demokratike dhe dënohet ligjërimi diskriminues publik. Në këtë vendim, shtetet pjesëmarrëse inkurajohen që të “nxisin politika që fokusohen tek mundësitë e barabarta, të drejtat, qasja në drejtësi dhe shërbimet publike dhe tek nxitja e dialogut dhe pjesëmarrjes së efektshme”.

- 17 Shih tekstin e plotë të PNDKP-së në: <<https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CCPR.aspx>>. Që prej datës 4 tetor 2022, 173 vende në mbarë botën, përfshirë edhe 56 shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, janë shtete palë në këtë traktat, <<https://indicators.ohchr.org>>.
- 18 Shih Komentin e Përgjithshëm 28 të ZKLKBDNJ-së të datës 29 mars 2000, <https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CCPR/Shared%20Documents/1_Global/CCPR_C_21_Rev-1_Add-10_6619_E.pdf>.

Megjithatë, deri më sot, instrumenti më gjithëpërfshirës për avancimin e grave është Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDNG).¹⁹ KEDNG-ja ka një zbatim shumë të gjerë, me 189 shtete palë në konventë dhe dy vende që e kanë nënshkruar por që nuk e kanë ratifikuar deri në kohën e hartimit të këtij manuali.²⁰ Traktati i detyron nënshkruesit të dënojnë dhe eliminonjë të gjitha format e diskriminimit, përfshirë edhe diskriminimin që ka të bëjë me gëzimin e të drejtave politike (neni 2).

Të drejtat politike trajtohen në mënyrë të shprehur në nenin 7 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDNG). Në këtë nen, kërkohet që shtetet palë në traktat “ të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit”. Më tej në të shtjellohet se shtetet palë “duhet t’u sigurojnë grave, në të njëjtat kushte me burrat, të drejtën: (a) për të votuar në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike dhe për t’u zgjedhur në të gjitha organet e zgjedhura publikisht; (b) për të marrë pjesë në hartimin e politikës së shtetit dhe në zbatimin e saj; për të mbajtur poste publike dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes; (c) për të marrë pjesë në organizatat dhe shoqatat joqeveritare që merren me jetën publike dhe politike të vendit.”

Kështu, neni 7 parashikon disa detyrime të forta, duke iu referuar marrjes nga ana e nënshkruesve të “të gjitha masave të duhura” për të “eliminuar” diskriminimin dhe “për të garantuar” pjesëmarrje në kushte të barabarta. Neni 4 i KEDNG-së përcakton se masat e posaçme që merren në mënyrë të përkohshme për të përshpejtuar *de facto* barazinë nuk duhet të konsiderohen diskriminuese. Aty thuhet gjithashtu se këto masa duhet të ndërpriten kur të jenë arritur objektivat e barazisë së mundësive dhe të trajtimit. Pra, fokusi vendoset jo vetëm te barazia juridike (*de jure*), por edhe te barazia në praktikë dhe në rezultate (*de facto*).

19 Shih tekstin e plotë të KEDNG-së, <<https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cedaw.aspx>>.

20 <<https://indicators.ohchr.org>>.

Organi monitorues i traktatit, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (“Komiteti”), ka nxjerrë rekomandime të përgjithshme të detyrueshme duke interpretuar dispozitat e traktatit. Në vitin 2004, doli Rekomandimi i Përgjithshëm 25 për përdorimin e masave të përkohshme të veçanta, në të cilin thuhet se: “nuk mjafton të garantohet një trajtim i grave që është identik me trajtimin e burrave” dhe se shtetet palë “duhet të vlerësojnë ndikimin, që mund të kenë masat e përkohshme dhe të veçanta sa i përket një qëllimi të caktuar brenda kontekstit kombëtar përkatës, dhe të miratojnë ato masa të veçanta të përkohshme që i konsiderojnë si më të përshtatshmet për të përshpejtuar arritjen e barazisë *de facto* ose barazisë thelbësore për gratë.”²¹

Para kësaj, në vitin 1997, Komiteti nxori Rekomandimin e Përgjithshëm 23 mbi jetën politike dhe publike. Aty thuhet se: “Ajo çka është e rëndësishme dhe që theksohet në Platformën për Veprim të Pekinit, është hendeku midis statusit *de jure* dhe atij *de facto*, ose hendeku midis të drejtës për të marrë pjesë dhe pjesëmarrjes reale të grave në politikë dhe në jetën publike në përgjithësi. Këto të drejta [neni 7] duhet të gëzohen si *de jure* ashtu edhe *de facto*” (shih gjithashtu *Iniciativat Ndërkombëtare Shtesë* më poshtë).²²

Rekomandimi i Përgjithshëm 23 përcakton gjithashtu se organet qeveritare duhet të konsultohen dhe t’i marrin parasysh këshillat e grupeve që përfaqësojnë gjerësisht pikëpamjet dhe interesat e grave, dhe se në hartimin e politikës së shtetit duhet të ketë përfaqësim të barabartë të grave.²³ Ai i referohet gjithashtu edhe shteteve palë që raportojnë të

21 Shih Rekomandimin e Përgjithshëm 25 të AP-së së OKB-së të datës 18 dhjetor 1979, <https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/INT_CEDAW_GEC_3733_E.pdf>.

22 Rekomandimi i Përgjithshëm 23 i AP-së së OKB-së, paragrafët 16 dhe 18, 1997, <https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/INT_CEDAW_GEC_4736_E.pdf>.

23 Tek Rekomandimin i Përgjithshëm 23, paragrafi 28, theksohet se: “Shtetet palë gjithashtu duhet të përpiqen të marrin masa që gratë të emërohen në organet këshillimore shtetërore njëjloj si burrat dhe që këto organe të marrin parasysh, sipas rastit, pikëpamjet e grupeve përfaqësuese të grave. Është përgjegjësi themele e qeverisë që t’i inkurajojë këto iniciativa për të udhëhequr dhe për të orientuar opinionin publik dhe për të ndryshuar qëndrimet që diskriminojnë gratë ose shkurojnë përfshirjen e grave në jetën politike dhe publike.” Në paragrafin 46 theksohet gjithashtu se: “Sipas nenit 7, paragrafi (b), ndër këto masa përfshihen

dhëna statistikore që tregojnë përqindjen e grave, në raport me burrat, të cilat gëzojnë të drejta politike.²⁴ Në Rekomandimin e Përgjithshëm 23 thuhet se ky traktat merr në konsideratë të gjitha degët e shtetit.²⁵ Për më tepër, në të thuhet se qeveritë duhet t'i inkurajojnë partitë politike të miratojnë masa efektive.²⁶

Gratë me aftësi të kufizuara përmenden në mënyrë të shprehur në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, të vitit 2008 (KDPAK).²⁷ Në nenin 6 të saj thuhet se “gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë objekt i një diskriminimi shumëformësh” dhe për këtë shtetet palë duhet “të marrin masa për t’u siguruar që ato t’i gëzojnë në mënyrë të plotë dhe të barabartë të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore”. Në nenin 29 u bëhet thirrje shteteve palë që t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato njësoj si të tjerët. Në mënyrë të veçantë, ato duhet të garantojnë që “personat me aftësi të kufizuara të mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në jetën politike dhe publike njësoj si të tjerët, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të

ato që synojnë të sigurojnë: (a) Barazinë e përfaqësimit të grave në hartimin e politikës së shtetit.”

- 24 Tek Rekomandimi i Përgjithshëm 23, paragrafi 48, vërehet se: “Kur raportohet në bazë të nenit 7, shtetet palë duhet ... (d) të përfshijnë të dhëna statistikore, të ndara sipas gjinisë, që tregojnë përqindjen e grave, në raport me burrat, që i gëzojnë këto të drejta”.
- 25 Rekomandimi i Përgjithshëm 23, paragrafi 5: “Detyrimi i përcaktuar në nenin 7 shtrihet në të gjitha fushat e jetës publike dhe politike dhe nuk kufizohet në ato fusha të përcaktuara në nënparagrafët (a), (b) dhe (c). Jeta politike dhe publike e një vendi është koncept i gjerë. Ai i referohet ushtrimit të pushtetit politik, në veçanti ushtrimit të kompetencave legislative, gjyqësore, ekzekutive dhe administrative. Ky term përfshin të gjitha aspektet e administrimit publik dhe hartimin dhe zbatimin e politikës në nivel ndërkombëtar, kombëtar, rajonal dhe vendor.”
- 26 Rekomandimi i Përgjithshëm 23, paragrafi 5: “Neni 7 i detyron shtetet palë të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike dhe të sigurojnë që ato të gëzojnë barazi me burrat në jetën politike dhe publike... Ky koncept përfshin edhe shumë aspekte të shoqërisë civile, përfshirë edhe bordet publike dhe këshillat vendore, dhe aktivitetet e organizatave, të tilla si: partitë politike, sindikatat, shoqatat profesionale ose ato të industrive të ndryshme, organizatat e grave, organizatat me bazë në komunitet dhe organizata të tjera që merren me jetën publike dhe politike.”
- 27 Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin Opsional, OKB, 2007, <www.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf>. Në kohën e hartimit të këtij manuali, pjesë e traktatit ishin 182 vende, shih <[https://indicators.ohchr.org](http://indicators.ohchr.org)>.

zgjedhur lirisht, përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësi të kufizuara për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur".²⁸

Përveç traktateve me detyrime ligjore, ka një sërë marrëveshesh të tjera me detyrime politike që ndihmojnë në vendosjen e standardeve në lidhje me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje. Për shembull, në një Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë dhe Pjesëmarrjen Politike, të vitit 2011 (66/130), kërkohet, midis masave të tjera, organizimi i trajnimeve për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe për ruajtjen e një mjedisi me tolerancë zero sa i takon dhunës ndaj funksionareve dhe kandidatëve gra.²⁹ Në të, gjithashtu, u bëhet thirrje shteteve "të rishikojnë ndikimin e diferencuar të sistemeve të tyre zgjedhore në pjesëmarrjen politike të grave dhe në përfaqësimin e tyre në organet e zgjedhura dhe t'i përshtatin ose t'i reformojnë ato sisteme, kur është e nevojshme". Megjithëse zgjedhja e sistemit zgjedhor është një çështje sovrane, theksi vihet mbi marrjen parasysh të ndikimit të sistemeve zgjedhore dhe projektin teknik dhe zbatimin e tyre për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje.

C. DETYRIMET DHE STANDARDET RAJONALE

Shumica e shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së janë edhe anëtare të Këshillit të Evropës dhe, për rrjedhojë, janë të detyruara që të veprojnë në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe me protokollin e praktikën e saj gjyqësore, si dhe me instrumentet e tjera ligjrisht jodetyruese. Neni 14 i KEDNJ-së dhe Protokollin 12 ndalojnë diskriminimin në lidhje me çdo të drejtë në bazë të Konventës, si dhe në lidhje me "gëzimin e çdo të drejte të përcaktuar me ligj". Këtu

28 Për më shumë informacion për këtë, shih "Udhëzuesin për vëzhgimin dhe promovimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje", ODIHR, 12 shtator 2017, <<https://www.osce.org/odihr/elections/handbook-observing-people-with-disability>>.

29 Rezoluta 66/130 e AP-së së OKB-së. Gratë dhe pjesëmarrja politike, A/RES/66/130, 19 dhjetor 2011, <<https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N11/466/62/PDF/N1146662.pdf?OpenElement>>.

gratë, përfshirë edhe kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, goftë nëse ndodh në jetën publike ose atë private”.³³ Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) monitoron masat legjislative dhe praktike të marra për zbatimin e Konventës nga shtetet që e kanë ratifikuar traktatin.³⁴ Deri më sot, 34 shtete anëtare të Këshillit të Evropës, të cilat janë që të gjitha edhe shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, e kanë ratifikuar Konventën e Stambollit.³⁵

Burim zyrtar i praktikës së mirë është Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venecias).³⁶ Komisioni i Venecias ka nxjerrë një sërë raportesh të përgjithshme dhe tematike për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje dhe për barazinë gjinore, si dhe disa opinione ligjore, së bashku me ODIHR-in, në lidhje me legjislacionin zgjedhor të shteteve të caktuara.³⁷ Në Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, të Komisionit të Venecias, pranohet se masat e veçanta me anë të të cilave synohet të adresohen pabarazitë që kanë ekzistuar tradicionalisht në përfaqësimin universal, nuk bien ndesh me parimin e të drejtës universale dhe të barabartë për të votuar.³⁸ Ndër këto masa mund të përfshihen vendosja e kuotave, vendet e rezervuara për grupe specifike dhe përjashtimet nga kërkesat për sigurimin e kuorumit ose uljen e pragjeve.

33 Traktati hyri në fuqi në vitin 2014. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (CETS nr. 210), 2014, <<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210>>.

34 Përveç kësaj, në rastet kur kërkohet marrja e masave për të parandaluar një model serioz, masiv ose të vazhdueshëm të çfarëdo akti dhune që parashikohet nga Konventa, GREVIO mund të fillojë një procedurë të veçantë hetimi.

35 Nënshkruesit e Konventës së Stambollit, <<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210/signatures>>.

36 Anëtarët e Komisionit të Venecias, <<https://www.venice.coe.int>>.

37 Përmbledhje e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias në lidhje me barazinë gjinore, Komisioni i Venecias, Strasburg, 13 qershor 2016, <[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-PI\(2016\)007-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-PI(2016)007-e)>, Projektpermbledhje e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias në lidhje me sistemet zgjedhore dhe përfaqësimin gjinor, CDL(2019)015, Strasburg, 2 maj 2019, <[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL\(2019\)015-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL(2019)015-e)>.

38 Shih Komisioni i Venecias, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, 25 tetor 2018, Udhëzues, seksionet I.2.4.b, I.2.5, Strasburg, <[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2002\)023rev2-cor-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2002)023rev2-cor-e)>.

Konventa e Komënuelthit të Shteteve të Pavarura për Standardet për Zgjedhje Demokratike, të Drejtat dhe Liritë Zgjedhore i referohet gjithashtu edhe mosdiskriminimit. Në nenin 2, thuhet se: “e drejta e shtetasit për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet shtetërore, në vetëqeverisjet vendore, në përfaqësimin (kombëtar) të njerëzve të tjerë dhe në poste të tjera të zgjedhura ushtrohet pa asnjë kufizim të një natyre diskriminuese sa i përket gjinisë, gjuhës, fesë ose besimit, bindjeve politike ose bindjeve të tjera, origjinës kombëtare ose shoqërore, përkatësisë në një pakicë kombëtare ose grupi etnik, statusit të pronësisë ose rrethanave të tjera.”³⁹

D. INSTRUMENTE TË TJERA NDËRKOMBËTARE

Në vitin 1995, u mbajt Konferenca e Katërt Botërore për Gratë, e cila kulmoi me miratimin e Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, që më pas u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.⁴⁰ Kjo Platformë njihet për pranimin botërisht të përcaktimit të objektivit prej 30 për qind të përfaqësimit të grave në nivelet vendimmarrëse.

Në vitin 2000, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Kjo nxiti “rritjen e përfaqësimit të grave në nivelet vendimmarrëse në institucionet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe mekanizmat për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve”.⁴¹

Rëndësia e pjesëmarrjes politike të grave njihet edhe në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të), të miratuara nga krerët e

39 Konventa për Standardet për Zgjedhjet Demokratike, të Drejtat dhe Liritë Zgjedhore në shtetet palë të Komënuelthit të Shteteve të Pavarura, faqja e Legjislacionit të KSHP-së, 7 tetor 2002, vizituar më 1 tetor 2022, <<https://cis-legislation.com/document.fwx?rgn=4711>>.

40 “Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim, Konferenca e Katërt Botërore për Gratë, 4-15 shtator 1995, <<https://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/pdf/BDPfA%20E.pdf>>.

41 Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, 31 tetor 2000, <<https://www.un.org/womenwatch/osagi/wps/#resolution>>.

shteteve dhe qeverive në një samit të OKB-së, në vitin 2015.⁴² OZHQ 5 për barazinë gjinore përfshin objektivin 5.5, i cili i referohet “pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të grave dhe mundësive të barabarta për pozicione drejtuese në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike”. OZHQ 16 për paqen, drejtësinë dhe institucione të forta përfshin një tregues të vendimmarrjes reaguese, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet.

42 “Transformimi i botës sonë: axhenda për zhvillim të qëndrueshëm, e vitit 2030” (OZHQ-të), A/RES/70/1 e AP-së së OKB-së, 21 tetor 2015, <<https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N15/291/89/PDF/N1529189.pdf?OpenElement>>.



KAPITULLI 2

FUSHAT E FOKUSIT TË AKTIVITETEVE TË ODIHR-IT PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

2

Në këtë pjesë shqyrtohen një sërë fushash dhe çështjesh të mundshme që AVZ-të e ODIHR-it mund të marrin në konsideratë kur vlerësojnë pjesëmarrjen e grave në zgjedhje dhe përmbushjen përkatëse të detyrimeve dhe standardeve ndërkombëtare (siç detajohet më lart). Anëtarët e ekipit kryesor duhet të identifikojnë se ku janë përmbushur standardet dhe ku ka mangësi dhe të hartojnë rekomandime të realizueshme për përmirësime. Në këtë seksion ndiqet struktura që ka zakonisht raporti përfundimtar i AVZ-së dhe paraqitet edhe një listë pyetjesh që analistët duhet të marrin në konsideratë. Këto nuk duhet të shihen si pyetje të detyrueshme për t'u bërë, por më shumë si një sërë pikash të mundshme pyetjesh që anëtarët e ekipit kryesor duhet t'i marrin parasysh në varësi të situatës në secilin vend. Po kështu, anëtarë të ndryshëm të ekipit kryesor mund të shohin si prioritare disa pika të caktuara pyetjesh, në varësi të llojit të AVZ-së, përbërjes së ekipit kryesor dhe kontekstit të vendit përkatës.

A. KONTEKSTI

Aftësia e grave për të marrë pjesë plotësisht në jetën politike, përfshirë edhe procesin zgjedhor, varet nëse ekziston një mjedis i favorshëm, përfshirë edhe normat sociale dhe kulturore të vendit, dhe nëse ekziston vullneti politik aktiv për ta promovuar përfshirjen e tyre. Për të

vlerësuar nëse ekziston një mjedis favorizues dhe sa favorizues është ai, duhen marrë parasysh një numër çështjesh.

Është thelbësore që në të gjitha nivelet të disponohen të dhëna të plota të ndara sipas gjinisë. Mbledhja e të dhënave mundëson matjen e pozicionit të gruas në shoqëri dhe të shkallës së përvojave të ndryshme, duke krijuar vizibilitet dhe duke ofruar prova mbi të cilat mund të bazohen qasje të mundshme. Duhet të mbahen parasysh besueshmëria e të dhënave dhe besimi i palëve të interesuara te statistikat.

Raporti burra-gra në parlamentin që i mbaron mandati, dhe në poste të tjera të zgjedhura tregojnë nëse ka aktualisht më pak përfaqësim në struktura. Nëse gratë janë sistematikisht dhe në mënyrë të vazhdueshme më pak të përfaqësuara në postet e zgjedhura, mund të jetë nevoja e marrjes së disa masave të përkohshme të veçanta. Gjithashtu, duhet parë edhe ecuria dhe ritmi i përmirësimit drejt arritjes së barazisë. Nëse janë marrë masa të përkohshme të veçanta, atëherë për to duhet të bëhet sistematikisht një analizë për të parë nëse ato masa janë ose jo efektive. A ka prova të një përmirësimi të vazhdueshëm apo duhen marrë edhe disa masa të tjera të përkohshme të veçanta ose të ndryshme? A vihen në jetë dhe a zbatohen masat ekzistuese si duhet? A duhet të vendosen disa sanksione ose stimuj më efektivë në lidhje me këto masa?

Mund të jetë interesante të shihet përqindja e grave dhe burrave në detyrë, që kanë zgjedhur të mos kandidojnë për një mandat tjetër. Në disa vende, duket se gratë kanë më shumë gjasa të largohen nga politika sesa burrat. Disa nga shqetësimet e tyre përfshijnë vështirësitë në gjetjen e një ekuilibri mes detyrave profesionale dhe jetës familjare, ndjesinë se ato nuk merren seriozisht, atmosferën konfrontuese në parlament dhe brendapërbrenda partive politike dhe ndjenjën se nuk mund të ecin përpara mjaftueshëm.⁴³

43 Shih, për shembull, faktet e gjetura të një “Studimi rajonal mbi përfaqësimin politik të grave në vendet e Partneritetit Lindor”, botimi i 2-të, Këshilli i Evropës, Strasburg, tetor 2017, < <https://rm.coe.int/regional-study-on-women-s-përfaqësimi-politik-në-pjesën-lindore/168070b6a4>>.

Numri dhe përqindja e grave në këshillat apo asamblatë vendore dhe ato rajonale janë gjithashtu të rëndësishme sepse një nga rrugët e zakonshme drejt posteve të zgjedhura në nivel kombëtar është përmes suksesit politik në nivel vendor. Nëse gratë nuk përfaqësohen si duhet në organet vendore, grupi i kandidatëve gra të kualifikuara dhe me përvojë për poste në nivel kombëtar mund të jetë më i vogël. Një tjetër gjë që duhet të merret parasysh është nëse zyrtarët e zgjedhur vendorë shërbejnë me kohë të plotë apo të pjesshme dhe marrin ose jo rrogë, sepse pengesat për pjesëmarrje, që kanë të bëjnë me të ardhurat, mund të ndikojnë në mënyrë shpërpjesëtimore tek gratë.

Tregues i statusit të grave në jetën politike mund të jetë edhe numri i grave në kabinet dhe në pozicione të tjera të ngjashme të nivelit të lartë, si dhe natyra e këtyre pozicioneve. Gratë shpesh emërohen në ministritë që zakonisht konsiderohen se mbulojnë “çështje të grave”, siç janë shërbimet sociale, çështjet e familjes apo arsimit. Kur ato përjashtohen në këtë mënyrë nga rolet e tjera në qeveri, pritshmëritë e shoqërisë që bazohen te stereotipat për gratë si nëna, edukatore dhe shtëpiake, përforcohen edhe më shumë.

Hartimi i planeve kombëtare të veprimit për barazinë gjinore –përfshirë edhe ato plane që synojnë strukturat dhe aktivitetet e qeverive, parlamenteve dhe partive politike – dhe ecuria e tyre në zbatim mund të jenë tregues të nivelit ekzistues të angazhimit për fuqizimin e grave. Është e rëndësishme të shihet me kujdes: nëse në këto plane identifikohen fushat ku synohet të bëhen përmirësime specifike për përfshirjen dhe për pjesëmarrjen e grave në politikë dhe në zgjedhje; cilat janë agjencitë përgjegjëse; nëse monitorohet apo jo zbatimi i planit; dhe nëse ekziston ndonjë raportim publik për ecurinë e zbatimit të atij plani.

Mund të jetë më e vështirë për gratë që të marrin pjesë në politikë aty ku ka nivele të ulëta edukimi, arsimit dhe mundësish ekonomike. Pengesë mund të jetë edhe ekzistenca e përfytyrimeve të rrënjësura tradicionale dhe popullore të grave që nuk promovojnë gratë, të cilat kanë mendim politik. Të gjitha këto vështirësi mund të vijnë edhe për shkak të ndarjeve gjeografike, p.sh.: ndërmyet komuniteteve urbane dhe rurale dhe zonave me përqendrim më të madh të

pakicave kombëtare. Niveli i ulët i dhunës ndaj grave është një tregues i rëndësishëm i shoqërive gjithëpërfshirëse, të barabarta dhe të qëndrueshme (shih edhe pjesën 3, më poshtë, mbi dhunën ndaj grave në zgjedhje).

Është gjithashtu e rëndësishme që AVZ-të të takohen me organizatat e grave dhe me organizatat e shoqërisë civile, që ndjekin pjesëmarrjen e grave në zgjedhje, dhe të marrin në konsideratë rolin e tyre. Këtu duhet parë nëse këto organizata mund të veprojnë *de facto*, nëse u merret mendim nga agjencitë shtetërore gjatë proceseve të reformës zgjedhore dhe sa efikase janë ato në adresimin e çështjeve të grave, veçanërisht në lidhje me pjesëmarrjen politike. Përveç kësaj, vlen të analizohet nëse ka partneritete strategjike ndërmjet grupeve të grave dhe drejtuesve burra dhe palëve të tjera të interesuara dhe sa efektive janë ato partneritete në avancimin e barazisë gjinore në zgjedhje.

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ Si ka qenë raporti gra-burra në parlamentin që i mbaroi mandati dhe në organet e tjera të zgjedhura në nivel rajonal dhe vendor?
- ▶ A disponohen të dhëna të plota dhe të ndara sipas gjinisë? A janë të besueshme këto të dhëna?
- ▶ Sa gra janë në kabinetin e ministrave apo në poste të larta ekzekutive? Çfarë portfolesh mbajnë këto gra?
- ▶ A është më i vogël numri i grave që rikandidojnë për ato pozicione që kishin deri tani?
- ▶ A ka politika kombëtare për barazinë gjinore të shoqëruara me plane veprimi? A zbatohen këto politika në mënyrë efektive?

- ▶ A ka ndonjë përmirësim domethënës së fundmi në fushën e barazisë gjinore në vend? A ka pasur ndonjë kthim të ndjeshëm mbrapa së fundmi?
- ▶ Si është niveli i edukimit, arsimimit dhe mundësive ekonomike për gratë?
- ▶ Cilat janë nivelet e raportuara dhe të perceptuara të dhunës me bazë gjinore?
- ▶ A ka grupe të shoqërisë civile që mbështesin të drejtat e grave, përfshirë edhe të drejtat politike? A kanë ato grupe “hapësirën”, burimet dhe njohuritë e nevojshme për të funksionuar siç duhet? A janë konsultuar ato gjatë reformave zgjedhore?

B. KUADRI LIGJOR

Një AVZ vlerëson se sa i përmbush një vend angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare përmes kuadrit të tij kushtetues, ligjor dhe rregullator. Prandaj kuadri ligjor duhet analizuar për të parë nëse ai i garanton të drejtat politike dhe zgjedhore në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. A janë futur në legjislacion edhe masa të veçanta siç kërkohet nga detyrimet dhe standardet ndërkombëtare dhe a zbatohen në mënyrë efektive ato dispozita ligjore?⁴⁴

Një AVZ duhet të verifikojë se cilat traktate ndërkombëtare, protokolle opsionale dhe marrëveshje të tjera lidhur me barazinë gjinore janë ratifikuar dhe nëse janë ratifikuar me ndonjë lloj rezerve. Ajo duhet

44 “Udhëzues për rregullimin e partive politike”, botimi i 2-të, ODIHR-Komisioni i Venecias, 14 dhjetor 2020, <[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2020\)032-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2020)032-e)>, i cili trajton gjithashtu mënyrat në të cilat legjislacioni mbi partitë politike mund të promovojë barazinë gjinore (përfshirë edhe përmes masave të përkohshme të veçanta) në Pjesën III mbi “Partitë në zgjedhje” (paragrafët 188-190).

të përcaktojë gjithashtu nivelin e traktatit në hierarkinë e normave juridike dhe nëse praktika gjyqësore ndërkombëtare gjen zbatim të drejtpërdrejtë në sistemin juridik të vendit. Duhet të shihen gjithashtu edhe raportet e paraqitura në organet monitoruese të traktateve dhe raportet e nxjerra nga këto të fundit.

KEDNG-ja angazhon shtetet palë “të përfshijnë parimin e barazisë së burrave dhe grave në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ligje të tjera të përshtatshme”.⁴⁵ Prandaj, për të vlerësuar shkallën e mbështetjes së pjesëmarrjes së grave, përfshirë edhe përmes marrjes së masave të veçanta, duhet të analizohen legjislacioni dhe rregulloret për zgjedhjet dhe për partitë politike. Disa karakteristika pozitive të legjislacionit janë kriteret për të dhëna të ndara sipas gjinisë në të gjitha fazat e një procesi zgjedhor dhe proceset gjithëpërfshirëse ligjbërëse, që përfshijnë edhe konsultimin me grupet e grave. Dispozitat ligjore duhet të vlerësohen për të parë nëse ato u sjellin përfitim grave dhe burrave në mënyrë të barabartë ose nëse përbëjnë veçanërisht disavantazh për gratë. Për të na ndihmuar që të kuptojmë rolin e grave në jetën publike dhe në poste drejtuese, mund të jetë e nevojshme që të shqyrtohen edhe ligje të tjera që lidhen me sa më lart. Ndër to mund të përfshihen ligjet që lidhen me statusin personal (p.sh.: kur gratë nuk janë në gjendje të dalin publikisht pa babanë ose pa një vëlla), me familjen dhe kujdestarinë, punësimin, taksat, trashëgiminë dhe pronësinë, si dhe kodet civile dhe penale.

Në ligjet e disa vendeve mund të ketë edhe dispozita kundër diskriminimit, si ligjet e veçanta që trajtojnë barazinë midis grave dhe burrave. Në këtë rast, AVZ-ja duhet të vlerësojë zbatimin dhe ndikimin e ligjeve të tilla në procesin zgjedhor. Gjithashtu, duhet t'i kushtohet vëmendje interpretimit zyrtar të një legjislacioni të tillë në praktikën gjyqësore. Mund të vlerësohen gjithashtu edhe ekzistenca dhe kompetencat e çdo organi ligjor të mandatuar me adresimin e të drejtave të grave.

Për çdo përpjekje të ardhshme për reformën ligjore dhe zgjedhore, vlen të theksohen boshllëqet dhe mospërputhjet ligjore që mund të

45 KEDNG, *vep.cit.*, shënimi 19, neni 2 (a).

çojnë në diskriminim ndaj grave, si dhe në interpretim të gabuar të ligjeve dhe rregulloreve, që mund t'i dëmtojnë ato. Këtu, rekomandimet duhet të fokusohen tek harmonizimi i legjislacionit nga perspektiva gjinore me qëllim trajtimin e barabartë të grave dhe burrave.

Një aspekt tjetër për t'u marrë në konsideratë është edhe nëse procesi i reformës zgjedhore, përfshirë edhe hartimin e legjislacionit lidhur me zgjedhjet, ka qenë gjithëpërfshirës dhe është kryer duke marrë parasysh edhe pikëpamjet e grupeve të grave. Kjo duhet të përfshijë konsultimet për të gjitha çështjet, jo vetëm për çështjet që perceptohen si të rëndësishme për avancimin e të drejtave zgjedhore të grave.

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ A i ka nënshkruar dhe ratifikuar vendi instrumentet përkatëse, përfshirë edhe PNDCP-në, KEDNG-në, KDPAK-në, KEDNJ-në dhe Konventën e Stambollit? A janë ratifikuar ato me ndonjë lloj rezerve? Çfarë raportimi është bërë nga organet monitoruese të traktateve?
- ▶ Çfarë vendi zënë në rendin juridik kombëtar instrumentet ndërkombëtare ligjërishit detyruese dhe jurisprudenca ndërkombëtare?
- ▶ A garanton kushtetuta të drejta të barabarta për burrat dhe për gratë?
- ▶ A ka ndonjë akt ligjor që trajton në mënyrë specifike barazinë mes grave dhe burrave?
- ▶ A ka ndonjë masë të veçantë ligjore për të nxitur pjesëmarrjen e grave në politikë? A janë ato masa të zbatueshme dhe efikase? A trajtohet në mënyrë efikase moszbatimi i atyre masave?

Në të njëjtën kohë, në një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, të vitit 2011, shteteve u bëhet thirrje që “të rishikojnë ndikimin e diferencuar që kanë sistemet e tyre zgjedhore në pjesëmarrjen politike të grave dhe përfaqësimin e tyre në organet e zgjedhura, dhe t’i përshtatin ose t’i reformojnë ato sisteme, sipas rastit”.⁴⁸ Kjo dispozitë njeh ndikimin e mundshëm të zgjedhjes së sistemit zgjedhor në pjesëmarrjen e grave dhe në përfaqësimin e mëvonshëm të tyre. Prandaj, ODIHR-i duhet të analizojë nëse sistemi zgjedhor është rishikuar nga këndvështrimi i ndikimit në barazinë gjinore dhe nëse pjesë e atij procesi kanë qenë edhe OSHC-të që përfaqësojnë të drejtat e grave.

Në varësi të llojit të sistemit zgjedhor në fuqi, AVZ-të duhet të përcaktojnë se çfarë vështirësish dhe pengesash mund të hasin gratë dhe si mund të ndikojnë politikat zgjedhore ndryshe tek gratë, përfshirë edhe gratë që u përkasin grupeve të tjera më pak të përfaqësuara. Aspektet që duhen marrë këtu parasysht përfshijnë: llojin e sistemit zgjedhor, pragjet për ndarjen e mandateve, madhësinë e njërive zgjedhore (numri i përfaqësuesve për një zonë zgjedhore), llojet e listave të kandidatëve (të hapura ose të mbyllura), procedurat e votimit, kuotat dhe vendet e rezervuara. Në përgjithësi, studimet tregojnë se numri më i madh i grave priret të zgjidhet sipas sistemeve proporcionale sesa sipas sistemeve mazhoritare ose sipas sistemeve të përziera.⁴⁹ Megjithatë, përtej gjinisë, përpara se të bëjnë ndryshime, shtetet duhet t’i shqyrtojnë në mënyrë të hollësishme avantazhet dhe disavantazhet e sistemeve zgjedhore në një kontekst të caktuar dhe ky proces duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe i mbështetur tek informacioni.

48 Rezoluta 66/130 e Kombeve të Bashkuara, A/RES/66/130, 19 mars 2012, <<https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N11/466/62/PDF/N1146662.pdf?OpenElement>>.

49 Shih, për shembull, “Ndikimi i diferencuar i sistemeve zgjedhore në përfaqësimin politik të grave”, Drejtoria e Përgjithshme e Parlamentit Evropian për Kërkimin Shkencor, mars 1997, <https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/femm/w10/1_en.htm>.

SISTEMET MAZHORITARE

Në krahasim me sistemet e përfaqësimit proporcional, mund të jetë më e vështirë për gratë që të kandidojnë në sistemet mazhoritare ose sistemet ku ka një mandat të vetëm për zonë zgjedhore. Nëse burrat shihen si kandidatë që i maksimizojnë shanset e partisë për të fituar atë mandat të vetëm në zgjedhje për zonën zgjedhore përkatëse, atëherë këto sisteme ofrojnë përgjithësisht më pak nxitje për partitë që të promovojnë kandidatet gra.

Përveç kësaj, një tjetër argument është që në sistemet mazhoritare, një burrë që rikandidon për pozicionin që ka aktualisht, ka shumë avantazhe, për shkak se njihet gjerësisht nga njerëzit, dhe kjo, shpesh, shërben si një bazë e mirë për të mbledhur fonde dhe ai garon duke pasur ndërkohë një pozitë të fortë influence. Ky avantazh që kanë burrat që rikandidojnë mund të ndikojë negativisht në nivelet e pjesëmarrjes së grave, duke pasur parasysh edhe dominimin tradicional që kanë burrat në poste të ndryshme historikisht. Gjithashtu, burrat mund edhe të kenë më shumë akses në burimet ekonomike në komunitetet e tyre, veçanërisht përmes lidhjeve të financimit që i kanë krijuar që gjatë kohës që kanë qenë në detyrë.

SISTEMET E PËRFAQËSIMIT PROPORCIONAL

Partitë kanë më shumë mundësi që të përfshijnë kandidate gra në sistemet e përfaqësimit proporcional, ku partitë paraqesin lista kandidatësh. Bazuar në vëzhgimet e ODIHR-it, nëse nuk do ishte presioni për të fituar, që lind zakonisht në sistemet mazhoritare nga nevoja për t'i fituar të gjitha, partitë duket se do ishin më të gatshme për të pasur lista më të larmishme kandidatësh. Sistemet proporcionale janë gjithashtu më të volitshme sesa sistemet mazhoritare sa i takon masa-ve që favorizojnë grupet e paavantazuara (shih më poshtë). Sistemet e përfaqësimit proporcional mund t'u ofrojnë më shumë mundësi partive më të vogla, axhendat e të cilave, me qëllim që të fitojnë mandate, fokusohen në çështje specifike. Në disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, kjo ka çuar në krijimin e disa partive të grave.

AVZ-të e ODIHR-it duhet të përcaktojnë dhe të vlerësojnë: nëse ka ndonjë detyrim ligjor për diversitetet gjinor në lista; nëse partitë kanë mekanizma të brendshëm në statutet e tyre apo në praktikë për përfshirjen e grave në listat e kandidatëve; sa përfshihen gratë në listat e regjistruara zgjedhore; dhe nëse kandidatet gra konsiderohen të kenë renditje të tilla në ato lista, ku vërtet mundet të fitojnë në zgjedhje. Duhet të analizohet gjithashtu edhe sistemi për zëvendësimin e kandidatëve për të parë nëse ka ndonjë detyrim për ruajtjen e ekuilibrit gjinor në rast të tërheqjeve të kandidatëve nga gara dhe për të parë nëse vendimet e gjykatave dhe praktika janë të qëndrueshme në këtë drejtim.

Llojet e listave: Në sistemin e listave “të mbyllura”, kandidatët vendosen në renditje fikse dhe nuk mund të ndryshohen nga zgjedhësit. Në përgjithësi, sistemet e listave të mbyllura janë më të favorshmet për të pasur më shumëandidate gra, me kusht që ato të vendosen mjaftueshëm lart në lista. Sistemet e listave “të hapura” u lejojnë zgjedhësve që ta ndryshojnë renditjen e kandidatëve, duke renditur ose duke shprehur preferencën e tyre për disa kandidatë kundrejt të tjerëve brenda një liste partiake. Në sistemet e listave “të hapura”, është konstatuar se zgjedhësit shpesh favorizojnë burrat dhe kandidatet gra përfundojnë në renditje më poshtë. Megjithatë, ndonjëherë, listat e hapura mund të jenë me përfitim për kandidatet gra nëse mbështetja për to mund të mobilizohet në mënyrë efektive dhe nëse këtoandidate janë të njohura në zonat e tyre zgjedhore. Rregulloret dhe praktikat e brendshme të partive politike luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e mbështetjes së nevojshme financiare dhe politike për gratëandidate në listat zgjedhore.

Kuotat: Ekzistojnë lloje të ndryshme kuotash që mund të përdoren, në varësi të kontekstit dhe sistemit zgjedhor në fuqi. Ato lidhen, më së shumti, me sistemet përfaqësuese proporcionale me lista partiake. Megjithatë ato mund të aplikohen edhe në sistemet mazhoritare, për shembull, duke vendosur detyrimin për partitë që të kenë një ekuilibër gjinor në listat e kandidatëve për zgjedhjet paraprake brendapërbrenda partive, në komisionet e tyre të propozimit të kandidatëve apo në çfarëdolloj sistemi që mund të kenë partitë së brendshmi për të zgjedhur kandidatët me të cilët garojnë në zgjedhje.

Në sistemet e përfaqësimit proporcional me lista kandidatësh, rriten shumë mundësitë që gratë të zgjidhen kur ligji specifikon nivelet minimale të përfaqësimit të të dyja gjinive në listën e kandidatëve të secilës parti dhe detyrimet në lidhje me renditjet e tyre në lista (detyrimet për përcaktimin e vendeve në lista).⁵⁰ Siç u përmend më lart, në KEDNG shtetet inkurajohen që të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin dhe në këtë mënyrë për të siguruar *de facto* pjesëmarrje të barabartë në jetën politike dhe publike. Kuotat janë një formë masash të veçanta dhe të përkohshme, të njohura si një nga mënyrat më efikase për të rritur pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave. Në përputhje me fokusin e KEDNG-së tek natyra e përkohshme e masave, rekomandohet që kuotat të jenë në fuqi deri në arritjen *de facto* të pjesëmarrjes në nivele të barabarta.

Kuotat legislative kanë ndikimin më të madh në zgjedhjen e kandidateve gra, pasi ato vlejné për të gjitha partitë dhe ligji, normalisht, ofron një bazë për zbatim, si p.sh.: listat e partive, që nuk i plotësojnë detyrimet në lidhje me kuotat në vendosjen e kandidatëve në lista, nuk pranohen. Megjithatë këto kuota mund të mos jenë efikase nëse ligji nuk specifikon edhe mënyrën se si duhet të renditen kandidatët burra dhe kandidatet gra në lista. Lista që mendohet se ofron mundësi më të mira për zgjedhjen e grave është lista që njihet si “lista zinxhir”, ku kandidatët burra dhe kandidatet gra alternohen njëri pas tjetrit.

Aty ku aplikohen kuotat, vëzhguesit duhet të shohin edhe nëse në legjislacion ka edhe dispozita për mënyrën e plotësimit të vendeve vakante nëse një kandidat jep dorëheqjen. Për shembull, sidomos në rastin e listave të mbyllura, mund të ketë një detyrim që nëse një grua jep dorëheqjen ose largohet për çfarëdolloj arsyeje nga detyra para kohe, ajo duhet të zëvendësohet nga kandidatja tjetër grua në radhë në listën e kandidatëve. Pa dispozita të tilla, efektiviteti i kuotave mund të zvogëlohet dhe kjo mangësi mund të përdoret në mënyrë strategjike, duke ushtruar presion ndaj kandidateve gra të suksesshme që ato të

50 “Raporti i ri i UNP-së: më shumë gra në parlament dhe më shumë vende me barazi gjinore”, faqja e internetit e UNP-së, 3 mars 2022, <[https://www.ipu.org/news/pre-ss-releases/2022-03/new-ipu-report -Më shumë-gratë-në-parlament-dhe-më shumë-vende-me-barazi gjinore](https://www.ipu.org/news/pre-ss-releases/2022-03/new-ipu-report-Më-shumë-gratë-në-parlament-dhe-më-shumë-vende-me-barazi-gjinore)>.

japin dorëheqjen. Prandaj është e rëndësishme të merret parasysh se çfarë dorëheqjesh ka pasur dhe si kanë funksionuar zëvendësimet në praktikë.

Aty ku detyrimi për kuota është përdorur si masë e përkohshme në të kaluarën, duhet të mblidhen dhe të analizohen të dhëna dhe opinione për të kuptuar se sa efikase apo sa kufizuese kanë qenë ato kuota. Këtu duhet parë nëse ndonjë përmirësim që është arritur, ka qenë i qëndrueshëm me kalimin e kohës. Për shembull, partitë mund të vazhdojnë me kuota vullnetare, pasi kanë zgjedhur të miratojnë politika të brendshme për promovimin e grave si kandidate përmes një sistemi kuotash brendapërbrenda partisë.

Madhësia e njësive zgjedhore: Me termin “madhësi e zonës zgjedhore” këtu nënkuptohet numri i kandidatëve të zgjedhur nga një zonë e vetme zgjedhore. Në përgjithësi, sa më e madhe të jetë një zonë zgjedhore, ose sa më shumë përfaqësues të zgjidhen nga një zonë e vetme, aq më e madhe është mundësia që gratë të zgjidhen.

Pragjet: Në sistemet proporcionale, pragjet përcaktojnë një përqindje minimale të votave, që duhet të fitohen, që një parti të marrë pjesë në shpërndarjen e mandateve. Sa më i lartë të jetë pragu, aq më e vështirë është për partitë më të vogla që të arrijnë përfaqësimin në parlament. Megjithatë nuk ka një standard ndërkombëtar që rregullon nivelet e pragjeve, në shumicën e vendeve të OSBE-së, pragu nuk shkon më shumë se pesë për qind. Pragjet në nivele më të larta mund të rezultojnë në një përqindje të lartë të votave “të humbura” (për partitë që nuk fitojnë asnjë vend në parlament). AVZ-ja mund të shohë nëse ka shqetësime lidhur me ndikimin që kanë pragjet, sidomos në pjesëmarrjen e grave. Për shembull, partitë e vogla me më pak mandate mund të kenë vetëm burra si kandidatë kryesorë dhe si të zgjedhur tashmë në detyrë.

Vendet e rezervuara: Një shembull tjetër i një mase që favorizon grupet e paavantazuara, është krijimi i disa vendeve “të rezervuara”, ku një numër i caktuar mandatesh në organin legjislativ lihet mënjanë për t’u plotësuar ekskluzivisht nga një grup i caktuar, siç janë gratë. Sisteme të tilla, të cilat përdoren në një sërë shtetesh pjesëmarrëse

të OSBE-së, garantojnë një nivel minimal të përfaqësimit të grave në parlamente. Megjithatë ky sistem mund të jetë kundërproduktiv duke i dekurajuar gratë që të mos kandidojnë nëse nuk ka vende të rezervuara, duke reduktuar kështu edhe mundësinë e tyre për pjesëmarrje në përgjithësi. Ndonjëherë, përfaqësueset gra, që e marrin mandatin përmes vendeve të rezervuara për to, mund të konsiderohen se nuk e kanë “fituar” mandatin përmes zgjedhjeve plotësisht konkurruese dhe mund të ndihen të diskriminuara si deputete.

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ A ka shqetësime specifike se si ndikojnë në pjesëmarrjen e grave lloji i sistemit zgjedhor dhe elementet që lidhen me të?
- ▶ A ka pasur ndonjë vlerësim për të parë se sa ndikon sistemi zgjedhor nga këndvështrimi gjinor?
- ▶ A ka pasur diskutime për një reformë të mundshme të sistemit zgjedhor, duke marrë parasysh ndikimin nga këndvështrimi gjinor, dhe a janë konsultuar grupet e grave për këtë?
- ▶ A përfshin apo a ka përfshirë ligji ndonjë kuotë apo masa të tjera të përkohshme për të promovuar zgjedhjen e grave? Nëse po, a konsiderohen ato efikase? Çfarë avantazhesh dhe disavantazhesh duket se kanë ato? A zbatohen ato si duhet?
- ▶ Çfarë masash ligjore janë marrë për trajtimin e listave të kandidatëve që nuk i përmbushin detyrimet legjislativë në lidhje me barazinë gjinore? Si menaxhohen në praktikë këto masa?
- ▶ Si plotësohen vendet vakante nëse një grua tërhiqet?

D. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Organet e administrimit të zgjedhjeve (OAZ-të) kanë një rol shumë të rëndësishëm për të luajtur në promovimin e grave në zgjedhje. Këtu përfshihet: marrja e masave që edhe këto organe të kenë gra në përbërjen e tyre që nga niveli i ulët deri në nivel drejtues; sigurimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe në dispozicion të publikut në lidhje me përbërjen e administratës zgjedhore, zgjedhësit dhe kandidatët; zbatimimi i procedurave të regjistrimit të kandidatëve, përfshirë edhe kuotat gjinore ose masa të tjera që favorizojnë grupet e paavantazuara; konsultimi me OSHC-të që përfaqësojnë të drejtat e grave; marrja e masave për ndërgjegjësimin dhe edukimin e zgjedhësve; si dhe promovimi i masave që mund të ndihmojnë në rritjen e pjesëmarrjes së grave si zgjedhëse dhe si kandidatë.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare, gratë duhet të përfaqësohen në pozicione drejtuese në organet e administrimit të zgjedhjeve.⁵¹ Disa vende kanë ligje që e bëjnë të detyrueshëm përfaqësimin e ekuilibruar të grave dhe burrave në vetë përbërjen e organeve të administrimit të zgjedhjeve. Përveç këtyre kërkesave, OAZ-të mund të kenë edhe politikat e tyre publike për promovimin e barazisë gjinore, si dhe kompetenca rregullatore për promovimin dhe zbatimin e masave të veçanta për të rritur përfaqësimin e grave brendapërbrenda strukturave të tyre. Përfaqësimi i balancuar i grave dhe burrave duhet të ndihmojë në promovimin e përfaqësimit dhe besueshmërisë së OAZ-ve. Megjithatë, në shumë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, gratë janë të mirëpërfaqësuar në stafin e administratës zgjedhore të nivelit më të ulët, por kjo nuk shihet në nivelet e mesme dhe të larta dhe as në pozicionet drejtuese.

OAZ-të mund të caktojnë një pikë kontakti apo të kenë një departament për barazinë gjinore ose mund t'i integrojnë çështjet gjinore në politikat

51 Kjo është në përputhje me Rekomandimin 2003(3) të Këshillit të Evropës, 12 mars 2003, <https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016805e0848>, i cili i referohet përfaqësimit të burrave dhe grave në të gjitha organet vendimmarrëse në jetën politike apo publike në masë jo më të vogël se 40 për qind. Gjithashtu, në paragrafin 15 të Rekomandimit të Përgjithshëm nr. 23 të KEDNG-së: Jeta Politike dhe Publike, 1997, A/52/38, <<https://www.refworld.org/docid/453882a622.html> [e vizituar më 1 tetor 2022]>, theksohet rëndësia jo vetëm e eliminimit të pengesave *de jure*, por edhe e arritjes *de facto* të barazisë në jetën publike dhe politike.

dhe në aktivitetet e tyre të ndryshme. OAZ-të duhet që të paktën të marrin masat që të ketë të dhëna të ndara sipas gjinisë për përbërjen e administratës zgjedhore, kandidatët dhe zgjedhësit, dhe nëse është e mundur, edhe për kandidatët e propozuar, për kandidatët që japin dorëheqjen, për zgjedhësit pjesëmarrës, vëzhguesit e akredituar, korrespondentët dhe përfaqësuesit e medias, si dhe për stafin që punon me OAZ-të. Studimet e kryera nga OAZ-të mbi impaktin e barazisë gjinore mund të shërbejnë më tej për mbledhjen e provave, të cilat mund të përdoren për hartimin e politikave pozitive në lidhje me barazinë gjinore. Gjithashtu, OAZ-të duhet të konsultohen me OSHC-të që përfaqësojnë të drejtat e grave për një gamë të gjerë çështjesh dhe politikash dhe jo vetëm për ato çështje që identifikohen si çështje të barazisë gjinore.

OAZ-të mund të bëjnë edukimin e zgjedhësve, që synon sidomos gratë dhe fokusohet tek të drejtat e grave për të votuar, dhe mund të bëjnë trajnime dhe të japin informacione të specializuara për aspirantet dhe kandidatet gra. Këtu mund të përfshihen, për shembull, informacionet mbi masat që mund të merren nëse ato përballen me ngacmime (në jetën reale ose përmes internetit) dhe burimet në dispozicion të grave. OAZ-të mund edhe të marrin disa masa të posaçme në ditën e zgjedhjeve, duke ofruar, për shembull, informacion mbi zgjedhjet që mund të përvetësohet lehtësisht nga gratë me nivel të ulët arsimimi. Në trajnimet që zhvillojnë për administruesit e zgjedhjeve (përfshirë këtu edhe anëtarët e qendrave të votimit), OAZ-të duhet të përfshijnë edhe disa komponentë me ndjeshmëri gjinore si, për shembull, informimin e tyre për parandalimin dhe reagimin ndaj rasteve të votimit në grup ose votimit familjar. OAZ-të duhet t'i shohin këto aspekte dhe t'i vlerësojnë ato nga këndvështrimi i respektimit të të drejtave të grave për të votuar.

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ A kanë OAZ-të të dhëna të plota të ndara sipas gjinisë në dispozicion të publikut të gjerë (p.sh.: për përbërjen e administratës zgjedhore, zgjedhësit, kandidatët etj.)?

- ▶ A kanë OAZ-të strategji për barazinë gjinore dhe plane veprimi apo ndonjë dokument tjetër politikash, që ka të bëjë me barazinë gjinore? A rishikohen sistematikisht këto dokumente dhe a ka mekanizma për llogaridhënien, si, për shembull, një pikë fokale për çështjet gjinore?
- ▶ Cila është përbërja nga këndvështrimi gjinor i administratës zgjedhore në nivele të ndryshme, përfshirë edhe rolet vendimmarrëse? A janë marrë masa të veçanta për të rritur përfaqësimin e grave? A zbatohen ato në mënyrë efektive?
- ▶ Sa të ndryshme janë trajnimet dhe përpjekjet e OAZ-ve për rritjen e kapaciteteve ndaj çështjeve të barazisë gjinore?
- ▶ A konsultohen OAZ-të rregullisht me OSHC-të e grave? Nëse po, a përfshihen në këto konsultime të gjitha çështjet apo vetëm çështjet që lidhen me barazinë gjinore? A bëhen konsultime në nivele të ndryshme të OAZ-ve (përfshirë edhe nivelin e njësive zgjedhore)?
- ▶ Çfarë kompetencash rregullatore dhe zbatuese kanë OAZ-të në lidhje me barazinë gjinore? A zbatohen në mënyrë të vazhdueshme sanksionet për mosrespektim të ligjit (p.sh.: gjogat, reduktimi i financimeve shtetërore/publike, mosregjistrimi i listave të partive)? A shihen këto sanksione si shkurajuese?
- ▶ A ka informacione për trajnime specifike/edukimin e zgjedhësve që kanë si pikësynim gratë dhe/ose që promovojnë pjesëmarrjen e grave në zgjedhje? A bëhet ndonjë edukim tjetër i zgjedhësve për çështje që lidhen me votimin familjar/votimin në grup dhe me votimin e deleguar dhe që gratë të mund të votojnë pa ndërhyrje apo ndikime të padrejta? A ka informacione për votimin në dispozicion të grave me nivel të ulët arsimimi, në gjuhë të ndryshme dhe në formate të aksesueshme për gratë me dëmtime ndijore?

E. REGJISTRIMI I VOTUESVE

AVZ-të e ODIHR-it duhet të mbledhin të dhëna për regjistrimin të ndara sipas gjinisë dhe të shohin nëse ka aspekte ligjore dhe praktike të regjistrimit të votuesve që prekin gratë, që mund të pengojnë ose të mos lejojnë regjistrimin e grave si zgjedhëse, si dhe masat që janë marrë për të promovuar pjesëmarrjen e tyre të plotë. Parimet e të drejtës universale dhe të barabartë për të votuar kërkojnë që aksesin në votim të mos jetë diskriminues për asnjë shkak, përfshirë edhe gjininë.⁵²

Regjistrimi i votuesve mund të jetë “pasiv” ose “aktiv”.⁵³ Në sistemet e regjistrimit pasiv, listat e zgjedhësve me të drejtë vote përpilohen bazuar në të dhënat ekzistuese mbi popullsinë të mbajtura nga një ose më shumë agjenci shtetërore, dhe votuesve në përgjithësi nuk u kërkohej të aplikojnë ose të konfirmojnë përfshirjen e tyre në lista, por mund të verifikojnë saktësinë e të dhënave të tyre.⁵⁴ Në sistemet e regjistrimit aktiv, votuesit duhet të aplikojnë për t’u përfshirë në regjistrin kombëtar të zgjedhësve ose në listën zgjedhore rajonale.

Në sistemet e regjistrimit pasiv, është e rëndësishme të merret parasysh burimi dhe cilësia e të dhënave të popullsisë në përcaktimin e të drejtës së votës, si dhe metodat që përdoren për ruajtjen dhe përditësimin e këtyre të dhënave. Gratë mund të kenë më shumë gjasa që ta ndryshojnë mbiemrin pas martesë, gjë që mund të çojë në mospërputhje midis dokumenteve të identifikimit, që kërkohej zakonisht në qendrat e votimit, dhe në të dhënat e tyre si zgjedhëse, në varësi të shkallës së harmonizimit të të dhënave të zgjedhësve dhe të dhënave

52 Neni 7 i KEDNG-së, <<https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-elimination-all-forms-discrimination-against-women>>, nenet 2, 3 dhe 25 të PNDKP-së, <<https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights>>.

53 Në sistemet e regjistrimit “pasiv”, autoritetet civile i përpilojnë listat e zgjedhësve në mënyrë automatike, duke u bazuar tek vendbanimi i zakonshëm dhe të dhënat e tjera, ndërsa në sistemet e regjistrimit “aktiv”, votuesit duhet të aplikojnë për të qenë në listat e zgjedhësve.

54 Shumë shtete me sisteme regjistrimi pasiv kanë edhe disa komponentë aktivë, si p.sh.: përfshirjen në disa mekanizma alternative votimi, të tilla si: votimi me pajisje elektronike ose votimi jashtë vendit, dhe mund t’i lejojnë votuesit që ta përditësojnë adresën e tyre elektorale duke vendosur një vendbanim të përkohshëm brenda vendit.

të popullsisë. Përditësimet e të dhënave të zgjedhësve duhet të jenë të lehta për t'u bërë dhe procedurat për ta bërë këtë përditësim duhet të bëhen të qarta gjatë edukimit të zgjedhësve nga OAZ-të.

Në sistemet e regjistrimit aktiv, kërkesat që duhet të përmbushin njerëzit për të vërtetuar se i përmbushin kriteret për të votuar duhet të jenë të arsyeshme dhe procedurat e regjistrimit duhet të jenë të aksesueshme. Detyrimet e panevojshme administrative, tarifatat për marrjen e dokumenteve personale për të demonstruar përmbushjen e kriterëve për të votuar apo vendndodhjet e paaksesueshme për t'u regjistruar mund të ndikojnë në mënyrë shpërpjesëtimore tek gratë. Numri i vizitave të nevojshme për t'u regjistruar dhe për të verifikuar regjistrimin, koha dhe distanca e udhëtimit për në zyra dhe kostot përkatëse, si dhe oraret e punës janë që të gjitha aspekte të rëndësishme për t'u marrë parasysh.

Duhet të merren në konsideratë edhe pengesat për regjistrimin e votuesve që rrezikojnë të prekin në mënyrë shpërpjesëtimore gratë. Për shembull, dokumentet e kërkuara mund të jenë të vështira e të lodhshme për t'u marrë dhe mund të kushtojnë, kurse disa dokumente mund të jenë nën kontrollin e bashkëshortëve ose të anëtarëve të tjerë të familjes. Regjistrimi pasiv i votuesve mund të verifikohet duke i bërë verifikimet vetëm me një anëtar të familjes, gjë që mund të rezultojë *de facto* në përjashtimin ose pamundësinë e disa grave për t'u regjistruar. Mund të ketë edhe pengesa burokratike për shkak të ndryshimeve të mbiemrit dhe adresës pas martese ose faktorëve të tjerë si nevoja për t'u paraqitur personalisht për t'u regjistruar. Gratë nga komunitetet e pakicave, përfshirë edhe gratë romë, mund të përballen me sfida specifike kur vjen puna tek regjistrimi i një adrese të ligjshme dhe aksesit në procedura administrative për të siguruar përfshirjen e tyre në regjistrat e zgjedhësve.

Është gjithashtu e rëndësishme që edukimi i zgjedhësve për regjistrimin të jetë pozitiv nga këndvështrimi gjinor, duke synuar gratë, veçanërisht ato që u përkasin grupeve të pafavorizuara. Niveli i regjistrimit mund të ulet edhe për shkak të pengesave për shkak të gjuhës ose nivelit të

arsimimit dhe kjo mund të ndikojë te gratë në mënyrë shpërpjesëtimore. Prandaj është e rëndësishme që materialet për edukimin e zgjedhësve të përshtaten për t'iu drejtuar këtyre grave. Po kështu, gratë që u përkasin grupeve të pakicave dhe gratë me aftësi të kufizuara kanë më shumë gjasa të rrezikohen të lihen pa përkrahje, kështu që mund të nevojitet një edukim i specializuar i zgjedhësve që ato të regjistrohen.

Për të vlerësuar nëse gratë regjistrohen si duhet, nevojiten të dhëna të ndara sipas gjinisë. Praktikë e mirë është që këto të dhëna të jenë të disponueshme sipas zonave zgjedhore në mënyrë që të mund të bëhen krahasime mes zonave dhe që të identifikohet çdo dallim mes zonave. Kur vlerësohet raporti i përgjithshëm i zgjedhësve gra të regjistruara, është e rëndësishme të merret parasysh përqindja e secilës gjini në popullatën në përgjithësi (e cila mund të mos jetë saktësisht 50:50). Në qendrat e votimit mund të përdoren teknologji për regjistrimin e zgjedhësve, si regjistrat elektronikë të zgjedhësve ose pajisjet e identifikimit të zgjedhësve, dhe në këtë rast OMZ-të duhet të përpqihen t'i përdorin këto teknologji për të mbledhur dhe për të siguruar të dhëna të ndara sipas gjinisë për pjesëmarrjen e votuesve.

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ A duket se raporti i grave dhe burrave në listën e zgjedhësve reflekton në përgjithësi përbërjen e popullsisë?
- ▶ Cili është burimi dhe cilësia e të dhënave të regjistrimit të votuesve dhe si kërkohen dhe mirëmbahen ndryshimet rutinë (p.sh.: ndryshimet e mbiemrit)?
- ▶ A ka zona zgjedhore ku gratë duket se janë më pak të përfaqësuar në listat e zgjedhësve? Nëse po, në çfarë rrethanash ndodh kjo?
- ▶ A ka mangësi apo pengesa sistematike në procesin e regjistrimit të zgjedhësve që janë të pafavorshme për gratë?

- ▶ A janë të vendosura në vende të përshtatshme zyrat e regjistrimit dhe a janë ato të hapura në orare të përshtatshme?
- ▶ A ka informacione për regjistrimin e votuesve që mund të gjenden lehtësisht nga gratë (për shembull, përfshirë edhe ato gra që nuk janë edhe aq të arsimuara)?
- ▶ A ka ndonjë pengesë, që lidhet me gjuhën apo me aftësinë për të lexuar dhe kuptuar, që ndikon në mënyrë shpërpjesëtimore në regjistrimin e grave në zgjedhje dhe si adresohen ato pengesa nga autoritetet?
- ▶ A ka tradita kulturore që priren të pengojnë regjistrimin ose pjesëmarrjen e grave? A marrin autoritetet ndonjë masë për tejkalimin e atyre traditave?
- ▶ A angazhohen në mënyrë aktive autoritetet, partitë politike, media dhe shoqëria civile në aktivitetet e edukimit për regjistrimin e votuesve, të cilat kanë si objektiv gratë?

F. CAKTIMI DHE REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

E drejta dhe mundësia për të kandiduar në zgjedhje duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim për shkak të gjinisë.⁵⁵ Me përjashtim të kandidatëve të pavarur, gratë që aspirojnë poste të zgjedhura varen nga partitë politike sa i përket propozimit si kandidate dhe mbështetjes gjatë fushatës dhe gjatë ushtrimit të detyrës. Janë partitë politike ato që përcaktojnë në masë të madhe si dhe kur gratë mund të bëhen aktore në arenën politike dhe në çfarë shkalle mund të ndodhë kjo. Prandaj është e rëndësishme që AVZ-të të vlerësojnë nëse partitë u ofrojnë

55 Dokumenti i Takimit të Kopenhagenit të Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të KSBE-së (Dokumenti i Kopenhagenit), OSBE, 29 qershor 1990, para. 7.5, neni 14, <<https://www.osce.org/odihr/elections/14304>>; vendimi i GJEDNJ-së në çështjen “*Staatkundig Gereformeerde Partij* kundër Holandës” <<https://hudoc.echr.coe.int/>>.

mundësi grave, nëse gratë janë në poste drejtuese në parti dhe nëse propozohen për të garuar si kandidatë.

Ndonjëherë kuadri ligjor kërkon që partitë të emërojnë një përqindje minimale kandidatësh gra dhe të miratojnë disa politika për pjesëmarrjen e grave brenda partisë dhe strukturave të saj vendimmarrëse, gjë që ndonjëherë lidhet me marrjen e fondeve publike ose të subvencioneve të caktuara. Zakonisht, partive u lihet diskrecion i konsiderueshëm për t'i përcaktuar vetë strukturat dhe procedurat e tyre të brendshme.⁵⁶ Në përgjithësi, sa më shumë që t'i respektojë një parti parimet demokratike dhe praktikat transparente në procedurat e saj të brendshme – gjë që është edhe më e rëndësishme kur partia merr fonde publike – aq më shumë mundësi duhet të ketë për gratë që të garojnë si kandidatë dhe, nga ana tjetër, aq më shumë mundësi që çështjet që përbëjnë shqetësim veçanërisht për gratë, të dalin si çështje serioze gjatë fushatës. Megjithatë, shumë shpesh, procedurat e brendshme partiake nuk kanë transparencë apo llogaridhënie të tillë.

Ka të dhëna që tregojnë se gratë kanë më shumë gjasa të propozohen për të kandiduar nga partitë me procedura të decentralizuara emërimi sesa nga partitë ku caktimi i kandidatëve bëhet nën një kontroll të fortë qendror.⁵⁷ Ndonjëherë partitë krijojnë degë, seksione ose grupe parlamentare të posaçme për gratë. Këto mund të jenë efikase, për shembull, për identifikimin e problemeve, për hartimin e politikave partiake që janë më të rëndësishme për zgjedhëset gra dhe për integrimin e tyre në programet politike të partive. Duhet të bëhen përpjekje për fuqizimin mjaftueshëm të këtyre strukturave për të shmangur rrezikun e izolimit të grave dhe skajimit të rëndësishëm të tyre brenda partisë.

Veç numrit të grave që një parti propozon si kandidatë, është e rëndësishme të merret në konsideratë nëse ato konkurrojnë në zona

56 Edhe pse nuk është e detyrueshme me ligj, është praktikë e mirë që gjatë ushtrimit të funksioneve të brendshme të partive politike t'ju respektohen parimet e mosdiskriminimit dhe të barazisë. Shih "Udhëzues i përbashkët për rregullimin e partive politike", *vep.cit.*, shënimi 44, para. 175.

57 "Udhëzues për promovimin e pjesëmarrjes së grave në partitë politike", ODIHR, 7 korrik 2014, <<https://www.osce.org/odihr/120877>>.

apo renditen në pozicione të tilla në listat e kandidatëve të partive, ku kanë mundësi reale “për të fituar”. Partitë fillimisht mund të propozojnë një listë të ekuilibruar nga këndvështrimi gjinor, por kjo listë mund të ndryshojë me tërheqjen ose me dorëheqjen e grave para ose pas ditës së zgjedhjeve. Kjo gjë është përdorur ndonjëherë për arsye strategjike, për shembull, kur partitë u kërkojnë kandidatëve që të dorëzojnë letrën e dorëheqjes të firmosur që para se t’i fusin në lista. AVZ-të duhet të vlerësojnë nëse ka të tilla praktika dhe nëse ato hehtohen menjëherë. Në vendet me sisteme votimi preferencial, në disa raste partitë mund të mos u japin kandidateve gra të njëjtin nivel mbështetjeje siç u japin kandidatëve të tyre meshkuj në lista. Në raste të tjera, partitë mund t’i inkurajojnë mbështetësit që t’i hedhin votat e tyre preferenciale për burrat që renditen më poshtë se gratë në lista.

Kërkesat për regjistrimin e kandidatëve që përfshijnë mbledhjen e një numri të madh firmash mbështetëse, depozitimin e një shume të konsiderueshme monetare, një kualifikim arsimor apo përkatësi partiake, mund të prekin në mënyrë shpërpjesëtimore gratë. Kjo vlen veçanërisht për vendet ku ka një hendek të madh mes pagave të grave dhe atyre të burrave. Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut ka vënë në dukje se: “personat që kanë gjithsesi të drejtën të kandidojnë në zgjedhje, nuk duhet të përjashtohen përmes kërkesave të paarsyeshme apo diskriminuese si ato që kanë të bëjnë me arsimimin, vendbanimin, prejardhjen apo edhe për shkak të përkatësisë politike”.⁵⁸ Çdo masë e veçantë në këtë drejtim (p.sh.: ulja e kërkesës për firma mbështetëse për kandidatet gra) duhet të vlerësohet për të parë se sa efektive është *de facto*. AVZ-të e ODIHR-it mund të përpiqen gjithashtu që të gjurmojnë çdo pabarazi gjinore në raportet e kandidatëve burra dhe gra të refuzuar nga autoritetet. Ato gjithashtu mund të përpiqen të shohin se si i ndihmojnë partitë politike aspirantët, për shembull, për mbledhjen e firmave ose depozitat monetare.

58 Komenti i Përgjithshëm 25 i OKB-së: E drejta për të marrë pjesë në çështjet publike, e drejta e votës dhe e drejta për akses të barabartë në shërbimin publik (neni 25), OSBE, 12 korrik 1996, para. 15, <<https://www.osce.org/odihr/elections/19154>>.

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ A e kërkon ligji apo ndonjë kuadër tjetër rregullator që partitë duhet të kenë gra në poste drejtuese apo duhet të kenë politika për pjesëmarrjen e grave brenda partive?
- ▶ A zbatohen në praktikë sanksione ndaj partive për mos-përmbushje të detyrimeve që lidhen me kandidimin dhe barazinë gjinore? A janë efikase sanksionet e vendosura?
- ▶ A mbliidhet në mënyrë qendrore informacioni për gratë në partitë politike dhe për politikën e partive sa i përket pjesëmarrjes së grave në politikë?
- ▶ A kanë partitë të dhëna të ndara sipas gjinisë për gratë brendapërbrenda partive? A përditësohet rregullisht ky informacion? Sa për qind e kryetarëve dhe anëtarëve të partive janë gra?
- ▶ A kanë partitë degë, seksione apo grupe parlamentare të posaçme për gratë? Sa efikase janë ato në promovimin e kandidateve gra?
- ▶ Cilat janë praktikat partiake për përzgjedhjen e kandidatëve dhe a duket se këto janë të favorshme apo të pafavorshme për kandidatet e mundshme gra? A kanë miratuar partitë kuota vullnetare për t'i promovuar gratë si kandidate?
- ▶ A vihen në jetë masa të veçanta që i inkurajojnë gratë të kandidojnë?
- ▶ A ndikojnë kriteret e kandidimit në mënyrë shpërpjesëtimore te gratë (p.sh.: kërkesat lidhur me arsimimin, firmat apo depozitat financiare)? A duket se këto kërkesa i pengojnë gratë të kandidojnë?

- ▶ A refuzohen kandidaturat e femrave më shpesh sesa ato të meshkujve? Cilat janë arsyet e refuzimeve?
- ▶ Sa gra garojnë si kandidatë dhe a mendohet se janë vendosur në zona zgjedhore/a renditen në pozicione të tilla në lista, ku kanë vërtet shanse për të fituar?
- ▶ A ka ndonjë parti që nuk ka emëruar asnjë grua apo që ka emëruar dukshëm më pak gra se burra? Nëse ekziston kushti ligjor për kuotën, a është respektuar dhe a është zbatuar ajo në praktikë?
- ▶ A ka zona elektorale ku nuk ka kandidatë gra?
- ▶ Sa për qind e kandidatëve të pavarur janë gra?
- ▶ A ka ndonjë program për rritjen e kapaciteteve/trajnimin apo a është marrë ndonjë masë tjetër për të mbështetur gratë që konkurrojnë si kandidatë?
- ▶ A janë më shumë si numër kandidatet gra, krahasuar me kandidatët burra, që tërhiqen nga kandidimi para apo pas ditës së zgjedhjeve? Cilat janë arsyet që jepen për këtë? Cila është procedura ligjore për zëvendësimin e kandidatëve gra që tërhiqen (p.sh.: a plotësohet vendi që ato lënë bosh me një tjetër kandidatë grua nga lista? Nëse ai mandat tashmë është përcaktuar, a i është dhënë ai mandat kandidatit të radhës në listën e partisë apo kandidatës tjetër grua në listë?)
- ▶ Sa të suksesshëm janë kandidatet gra dhe kandidatët burra në zgjedhje?

G. FUSHATA

Kornizat ligjore dhe rregullatore të fushatës mund të përfshijnë masa të veçanta për të mbështetur pjesëmarrjen e grave. Këto mund të përfshijnë burime të tjera financiare dhe/ose kohë transmetimi në media për kandidatet gra ose për partitë që nxjerrin përqindje më të larta të kandidateve gra. Përveç kësaj, partive mund t'u kërkohej që të kenë strategji se si i mbështesin gratë si kandidate dhe si i ndihmojnë zgjedhëset gra që të marrin vendime të mbështetura tek informacioni.

Partitë mund të kenë edhe politikat dhe strategjitë e tyre vullnetare për promovimin e pjesëmarrjes së grave. Këtu mund të përfshihet edhe ofrimi i një mbështetjeje më të madhe për kandidatet gra, angazhimi me zgjedhëset gra dhe përfaqësimi i partive nga gratë në aktivitetet e fushatës dhe në media. Krahas politikave të tilla, AVZ-të duhet të vëzhgojnë nëse gratë përfaqësohen në mënyrë efikase në mitingje – si pjesëmarrëse dhe si folëse, veçanërisht në aktivitetet më të mëdha dhe më të rëndësishme – dhe nëse partitë përfaqësohen nëpër intervista në media nga gratë, përfshirë edhe në programe që ndiqen nga një numër i madh njerëzish. Në AVZ-të ku ka vëzhgues afatgjatë, duhet të merret parasysh edhe prania dhe roli i grave në aktivitetet e fushatave, mënyra se si vihen në shenjë zgjedhëset gra në mesazhet e përcjella dhe përdorimi i retorikës gjinore ose seksiste nga folësit apo pjesëmarrësit.

Aftësia e kandidateve gra për të bërë fushata efikase mund të varet nga mbështetja dhe financimi që marrin në praktikë nga partitë, si dhe nga mbështetja e dukshme që marrin nga drejtuesit e partive. Mund të jetë veçanërisht e vështirë për gratë në vendet ku kandidatët pritet që t'i financojnë vetë fushatat e tyre e madje edhe të kontribuojnë në buxhetin e partive ku bëjnë pjesë. Është e rëndësishme që AVZ-të të takohen me kandidatet gra – jo vetëm me partitë që i kanë caktuar si kandidate – për të dëgjuar vetë drejtpërdrejt për sfidat specifike me të cilat përballen gratë dhe se si mbështeten ato në fushatat e tyre.

AVZ-të e ODIHR-it gjithashtu mund të shikojnë nëse informacioni i fushatës është i aksesueshëm për gratë ose nëse votueset gra përballen me vështirësi në pjesëmarrjen në veprimtaritë e fushatës, në mënyrë që ato

të arrijnë të marrin vendime të mbështetura tek informacioni se për kë të votojnë. Për shembull, mund të jetë më e vështirë për gratë të marrin pjesë në fushata nëse ka kosto të larta financiare ose nëse veprimtaritë nuk janë të përshtatshme për fëmijët. Aksesit ndaj informacionit mund të rritet duke transmetuar spote të fushatës në radio dhe televizion në oraret kur ka më shumë gjasa që të shihen apo të dëgjohen nga gratë. Është gjithashtu e dobishme që materialet e fushatave të vihen në dispozicion edhe në gjuhët e pakicave dhe në formate të lexueshme për gratë me nivel të ulët arsimimi. Në disa kultura, fushata derë më derë mund ta bëjë më të vështirë për gratë të bëjnë pyetje dhe të angazhohen, ndërsa në kontekste të tjera mund të rrisë aksesin.

Vëzhguesit mund të mbledhin pikëpamje mbi angazhimet përkatëse të partive ndaj votueseve gra dhe të rishikojnë programet politike. Për shembull, ata mund të shqyrtojnë nëse programet politike adresojnë papunësinë ose mospunësimin sa duhet të grave, boshllëqet e pagave, punëtorët e parregulluar në ekonominë informale, planifikimin familjar dhe shëndetin riprodhues, arsimin, shërbimet sociale, dhunën ndaj grave, subvencionet familjare dhe mundësitë e kujdesit për fëmijët. Marrëdhëniet e partive politike me grupet e të drejtave të grave mund të jenë gjithashtu një tregues i angazhimit dhe përkushtimit të tyre në avancimin e interesave të grave.

Gratë mund të frikësohen në mënyrë shpërpjesëtimore e të mos marrin pjesë në mitingjet ose veprimtaritë e tjera të fushatës në një mjedis konflikti dhe dhune. Dhuna e lidhur me zgjedhjet duhet parë nga një këndvështrim i gjerë, përfshirë edhe kanosjen, presionin dhe frikën nga hakmarrja.⁵⁹ Çdo incident duhet të dënohet, përfshirë edhe nga zyrtarët e lartë dhe udhëheqësit e partive, dhe duhet të hetohet menjëherë. AVZ-të duhet të raportojnë për çdo mekanizëm me qëllim frenimin e praktikave të tilla.

Efektet e dëmshme të fushatave dhe retorikave negative mund të jenë veçanërisht të theksuara për kandidatet gra. Për shembull, komentet mund të jenë komente të bazuara te gjinia e kandidatëve, duke u

59 Shih Dokumentin e Kopenhagenit, *vep.cit.*, shënimi 55, paragrafi 7.7.

fokusuar te pamja e jashtme e kandidateve gra ose tek tipare të tjera personale dhe jo te thelbi i platformave të tyre apo te statusi i tyre profesional. Duke pasur parasysh kostot më të ulëta që kanë rrjetet sociale, këto të fundit mund të ofrojnë mundësi të shkëlqyera për të bërë fushatë. Megjithatë bërja e kërkimeve në rrjetet sociale mund të kërkojë më shumë ekspertizë teknologjike dhe më shumë aftësi të komunikimit përmes mjeteve dixhitale dhe mund të rrisë rrezikun e retorikës negative.

Dhuna kibernetike ndaj kandidateve gra mund të marrë forma të ndryshme, përfshirë edhe ngacmimet, bulizmin, bulizmin nga turma, postimin e materialeve pamore intime pa dhënien e pëlqimit, postimin dhe ndarjen me të tjerë të përmbajtjes së dhunshme, kërcënimet me vdekje dhe përdorimin e komenteve seksuale ose fyese dhe të imazheve ose videove nënçmuese/të modifikuara (p.sh.: thellësisht të falsifikuara aq sa duken si origjinale).⁶⁰ Veprime agresive dhe frikësuese si këto prekin dinjitetin e grave dhe mund edhe t'i pengojnë kandidatet gra që t'i shprehin lirisht pikëpamjet e tyre. Prandaj është e rëndësishme që AVZ-të e ODIHR-it, nëpërmjet monitorimit të fushatave të zhvilluara përmes internetit dhe takimeve me kandidatët, të identifikojnë nëse ndodhin të tilla incidente, të shohin sa ankesa janë depozituar pranë agjencive ligjzbatuese dhe të kuptojnë se çfarë masash po merren për zbutjen e akteve të tilla dhe si po trajtohen shkeljet e ndryshme nga autoritetet dhe rrjetet sociale.⁶¹

Gjuha e urrejtjes i referohet zakonisht formave të shprehjes që motivohen nga armiqësia dhe demonstrojnë ose inkurajojnë armiqësi ndaj një grupi ose një individi për shkak të përkatësisë së tij në atë grup.⁶² Për t'iu

60 Në Vendimin nr. 4/18 të Këshillit Ministror, *vep.cit.*, shënimi 12, u bëhet thirrje shteteve pjesëmarrëse që “të inkurajojnë të gjithë aktorët përkatës... që të kontribuojnë në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave, përfshirë edhe ndaj grave të angazhuara në aktivitete profesionale të ekspozuara në publik dhe/ose në interes të shoqërisë”.

61 Rekomandimi CM/Rec(2019)1 për parandalimin dhe luftimin e seksizmit, KIE, 27 mars 2019, <<https://rm.coe.int/cm-rec-2019-1e-sexism/1680a217ca>>.

62 Për gjuhën e urrejtjes nuk ka ndonjë përkufizim ndërkombëtar. Megjithatë disa elemente mund të gjenden në instrumente universale si, për shembull, në nenin 19 të KNDCP-së për lirinë e mendimit dhe të shprehjes, *vep.cit.*, shënimi 52. Po kështu, edhe në nenin 20 të KNDCP-së, i cili thotë: “Çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare, që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë, duhet të ndalohet me ligj”. Neni 4 i Konventës Ndërkombëtare për

kundërvënë një retorike të tillë, autoritetet duhet të balancojnë lirinë e shprehjes me mbrojtjen e të drejtave të tjera, duke lejuar shprehjen e ligjshme të opinioneve dhe pikëpamjeve që mund të jenë ndonjëherë të kundërshtueshme. Në shoqëritë demokratike zakonisht nuk inkurajohet vendosja e kufizimeve ndaj lirisë së shprehjes. Megjithatë mund të nevojitet marrja e disa masave përpjesëtimore ndaj deklaratave provokuese gjatë zgjedhjeve, që mund të vënë në rrezik jetën e kandidatëve gra.⁶³ Gjithashtu, AVZ-të mundet të vlerësojnë edhe mënyrën se si reagohej gjithashtu ndaj gjuhës nënçmuese dhe retorikës intolerante ndaj grave. Për shembull, a i kundërshtojnë strukturat drejtuese të partive dhe mediat raste të tilla dhe a i monitoron shoqëria civile këto çështje?

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ A është marrë ndonjë masë nga shteti për të mbështetur të bërit fushatë nga kandidatet gra?
- ▶ Deri në çfarë mase trajtohen në platformat partiake pjesëmarrja politike e grave dhe çështjet me interes të veçantë për gratë? A përfshihen në platformat e fushatës çështjet e barazisë gjinore dhe “çështjet e grave”? Cila është retorika e fushatës rreth çështjeve gjinore dhe grave?

Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial në të cilin shtetet palë të traktatit zotohen “të shpallin vepra të dënueshme me ligj çdo përhapje të ideve të bazuara në epërsinë ose urrejtjen racore, çdo nxitje për diskriminim racial, si dhe çdo akt dhune ose provokim për kryerjen e akteve të kësaj natyre kundër çdo race ose grupi personash të një ngjyre ose origjine tjetër etnike, si dhe ndihmën e veprimeve raciste, përfshirë këtu edhe financimin e tyre”.

- 63 Në çështjen “Lopes Gomes da Silva kundër Portugalisë”, GJEDNJ, 28 dhjetor 2000, <<https://hudoc.echr.coe.int/>>, GJEDNJ-ja ritheksoi se: “[L]iria e shprehjes përbën një nga themelet e domosdoshme të një shoqërie demokratike” dhe se ajo “gjen zbatim jo vetëm për ‘informacione’ ose për ‘idetë’ që priten në mënyrë të favorshme ose që konsiderohen si jofyese ose si çështje indiference, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin apo shqetësojnë”. Ajo më tej theksoi se: “caqet e kritikës së pranueshme... janë më të gjera kur bëhet fjalë për politikanë, që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre publike” dhe që “në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije ekspozohen ndaj një analize të hollësishtme të çdo fjale apo akti të tyre nga ana e gazetarëve dhe publikut në përgjithësi”.

- ▶ Çfarë lloj mbështetjeje u japin partitë kandidateve gra? Mbështetje financiare? Trajnim se si të bëjnë fushatë efektive? Mbështetje të dukshme nga strukturat drejtuese të partive? Lloje të tjera mbështetjeje?
- ▶ A i promovojnë partitë gratë në angazhimin e tyre publik, për shembull, në diskutimet në media, në mitingje dhe në materialet e fushatave?
- ▶ A arrijnë zgjedhëset gra që të informohen plotësisht dhe të marrin pjesë në aktivitetet e fushatave në mënyrë që të mund të bëjnë zgjedhje të mbështetura tek informacioni? A ndihen zgjedhëset gra të sigurta që të marrin pjesë në veprimtari/mitingje të fushatave?
- ▶ Si e bëjnë fushatën gratë (p.sh.: përmes mitingjeve, televizionit, vizitave derë më derë, përmes internetit etj.) dhe a ndryshon mënyra se si e bëjnë ato fushatën nga ajo e kandidatëve burra? A përballen kandidatet gra edhe me ndonjë sfidë tjetër shtesë?
- ▶ A janë kandidatet gra objekt ngacmimesh dhe dhune përmes internetit? A adresohen në kuadrin ligjor dhe rregullator problemet dhe shkeljet që ndodhin përmes internetit? A marrin rrjetet sociale dhe organet rregullatore masa paraprake për të adresuar ndonjë problem?

H. FINANCIMI I FUSHATËS

Analizat e AVZ-ve duhet të fokusohen kryesisht te mënyra se si e rrit korniza ligjore për financimin e fushatave transparencën dhe integritetin e proceseve zgjedhore, si dhe nëse ai kuadër nxit një fushë loje në kushte të barabarta për garuesit, që i vendos kandidatet gra në pozita të barabarta *de jure* dhe *de facto*.

Në të gjithë rajonin e OSBE-së, ka shembuj të financimeve të partive politike nga buxheti i shtetit që kanë pjesërisht si kusht nxitjen e barazisë gjinore gjatë zgjedhjeve dhe, ndonjëherë, edhe brendapërbrenda partive. Kjo mund të bëhet përmes stimujve – duke u dhënë, për shembull, më shumë fonde publike partive që kanë një përqindje të caktuar kandidatësh gra – ose, nga ana tjetër, përmes uljes së financimit kur partitë nuk kanë në lista një përqindje të mjaftueshme kandidatësh gra. Fonde publike mund të caktohen edhe për aktivitete specifike të fushatave lidhur me nxitjen e barazisë gjinore. Të tjera masa janë dispozitat për lehtësime tatimore, kujdesi falas për fëmijët ose një fond qendror aksesueshmërie për të lehtësuar pjesëmarrjen e grave me aftësi të kufizuara, që mund të përballen me kosto shtesë kur kandidojnë për poste të caktuara në zgjedhje.

Pa financime publike, barra e financimit bie tek mbështetja financiare e partive dhe tek financimi nga pasuritë personale të kandidatëve dhe nga kapacitetet e tyre për të mbledhur fonde. Kjo mund të jetë veçanërisht e pafavorshme për gratë, të cilat zakonisht kanë më pak para dhe rrjete më të dobëta mbështetëse në fillimet e tyre. Në përgjithësi gratë priren të mos jenë aq të integruara në rrjetet tregtare, profesionale dhe sociale që zakonisht shërbejnë si burime kryesore të fondeve të fushatës, si në politikën në shkallë kombëtare ashtu edhe në shkallë vendore.⁶⁴ Tek aftësitë e kandidateve gra për të thithur fonde gjatë fushatave zgjedhore mund të ndikojnë në mënyrë shpërpjesëtimore edhe disa faktorë të tjerë socialë, si niveli i arsimimit, aftësitë dominuese gjuhësore, mosha dhe gjendja familjare.

Partitë mund të aplikojnë edhe politika të brendshme që nuk përbëjnë disavantazh për personat që kanë akses të kufizuar në fondet e fushatave gjatë përzgjedhjes dhe propozimit të kandidatëve. Kjo vlen veçanërisht për gratë, pasi shpesh ato kanë status më të ulët ekonomik dhe më pak mundësi se burrat. Partitë mund të ofrojnë edhe më shumë mbështetje financiare për fushatat e kandidateve gra dhe t’u japin edhe më shumë fonde kandidateve gra krahasuar me atë që marrin

64 Julie Ballington, “Barazia gjinore në financimin e partive politike”, *International IDEA*, 16 dhjetor 2003, <<https://www.idea.int/news-media/media/gender-equality-political-party-funding>>.

homologët e tyre burra. Kjo mund të jetë e nevojshme për t'u dhënë grave *de facto* mundësi të barabarta për të bërë fushata si duhet dhe për të pasur sukses të sigurt në zgjedhje. Partitë mund të organizojnë edhe trajnime për mbledhje fondesh dhe për financimin e fushatave për kandidatet gra, veçanërisht për ato që kandidojnë për herë të parë. Procedurat transparente të partive mund të tregojnë nëse shpërndarja e burimeve të fushatës është e barabartë dhe/ose nëse ndihmon në krijimin e kushteve më të barabarta të konkurrencës për kandidatet gra.

Mund të jetë veçanërisht e dobishme për kandidatet gra që të gjithë kandidatëve t'u vendoset një shumë tavan shpenzimesh, për të promovuar kështu kushte të barabarta konkurrence, duke qenë se gratë shpesh kanë më pak akses në fonde.⁶⁵ Pa kufizime të tilla, kandidatët e pasur (zakonisht burra) mund të shpenzojnë shuma të mëdha parash, duke ua bërë më të vështirë grave konkurrimin. Megjithatë, që të ndihmojë vërtet, kjo duhet që të zbatohet në praktikë në mënyrë të efektshme.

Ndihmon edhe nëse raportet për financimin e fushatës, që përgatisin dhe dorëzojnë organet mbikëqyrëse, mund të ofrojnë informacione të ndara sipas gjinisë, në mënyrë që të shihet shkalla e disavantazheve financiare me të cilat përballen gratë. Këto informacione mund të tregojnë mbështetjen e dhënë nga partitë, nivelin e fondeve të mbledhura nga kandidatet gra, pikat e forta dhe të dobëta të partive në mbështetjen e kandidateve gra, nevojën e vazhdueshme për mbështetje shtesë për kandidatet gra, si dhe nëse rekomandohet ndonjë përmirësim.

65 Komenti i Përgjithshëm 25 për nenin 25 të KNDCP-së, HN HRC, 12 korrik 1996, CCPR/C/21/Rev. 1/Add.7, <<https://www.refworld.org/docid/453883fc22.html>>, parashikon kufizime të arsyeshme të shpenzimeve të fushatës “aty ku këto kufizime janë të nevojshme për t'u siguruar që të mos cenohet zgjedhja e lirë e votuesve apo që procesi demokratik të mos shtrembërohet nga shpenzimet shpërpjesëtimore në emër të ndonjë kandidati apo të ndonjë partie.” Shih gjithashtu “Udhëzim i përbashkët për rregullimin e partive politike”, *vep.cit.*, shënimi 44, paragrafi 196.

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ Nëse për fushatat jepen fonde publike, a ka ndonjë detyrim për promovimin e grave dhe nxitjen e barazisë gjinore? A ka ndonjë detyrim që duhet përmbushur si kusht për t'u kualifikuar për marrjen e fondeve publike dhe që mund të jetë i vështirë për t'u përmbushur nga kandidatet gra? A janë marrë masa të tjera nga shteti, nga të cilat përfitojnë veçanërisht kandidatet gra?
- ▶ A ka të dhëna të ndara sipas gjinisë për financimin dhe për shpenzimet e kandidatëve burra dhe gra? Nëse po, a monitorohet kjo nga ndonjë organ shtetëror apo nga ndonjë organizatë tjetër? A marrin dhe shpenzojnë kandidatet gra shuma të krahasueshme me kandidatët burra? Si shpjegohet ky dallim?
- ▶ A duket se gratë kanë më shumë vështirësi se burrat në sigurimin e fondeve për fushatë (përfshirë edhe kandidatët e pavarur)?
- ▶ A kanë miratuar partitë politike brendapërbrenda tyre ndonjë masë për mbështetjen e financimit të kandidateve gra?
- ▶ A kanë prezantuar partitë politike procedura të drejta dhe transparente për shpërndarjen e barabartë të fondeve publike ose partiake mes kandidatëve (gra dhe burra)? A përfshin kjo edhe shpërndarjen e financimeve publike ose partiake të tërthorta, si aksesin në kohën e transmetimeve dhe në burimet e medias apo përdorimin e ambienteve ose burimeve të vetë partisë për fushatë?
- ▶ A ka ndonjë kufi për shpenzimet e kandidatëve për fushatë? A respektohet ai kufi në praktikë? Si ndikon kjo tek kandidatët burra dhe tek kandidatet gra?

I. MEDIA

Angazhimet e OSBE-së për zgjedhjet e bëjnë të detyrueshëm aksesin pa diskriminim në media për të gjitha grupet politike dhe individët që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor.⁶⁶ Masat e përkohshme të posaçme, siç përmendet në KEDNG, mund të përfshijnë dhënien e një kohe transmetimi shtesë në media kandidatëve gra ose ofrimin e disa objektivave ose garancive për mbulim të barabartë në media të veprimtarisë zgjedhore. Instrumentet ndërkombëtare u referohen mediave shtetërore që kanë për detyrë të mbulojnë veprimtarinë zgjedhore të kandidatëve dhe programet e tyre politike në mënyrë të barabartë dhe të paanshme, pavarësisht nga gjinia e tyre.⁶⁷

Analiza e grave dhe e medias gjatë zgjedhjeve përfshin shqyrtimin e disa elementeve të ndryshme. Këtu përfshihet identifikimi i çfarëdo kërkesë ligjore ose mase vullnetare që media të promovojë pjesëmarrjen e grave në politikë, monitorimi i raportit dhe natyrës së mbulimit në media të veprimtarisë zgjedhore të kandidatëve gra krahasuar me kandidatët burra, përfshirja e grave si opinioniste për çështje politike dhe zgjedhore, si dhe përvojat e gazetareve gra që mbulojnë fushatat zgjedhore dhe veprimtarinë zgjedhore të politikanëve. Përveç monitorimit nga vetë ODIHR-i, AVZ-të duhet të shohin nëse bëhet ndonjë monitorim nga organet rregullatore ose nga shoqëria civile lidhur me aksesin në media të kandidatëve gra dhe mbulimin në media të veprimtarisë së tyre zgjedhore.

Në vende të ndryshme kanë lindur vazhdimisht një sërë çështjesh që lidhen me përfaqësimin më pak të grave në media. Kandidatet gra mund të zënë më pak vend në media sesa homologët e tyre burra kur bëhet fjalë për qëndrimet e tyre politike në lidhje me politikat e ndryshme, por më shumë kur bëhet fjalë për karakteristikat vetjake

66 Dokumenti i Kopenhagenit, *vep.cit.*, shënimi 55, pika 7.8, parashikon që shtetet duhet të sigurojnë akses të barabartë dhe trajtim objektiv të garuesve në zgjedhje në të gjitha programet e mediave shtetërore.

67 Shih gjithashtu Rekomandimin (2013)1 të Komitetit të Ministrave për barazinë gjinore dhe median, Këshilli i Evropës, vizituar më 3 tetor 2022, Udhëzues A1, B4, <<https://go.coe.int/OWWun>>.

dhe pamjen e tyre të jashtme. Kandidatet gra mund të përballen me stereotipizimin gjinor; me portretizimin e grave në rolet e tyre tradicionale si bashkëshorte dhe si nëna. Atyre mund t'u drejtohen vetëm pyetje që “u takojnë grave” dhe të mos shihen vërtet si figura që mund të japin opinione të rëndësishme për një gamë të gjerë temash.⁶⁸ Lidhur me përfaqësimin më pak në media të grave në mbulimin e veprimtarisë së tyre zgjedhore, mediat shpesh ua vënë fajin partive ose subjekteve të tjera që nuk zgjedhin të nxjerrin gra mjaftueshëm nëpër intervista dhe që kanë një numër më të ulët kandidatësh gra. Megjithatë grupet për të drejtat e grave shpesh pohojnë se burimet mediatike duhet të jenë më vigjilente dhe më këmbëngulëse sa i takon ekuilibrit gjinor. Prandaj AVZ-të e ODIHR-it mund të shohin nëse burimet mediatike e kultivojnë pranimin publik të grave si një tipar normal të jetës politike dhe nëse ato i paraqesin gratë në një mënyrë të tillë që nxit besim te kapacitetet e tyre si drejtuese politike.

Analistët e medias bëjnë vlerësime cilësore të çështjeve gjinore, duke i parë ato në kuadrin e angazhimeve të OSBE-së dhe angazhimeve të tjera ndërkombëtare, dhe mund të bëjnë edhe analiza të tjera sasiore për mbulimin në media të veprimtarisë zgjedhore të grave përmes monitorimit të medias. Kjo mundëson analizimin e masës në të cilën është pasqyruar në media veprimtaria zgjedhore e kandidateve gra në krahasim me kandidatët burra, si dhe të ndryshimeve mes tyre sa i përket tonit dhe arsyeve të mbulimit të veprimtarisë zgjedhore. Monitorimi i medias mund të përdoret edhe për të vlerësuar nëse gratë kanë më pak gjasa të dalin si të ftuara apo si opinioniste në programet politike kryesore. Analistët e medias mund të jenë në gjendje të shohin edhe se sa përpjekje bëhen për edukimin e zgjedhësve, duke iu drejtuar posaçërisht grave, dhe të identifikojnë raste të retorikave kanosëse ndaj gazetareve gra, përfshirë edhe politikanet gra.

68 Një studim i Këshillit të Evropës mbi barazinë gjinore dhe zgjedhjet, “Media, zgjedhjet dhe barazia gjinore”, CoE DGI(2017)10, prill 2018, <<https://rm.coe.int/gender-equality-and-elections-/16807c0e23>> tregon se “prania e grave mbetet shumë prapa në pasqyrimin e politikës dhe se temat, që konsiderohen si ‘tema të vështira’, vazhdojnë të shihen si tema për burrat dhe të perceptohen si të tilla nga opinioni publik dhe nga zgjedhësit”.

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ A ka kërkesa ligjore në lidhje me mbulimin e veprimtarisë zgjedhore të grave në media (në përgjithësi apo veçanërisht gjatë zgjedhjeve)? Nëse po, a ka ndonjë mekanizëm efektiv për plotësimin e atyre kërkesave?
- ▶ A kanë burimet mediatike të financuara nga buxheti i shtetit ose mediat private politika në lidhje me promovimin e grave në përgjithësi apo për zgjedhjet në veçanti? A zbatohen si duhet ato politika?
- ▶ A parashikohen masa të veçanta shtesë (p.sh.: kohë/hapësirë shtesë për kandidatet gra)?
- ▶ A duket se burimet mediatike/mediat e shkruara i rrënjosin edhe më shumë stereotipat tradicionale, duke u fokusuar te pamja dhe roli i grave në familje si bashkëshorte dhe nëna?
- ▶ A ka kandidatë burra/drejtues partish politike ose aktorë të tjerë (si, për shembull, gazetarë) që përdorin komente seksiste dhe stereotipizmin kur flasin për kandidatet gra gjatë debateve?
- ▶ A bëhet ndonjë monitorim nga organet rregullatore apo nga shoqëria civile për aksesin dhe mbulimin e veprimtarisë zgjedhore të grave në media?
- ▶ A ka në dispozicion të publikut të dhëna të ndara sipas gjinisë (p.sh.: mbi përqindjen e mbulimit në media të veprimtarisë zgjedhore të kandidatëve burra dhe të kandidatëve gra)? A ka ndonjë analizë të dukshmërisë dhe portretizimit të grave në media (veçanërisht në lajmet kryesore dhe në programet me tema nga aktualiteti)? A marrin veprimtaritë e kandidateve gra mbulim sasior dhe cilësor

të krahasueshëm me mbulimin në media të veprimtarisë zgjedhore të kandidatëve burra në pozita të ngjashme politike?

- ▶ A tregojnë burimet mediatike ekuilibër gjinor në përzgjedhjen e të intervistuarve dhe të panelistëve, që komentojnë procesin zgjedhor? Çfarë hapash po ndërmerren për të promovuar një ekuilibër të tillë gjinor?
- ▶ A ka reklama politike që u drejtohen veçanërisht zgjedhësve gra? Në cilat çështje fokusohen ato?
- ▶ A bëhet ndonjë përpjekje për edukimin e zgjedhësve apo për informimin e tyre, duke synuar veçanërisht gratë? Cila është përmbajtja e këtyre mesazheve?
- ▶ Si ndihen kandidatet gra të trajtuara nga media? A iu duket se mbulimi i veprimtarisë së tyre zgjedhore në media nuk është objektiv?

J. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE ZGJEDHORE

Kuadri ligjor duhet të parashikojë parimin e barazisë përpara ligjit, përfshirë edhe aksesin e barabartë në mjetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore, pavarësisht nga gjinia.⁶⁹ Megjithatë gratë shpesh janë në pozitë të pafavorizuar në praktikë. Ndonjëherë gratë nuk i njohin mjaftueshëm të drejtat e tyre dhe mund të jenë të pafavorizuara duke pasur më pak burime financiare në dispozicion për të paguar për kërkesat për zgjidhje ligjore. Për shembull, procedurat për paraqitjen e ankesave ose apelimeve, që kërkojnë që të udhëtosh ose që të paguash një tarifë depozitimi, mund të jenë më shumë pen-

69 Neni 26 i KNDCP-së-së thotë se: “Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi”, *vep. cit.*, shënimi 52.

gesë për gratë në shoqëritë ku gratë kanë më pak burime financiare ose ku ato përballen me pabarazi të konsiderueshme në të ardhura. Prandaj aksesit në zgjidhjet ligjore të mosmarrëveshjeve zgjedhore dhe politikave shtetërore për ndihmën juridike mund të vlerësohet nga vëzhguesit e ODIHR-it.⁷⁰

AVZ-të e ODIHR-it mund të shqyrtojnë nëse proceset e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore janë po aq të arritshme dhe efikase për gratë sa edhe për burrat që paraqesin ankese apo kërkesa. Ata gjithashtu mund të vlerësojnë nëse ka edhe procedime (*ex officio* ose procedime që iniciohen në vijim të një ankese) kryesisht kur janë kryer shkelje zgjedhore dhe nëse ka ndonjë pabarazi në mënyrën se si trajtohen ato. Vlen të shikohet edhe përbërja e organeve që i dëgjojnë rastet e mosmarrëveshjeve zgjedhore nga perspektiva e barazisë gjinore. Të dhënat e ndara sipas gjinisë për ankesat mund të japin ndonjë tregues se sa i aksesueshëm është sistemi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore (ZMZ) për burrat dhe për gratë.

AVZ-të e ODIHR-it duhet t'i kushtojnë vëmendje çdo ankese për trajtimin e pabarabartë të grave. Disa shembuj janë shkelja e kuotave gjinore për listat e kandidatëve, pabarazia në administratën zgjedhore, aksesit i pabarabartë në mundësitë e fushatës, kanosja ose pakësimi i aksesit në media. Reagimet e institucioneve duhet të vlerësohen për të parë nëse mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore ofrojnë apo jo zgjidhje domethënëse dhe masa korrigjuese të barabarta. AVZ-të e ODIHR-it duhet të vlerësojnë nëse këto ankese trajtohen në të njëjtën mënyrë si ankesat dhe apelimet e tjera që nuk kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Ato gjithashtu mund të marrin parasysh edhe arsyet e dhëna përse gratë kanë zgjedhur të mos i parashtrojnë ankesat e tyre në mënyrë zyrtare.

70 Shih gjithashtu “Udhëzues për vëzhgimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore”, OSBE/ODIHR, 17 shtator 2019, Seksioni 5.A, <<https://www.osce.org/odihr/elections/429566>>.

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ A ka ndonjë pengesë ligjore apo praktike që gratë të kenë qasje në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe në mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore në veçanti?
- ▶ A shihen proceset e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore si njëloj të arritshme dhe efikase kur kërkueset janë gra?
- ▶ Brenda kontekstit zgjedhor, a ka pasur raste të kohëve të fundit apo raste aktuale të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore që përfshijnë trajtimin e pabarabartë të grave? Nëse po, cilat kanë qenë çështjet kryesore? Nëse është zgjidhur tashmë një rast i tillë, cili ka qenë rezultati?
- ▶ A është i balancuar nga këndvështrimi gjinor organi që trajton ankesat?
- ▶ A ka të dhëna të ndara sipas gjinisë për ankesat dhe apelimet?
- ▶ A është shprehur ndonjë shqetësim për trajtimin e pabarabartë të grave në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore? Nëse po, a janë paraqitur ankesa dhe kërkesa? Nëse jo, pse jo?

K. DITA E ZGJEDHJEVE

Çdo pengesë për pjesëmarrjen në ditën e zgjedhjeve mund të ndikojë veçanërisht në aftësinë e grave për të votuar dhe duhet të raportohet nga AVZ-të. Për shembull, distancat e gjata për në qendrat e votimit mund të jenë më shumë pengesë për gratë nëse ato kanë përgjegjësinë e kujdesit për fëmijët ose përgjegjësi të tjera të kujdesit, nëse janë shtatzënë dhe/ose nëse janë në gjendje më të vështirë social-ekonomike. Po

kështu, qëndrimi në radhë për një kohë të gjatë për të votuar mund ta bëjë më të vështirë pjesëmarrjen e grave. Mjediset kanosëse apo të dhunshme veçanërisht mund të frenojnë shkuarjen e grave në qendrat e votimit. Po kështu, turmat shumë të mëdha ose mjediset kaotike mund të jenë dekurajuese në veçanti për gratë, duke bërë që të mos shkojnë të votojnë. Kërkesat për identifikimin e votuesve mund të rëndojnë në mënyrë shpërpjesëtimore te gratë dhe sidomos te gratë që u përkasin grupeve të pafavorizuara. Për shembull, gratë rome dhe sinti mund të preken më shumë nga këto kërkesa për shkak të mosregjistrimit të tyre në zyrën e gjendjes civile. Për të parë se si dhe sa ndikojnë të gjitha këto, mund të duhen të dhëna për pjesëmarrjen në votime të ndara sipas gjinisë. Këto të dhëna duhet të zërthehen edhe gjeografikisht në mënyrë që të mund të identifikohen problemet në zona specifike.

Paragrafi 7.4 i Dokumentit të Kopenhagenit i angazhon shtetet që “të marrin masa që votat të hidhen në mënyrë të fshehtë ose me një procedurë ekuivalente me votimin e lirë”. Një abuzim që ndodh shpesh me fshehtësinë e votës është “votimi familjar” ose “votimi në grup”, i cili është ende një praktikë relativisht e zakonshme në disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Kjo përfshin futjen në të njëjtën kabinë të dy ose më shumë personave që shënojnë në fletët e votimit së bashku. Ose hedhjen e votave në kutinë e votimit nga kryefamiljari, që zakonisht është burrë që voton në emër të anëtarëve të tjerë të familjes. Këto praktika shpesh janë më të zakonshme në zonat rurale, me popullsi më pak të arsimuar dhe janë veçanërisht të pafavorshme për gratë. Votimi i deleguar, kur një person paraqet dokumente për një person tjetër dhe voton në emër të tij, është rregulluar me ligj në disa shtete, por të dhënat për aplikimin e tij ndonjëherë kanë treguar pabarazi gjinore. Edhe votimi i hapur, gjatë të cilit shënimi në fletët e votimit bëhet jashtë qendrave të votimit, qartësisht në sy të të tjerëve, rrezikon fshehtësinë e votës dhe mund të pengojë veçanërisht gratë që të votojnë për atë që zgjedhin vetë. Një tjetër fushë shqetësuese mund të jetë edhe rasti kur ka një numër të lartë grash që kërkojnë ndihmë për të votuar, gjë që mund të vihet në pikëpyetje nëse vërtet kanë nevoja për ndihmë.

Shumë vende kanë dispozita për metodat alternative të votimit (MAV-të) që synojnë të lehtësojnë votimin ose të mundësojnë votimin për

qytetarët që, për çfarëdolloj arsyeje, mund të mos jenë në gjendje të shkojnë personalisht në qendrën e votimit. MAV-të mund të përfshijnë votimin në qendra të lëvizshme, votimin me postë ose votimin elektronik.⁷¹ Kur futen dhe përdoren mekanizma të tillë, duhet të merren masa mbrojtëse ligjore dhe procedurale dhe duhet të ketë besim tek masat e marra. E mira është që të bëhet edhe një vlerësim i ndikimit që kanë këto metoda nga këndvështrimi gjinor për të parë nëse ka ndonjë problem të veçantë që lidhet me përdorimin e këtyre metodave nga gratë; konkretisht, për të parë nëse ato janë apo jo të pafavorshme dhe çfarë masash nevojiten për të promovuar përdorimin e barabartë dhe legjitim të MAV-ve nga gratë, siç janë masat mbrojtëse shtesë dhe edukimi. Hetimi i hollësishëm i rasteve të keqpërdorimit të MAV-ve dhe një vlerësim se si kanë ndikuar këto metoda veçanërisht tek zgjedhëset gra mund të kontribuojnë për të pasur besim më të madh te proceset zgjedhore. Duhet të vendoset ekuilibri ndërmjet bërjes së votimit më të aksesueshëm dhe garantimit të integritetit të procesit.

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ A ka në dispozicion të publikut të dhëna të ndara sipas gjinisë që nga dita e votimit - mbi numrin e zgjedhësve të regjistruar burra dhe gra, përfaqësuesve, vëzhguesve dhe pjesëmarrjen në votime?
- ▶ A është procesi i votimit i aksesueshëm për gratë? A është marrë ndonjë masë shtesë për të ndihmuar gratë të votojnë?
- ▶ A është e arsyeshme distanca për në qendrat e votimit? A ka radhë të gjata në qendrat e votimit?
- ▶ A është e përcaktuar fshehtësia e votimit në legjislacion/rregullore? A ka probleme lidhur me fshehtësinë e votimit

71 Shih edhe “Metodat dhe masat alternative të votimit”, OSBE/ODIHR, 12 tetor 2020, <<https://www.osce.org/odihr/elections/466794>>.

që prekin në mënyrë shpërpjesëtimore gratë? A është i ndaluar votimi familjar/votimi në grup/votimi i deleguar? A ka probleme lidhur me votimin familjar/votimin në grup/votimin e deleguar që prekin gratë?

- ▶ Sa për qind e personelit të qendrave të votimit, vëzhguesve qytetarë dhe përfaqësuesve të partive/kandidatëve janë gra?
- ▶ A është lehtësisht i aksesueshëm për gratë informacioni për procedurat e votimit?
- ▶ A ka MAV-ë, të tilla si: votimi nga pajisje celulare, votimi me postë apo votimi elektronik? Nëse po, a paraqesin këto metoda sfida të veçanta për zgjedhëset gra (p.sh.: a mbrohet fshehtësia e votës në votimin me postë dhe a kanë gratë akses ndaj informacionit mbi këto mekanizma njësoj si burrat)? A ka garanci të mjaftueshme ligjore dhe procedurale për përdorimin e MAV-ve me qëllim pakësimin e mundësive për keqpërdorim? A ka pasur një rishikim të ndikimeve të MAV-ve nga këndvështrimi gjinor?



KAPITULLI 3

DHUNA NDAJ GRAVE NË ZGJEDHJE

Ka tashmë një ndërgjegjësimit gjithnjë e më të madh sa i takon dhunës me të cilën mund të përballen gratë si pjesëmarrëse në proceset zgjedhore, ndërsa pranohet gjithnjë e më shumë se aktet e dhunës ndaj grave në zgjedhje nuk raportohen mjaftueshëm. Në raportin e saj për vitin 2018 në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, Raportuesja e Posaçme e OKB-së për Dhunën ndaj Grave deklaroi se: “Si burrat ashtu edhe gratë mund të përjetojnë dhunë në politikë. Megjithatë të tilla akte dhune ndaj grave i vënë ato në shenjë për shkak të gjinisë dhe marrin forma me bazë gjinore si kërcënimet seksiste apo ngacmimet dhe dhuna seksuale. Qëllimi i tyre është që t'i dekurajojnë gratë që të mos jenë politikisht aktive dhe të mos i ushtrojnë të drejtat e tyre të njeriut, si dhe që të ndikojnë, të kufizojnë dhe të mos lejojnë pjesëmarrjen politike të grave individualisht dhe si grup... Një dhunë e tillë, përfshirë edhe dhunën gjatë dhe jashtë zgjedhjeve, konsiston në çfarëdo akti dhune me bazë gjinore ose në kërcënime për akte të tilla, që rezulton ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike, dhe që drejtohet kundër një gruaje në politikë, thjesht, sepse ajo është grua ose që ndikon te gratë në mënyrë shpërpjesëtimore”.⁷² UN Women ka një përkufizim të ngjashëm, i cili

72 Raportuesja e Posaçme e OKB-së për Dhunën ndaj Grave, raport për Asamblenë e Përgjithshme, 5 tetor 2018, <https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Issues/Women/SR/SR_VAW_GA73_2018.pdf>.

vë në dukje se dhuna ndaj grave në jetën politike “mund të kryhet nga një anëtar i familjes, nga një anëtar i komunitetit dhe/ose nga shteti”.⁷³

Gama e personave që mund të vihen në shenjë, përfshin të zgjedhurit ose përfaqësues të tjerë politikë, kandidatë, aktivistë politikë, anëtarë partish, zgjedhës, staf zgjedhor, vëzhgues të zgjedhjeve dhe përfaqësues të mediave, si dhe anëtarë të familjeve ose bashkëpunëtorë të atyre që janë vënë në shënjestër. Dhuna psikologjike përfshin veprime që kanë për qëllim ta frikësojnë ose ta poshtërojnë një person dhe mund të jenë shumë të sofistikuar dhe të vështira për t'u identifikuar. Dhuna seksuale përfshin akte pa pëlqim dypalësh, provokime ose komente të padëshiruara në mjedise publike ose private. Rastet e kanosjes së grave përmes internetit po bëhen gjithnjë e më të përhapura dhe mund të kenë ndikim shpërpjesëtimor tek ato, veçanërisht nëse kanosja e ka bërë të vetën; ato kanë frikë të marrin pjesë fizikisht në veprimtari zgjedhore ose politike.⁷⁴ Kjo mund të përfshijë, ndër të tjera, kërcënimet, gjuhën e urrejtjes, dezinformimin, ekspozimin e të dhënave private dhe përdorimin e të dhënave të tyre nga persona të tjerë duke rezultuar në frikë, poshtërim dhe/ose dëmtim të reputacionit.

Siç ka vënë në dukje Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, “Personat me të drejtë vote duhet të jenë të lirë të votojnë për çdo kandidat në zgjedhje dhe pro ose kundër çdo propozimi të paraqitur në referendume ose në plebishite, si dhe të lirë të mbështesin ose të kundërshtojnë qeverinë, pa u influencuar dhe pa u ndikuar në asnjë lloj forme që mund të shtrembërojë ose frenojë shprehjen e lirë të vullnetit

73 Më gjerësisht, *UN Women* e përkufizon dhunën ndaj grave në jetën politike si “çdo akt ose kërcënim për dhunë me bazë gjinore, që rezulton në dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale dhe psikologjike ndaj grave, që i pengon ato të ushtrojnë dhe të realizojnë të drejtat e tyre politike, qoftë në hapësira publike apo private, përfshirë edhe të drejtën për të votuar dhe për të ushtruar funksione publike, për të votuar në fshehtësi dhe për të bërë fushatë lirisht, për t'u organizuar dhe për të gëzuar lirinë e mendimit dhe të shprehjes.” Shih “Parandalimi i dhunës ndaj grave në zgjedhje: udhëzues programimi”, *UN Women* & PNUD, 2017, <<https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2017/11/preventing-violence-against-women-në-zgjedhje>>.

74 “Dhuna përmes internetit ndaj grave në zgjedhje: një mjet për analizimin e mediave sociale”, IFES dhe Instituti Kombëtar Demokratik, 30 shtator 2019, <<https://www.ifes.org/publications/violence-against-women-elections-online-social-mjet-analiza-media>>.

të zgjedhësve”.⁷⁵ Kërcënimet dhe dhuna mund t’ua bëjnë të vështirë njerëzve që të formojnë dhe të shprehin opinionet e tyre politike dhe të përfshihen në parti politike dhe në zgjedhje.⁷⁶ Përveç komprometimit të drejtave të njeriut të individëve, kjo mund ta shtrembërojë procesin demokratik në përgjithësi.

Mund të jetë e vështirë për të marrë të dhëna për dhunën ndaj grave në zgjedhje, pasi kjo dhunë mund të konsistojë vetëm në disa akte të sofistikuar në hapësirën private dhe mund të ketë hezitim për ta raportuar. *UN Women* dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) kanë vënë në dukje se: “studimet shkencore tregojnë se dhuna ndaj grave në zgjedhje është e përhapur në të gjitha vendet dhe rajonet e botës”.⁷⁷ Një studim i Unionit Ndërparlamentar, i vitit 2016, tregon se 81.8 për qind e grave të anketuara (parlamentare) kanë raportuar dhunë psikologjike, nga të cilat 44.6 për qind kishin qenë kërcënime për përdhunim, rrahje ose rrëmbime, si dhe kërcënime me vdekje.⁷⁸ Ky studim vërtetoi se rrjetet sociale “janë bërë vendi numër një ku ndaj parlamentareve gra ushtrohet dhunë psikologjike – veçanërisht në formën e vërejtjeve seksiste dhe mizogjine, imazheve poshtëruese, bulizmit nga turma, frikësimit dhe kërcënimeve”.⁷⁹

Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias ka vënë në dukje se: “Gazetarët janë sistematikisht objektiva të sulmeve përmes internetit dhe gazetaret gra përballen me një barrë të dyfishtë; ato sulmohen edhe si

75 PNDKP, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Komenti i Përgjithshëm 25, *vep. cit.*, shënimi 52, parag. 19.

76 “Jo dhunës: analizimi i dhunës ndaj grave në partitë politike”, IKD, 19 mars 2018, <<https://www.ndi.org/publications/no-party-violence-analyzing-violence-against-women-political-parties>>.

77 “Parandalimi i dhunës ndaj grave në zgjedhje”, *vep. cit.*, shënimi 74, faqe 7.

78 “Seksizmi, ngacmimi dhe dhuna ndaj parlamentareve gra”, Unioni Ndërparlamentar (UNP), tetor 2016, <<http://archive.ipu.org/pdf/publications/issuesbrief-e.pdf>>.

79 Edhe një studim i UNP-AP-së së KiE-së, 2018 <<https://www.ipu.org/resources/publications/issue-briefs/2018-10/sexism-harassment-and-violence-against-women-in-parliaments-in-europe>>, vuri në dukje se anëtarët gra të parlamenteve në Evropë janë veçanërisht në shënjestër të sulmeve përmes internetit, pasi 58.2 për qind e të intervistuarave kishin përjetuar përmbajtje dhe sjellje abuzive, seksuale ose të dhunshme në rrjetet sociale. Shih edhe broshurën informative “Parlamentet pa seksizëm dhe ngacmime seksuale”, AP e KiE-së, 27 nëntor 2019, <<https://pace.coe.int/en/news/7702/parliaments-free-of-sexism-and-sexual-harassment>>.

gazetare, edhe si gra. Në kryerjen e punës së tyre, ato gjejnë në kutitë e tyre të postës elektronike dhe në mediat sociale kërcënime për përdhunim, për dhunë fizike dhe imazhe grafike. Në raste ekstreme këto sulme çojnë në autocensurë ose më keq akoma: gratë tërhiqen nga sfera publike, duke e lënë fushën e gazetarisë të dominuar nga meshkujt me më pak zëra të gazetareve gra”.⁸⁰ Po kështu, siç u përmend më lart, në një vendim të fundit të Këshillit Ministror të OSBE-së, theksohen “roli vendimtar i gazetarëve në mbulimin e zgjedhjeve “ dhe “risqet e qarta me të cilat përballen gazetaret gra në punën e tyre, përfshirë edhe përmes teknologjive dixhitale”.⁸¹ Këto kërcënime mund të kenë ndikim të zgjedhjet, duke i mënjanuar gazetaret gra edhe më shumë nga procesi, me rrezikun e efekteve anësore për kandidatet gra dhe zgjedhëset gra.

Çdo lloj konflikti mund të rrisë rrezikun e dhunës gjatë procesit zgjedhor me pasoja potencialisht shpërpjesëtimore për vullnetin dhe për aftësinë e grave për të marrë pjesë. Në situata të tilla, mund të nevojiten edhe masa të tjera për të nxitur ndërgjegjësimin e grave për pjesëmarrjen në zgjedhje dhe për t’u mundësuar grave që të marrin pjesë të sigurta në zgjedhje. Këto masa mund të përfshijnë shtimin e qendrave të votimit për të reduktuar kohën e udhëtimit dhe rrezikun, si dhe shtimin e personelit të sigurisë dhe personelit të qendrave të votimit duke ruajtur ekuilibrin gjinor. Kandidatet gra mund të kenë nevojë edhe për masa mbrojtëse shtesë që të jenë në gjendje të bëjnë fushatë në vende të rrezikshme. Kjo është në përputhje me qëllimet e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

AVZ-të duhet të shikojnë kuadrin ligjor për barazinë gjinore dhe për dhunën ndaj grave dhe të përcaktojnë nëse ai po zbatohet si duhet dhe nëse ka mjete juridike të menjëhershme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ato duhet të shohin gjithashtu nëse zyrtarët zgjedhorë, personeli i sigurisë dhe gjyqtarët kanë marrë trajnimin e duhur se si ta adresojnë dhunën ndaj grave në zgjedhje. AVZ-të mund të vlerësojnë nëse po bëhet ndonjë punë përmirësuese nga autoritetet dhe partitë politike për të parandaluar dhe për të adresuar dhunën ndaj grave në zgjedhje dhe për

80 “Siguria e gazetareve femra përmes internetit”, faqja e internetit e OSBE-së, vizituar më 3 tetor 2022, <<https://www.osce.org/fom/safety-female-journalists-online>>.

81 Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror, *vep. cit.*, shënimi 13.

t'iu kundërvënë kërcënimeve përmes internetit dhe formave të tjera të dhunës kibernetike. Ato duhet të shqyrtojnë edhe nëse OAZ-të kanë plane paraprake për të adresuar dhunën ndaj grave në zgjedhje si edukimi specifik i zgjedhësve dhe puna me drejtuesit në komunitet, dhe nëse ata bëjnë rishikime përmes diskutimit të mësimeve të nxjerra. AVZ-të duhet të marrin gjithashtu në konsideratë sfidën se si duhet vlerësuar si duhet dhuna ndaj grave në zgjedhje, duke pasur parasysh format e saj të sofistikuar dhe mungesën e të dhënave në dispozicion.

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ A ka në ligj ndonjë përkufizim të dhunës me bazë gjinore dhe a e parashikon ai pjesëmarrjen politike?
- ▶ A ka dispozita të mjaftueshme legislative për të luftuar dhunën ndaj grave në zgjedhje dhe a duket se ato po zbatohen në praktikë? A ekzistojnë mjete juridike të menjëhershme?
- ▶ A po merret ndonjë masë tjetër paraprake për të adresuar dhunën ndaj grave në zgjedhje? Nëse po, nga kush dhe a konsiderohen efikase ato masa?
- ▶ A duket se ndonjë nga rastet e dhunës apo të frikësimit në zgjedhje, përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve, synon veçanërisht gratë?
- ▶ A i raportojnë grupet e grave problemet lidhur me dhunën ndaj grave në zgjedhje? A janë organizatat e shoqërisë civile aktive për këtë çështje?
- ▶ A kanë gratë mekanizma për të raportuar dhunën ndaj grave në zgjedhje në mënyrë të sigurt (tek autoritetet, përmes linjave telefonike etj.)?

- ▶ A ka të dhëna të ndara sipas gjinisë sa i takon dhunës lidhur me zgjedhjet? A ka shqetësime se dhuna ndaj grave në zgjedhje nuk raportohet mjaftueshëm?
- ▶ A ka trajnime për personelin e sigurisë dhe për zbatimin e ligjit për dhunën ndaj grave në zgjedhje?
- ▶ A ka ndonjë fushatë informimi të publikut që adreson të drejtën e grave për të marrë pjesë në mënyrë paqësore në zgjedhje, pa frikësim apo dhunë?
- ▶ A kanë partitë politike ndonjë politikë për reduktimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave në zgjedhje brenda partive dhe/ose më gjerë?
- ▶ A ka konflikte në vend që duket se pengojnë pjesëmarrjen e grave në zgjedhje?
- ▶ A siguron administrata zgjedhore trajnime për personelin e saj për të zbutur dhunën ndaj grave në zgjedhje apo për raportimin e saj?
- ▶ A ka ndonjë mbulim mediatik të dhunës ndaj grave në zgjedhje? A e përforcon apo e adreson kjo gjë këtë çështje?
- ▶ A janë gazetaret gra veçanërisht objekt i kërcënimeve ose ngacmimeve (përfshirë edhe ato përmes internetit)?
- ▶ A po kryhet ndonjë monitorim i dhunës ndaj grave në zgjedhje përmes internetit?
- ▶ A kanë marrë autoritetet apo kompanitë e rrjeteve sociale masa për të parandaluar apo adresuar dhunën ndaj grave përmes internetit?

- ▶ A i nënshtrohen autorët e dhunës ndaj grave në zgjedhje hetimit dhe ndjekjes penale? A ka trajnime për gjyqtarët dhe prokurorët?



KAPITULLI 4

PJESËMARRJA E GRUPEVE MË PAK TË PËRFAQËSUARA

Përfshirja dhe mosdiskriminimi janë të drejta gjithëpërfshkuese të njeriut që duhet të mbështesin ushtrimin e të drejtave të tjera. Gratë me aftësi të kufizuara, vajzat dhe gratë nga komunitetet e pakicave kombëtare, përfshirë edhe romët dhe sintit, si dhe gratë e zhvendosura brenda vendit përballen me sfida të veçanta në pjesëmarrjen e tyre politike, përfshirë edhe pjesëmarrjen në proceset zgjedhore. Këto grupe grash shpesh hasin forma të shumta diskriminimi dhe vështirësish që mund t'i përballin ato me një rrezik edhe më të madh të përjashtimit dhe përfaqësimit më të paktë. Po kështu, ngrihen gjithmonë e më shumë çështjet që lidhen me identitetin gjinor dhe diversitetin gjinor kur flitet për vështirësitë e pjesëmarrjes në zgjedhje.

Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka vënë në dukje se: “Zërat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara i kanë detyruar të heshtin historikisht dhe kështu gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë më pak të përfaqësuara në mënyrë shpërpjesëtimore në vendimmarrjen publike”.⁸² Komisioni gjithashtu ka deklaruar se: “Ka prova të forta që tregojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përballen me pengesa në shumicën e fushave të jetës. Këto pengesa krijojnë situata të formave të shumta dhe të ndërthurura të diskriminimit

82 Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Komenti i Përgjithshëm 3, 2016.

ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, veçanërisht në lidhje me: qasjen e barabartë në arsim, mundësitë ekonomike, ndërveprimin social dhe drejtësinë, njohjen e barabartë përpara ligjit dhe aftësinë për të marrë pjesë në politikë dhe për të ushtruar kontroll mbi jetën e tyre në një sërë kontekstesh...”

Janë ngritur shqetësime për rënien e pjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhje dhe kjo dinamikë mund të ndikojë veçanërisht te vajzat dhe të pakësojë më tej përfaqësimin e tyre në postet e zgjedhura.⁸³ Përveç dinamikave më të gjera politike, kjo rënie ndonjëherë shpjegohet me mungesën e ndërgjegjësimit të synuar, me mungesën e politikave dhe/ose masave mbështetëse për të promovuar të rinjtë brenda partive politike dhe në listat e kandidatëve, me mundësitë e kufizuara për të marrë pjesë në administratën zgjedhore dhe me rregulloret e regjistrimit të votuesve që dekurajojnë në mënyrë shpërpjesëtimore zgjedhësit e rinj. Megjithatë teknologjitë dixhitale të komunikimit kanë pasur një efekt pozitiv në promovimin e lidhjes në rrjet dhe mobilizimit, duke pasur parasysh se sa gjerësisht përdoren ato nga të rinjtë. Megjithëse nuk ka asnjë traktat të posaçëm ndërkombëtar për të drejtat e të rinjve, rëndësia e përfshirjes së tyre njihet gjithnjë e më shumë si pjesë e axhendës së OZHQ-ve “të mos lëmë askënd pas” dhe për promovimin e angazhimit demokratik.

Përfshirja e pakicave kombëtare në jetën publike është një pjesë e rëndësishme e integritit dhe kontribuon në parandalimin e konflikteve të mundshme. Kjo përfshirje njihet në një sërë standardesh ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.⁸⁴ Megjithatë, siç shtjellohet

83 Sipas raportit të Unionit Ndërparlamentar mbi Pjesëmarrjen e të Rinjve në Parlamentet Kombëtare nga viti 2016 <<https://www.ipu.org/resources/publications/reports/2016-07/youth-participation-in-national-parliaments-2016>>, të rinjtë nën 30 vjeç përbëjnë më pak se 2 për qind të deputetëve në botë. Shih edhe Deklaratën për Rininë të OSBE-së në Madrid, të vitit 2007. Shih edhe rezultatet e një sondazhi, të vitit 2019, mbi pjesëmarrjen rekord të nxitur nga votuesit në moshë të re në zgjedhjet për Parlamentin Evropian <<https://www.europarl.europa.eu/news/en/press-room/20190923IPR61602/2019-european-elections-record-turnout-driven-by-young-people>>.

84 Dokumenti i Kopenhagenit *vep.cit.*, shënimi 55, para. 30–39; Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKPK), 1995 <<https://www.coe.int/en/web/minorities>>.

edhe në botime të tjera të ODIHR-it, personat që u përkasin pakicave kombëtare, përfshirë edhe romët dhe sintit, shpesh përballen me disavantazhe në lidhje me pjesëmarrjen në zgjedhje.⁸⁵ Këtu mund të përfshihen vështirësitë gjuhësore, aksesit i reduktuar në media, sistemet e pafavorshme zgjedhore dhe/ose përcaktimet e kufijve dhe pengesat e mundshme kulturore. Vështirësi të tilla mund të jenë veçanërisht të theksuara për gratë nga pakicat kombëtare.

Gratë shpesh formojnë në mënyrë shpërpjesëtimore një përqindje më të madhe të popullatave të personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV-ve). OSBE-ja ka rekomanduar që “Në punën e OSBE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve të bëhet kujdes që t’i kushtohet vëmendje e veçantë të drejtave të PZHBV-ve për të votuar, të monitorohet mundësia e PZHBV-ve për të votuar dhe të promovohen reforma për të siguruar ushtrimin e plotë të së drejtës së tyre për pjesëmarrje politike.”⁸⁶ Instrumente të ndryshme politike ndërkombëtare i referohen në mënyrë të shprehur të drejtave zgjedhore të PZHBV-ve, përfshirë edhe Parimet Udhëzuese të Zhvendosjes Brenda Vendit, marrëveshja kryesore ndërkombëtare që parashikon zhvendosjen brenda vendit, e miratuar nga Samiti Botëror i OKB-së, në vitin 2005.⁸⁷ Në vitin 2006, Komiteti i Ministrave i Këshillit të

-
- 85 Udhëzues për Vëzhgimin dhe Promovimin e Pjesëmarrjes së Pakicave Kombëtare në Proceset Zgjedhore, OSBE/ODIHR, 2014. Gjetet në <<https://www.osce.org/files/f/documents/a/f/124067.pdf>>. Shih gjithashtu “Raporti i tretë i statusit: zbatimi i planit të veprimit të OSBE-së për përmirësimin e situatës së romëve dhe sintit brenda OSBE-së”, OSBE/ODIHR, 11 dhjetor 2018, <<https://www.osce.org/odihr/roma-sinti-action-plan-2018-status-raport>>, ku thuhet se pengesat që frenojnë pjesëmarrjen e romëve dhe sintit në zgjedhje kanë mbetur krejtësisht të pandryshueshme që nga viti 2013. Nga raportet dhe informacionet e marra gjatë pesë viteve të fundit shihet qartë se romët ende përballen me probleme “duke filluar nga presioni i drejtpërdrejtë të “votimi i kontrolluar”, blerja e votave, mungesa e edukimit dhe analfabetizmi i zgjedhësve, mungesa e kapacitetit të kandidatëve për të kandiduar për funksionet e zgjedhura, mungesa e dokumenteve të regjistrimit, votimi familjar dhe pengesat ligjore dhe administrative.” Gratë rome dhe sinti mbeten më pak të përfaqësuara në politikë dhe partitë kryesore politike vazhdojnë me kokëfortësi që t’i rezistojnë nxjerrjes së kandidatëve romë dhe sinti.
- 86 “Personat e zhvendosur brenda vendit”, Raporti përfundimtar, Takimi plotësues i OSBE-së për dimensionin njerëzor, 4-5 dhjetor 2004, <<http://www.osce.org/odihr/38887?download=true>>.
- 87 Parimi 22 (1) (d) thotë: “Personat e zhvendosur brenda vendit, pavarësisht nëse jetojnë apo jo në kampe, nuk duhet të diskriminohen, si rezultat i zhvendosjes së tyre, në gëzimin e të drejtave të mëposhtme: ... (d) të drejtën për të votuar dhe për të marrë pjesë në çështjet qeveritare dhe publike, përfshirë edhe të drejtën për të pasur akses në mjetet e nevojshme për ta ushtruar këtë të drejtë.” Parimi 29(1)

Evropës deklaroi se: “Shtetet anëtare duhet të marrin masat e duhura ligjore dhe praktike për t’u mundësuar personave të zhvendosur brenda vendit të ushtrojnë efektivisht të drejtën e tyre për të votuar në zgjedhjet kombëtare, rajonale ose vendore dhe të garantojnë që kjo e drejtë të mos cenohet nga pengesa të një natyre praktike.” Në vitin 2009, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës rekomandoi që Komiteti i Ministrave “të marrë masa që PZHBV-të të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të marrë pjesë në çështjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë edhe të drejtën e tyre për të zgjedhur ose për t’u zgjedhur, gjë që mund të kërkojë masa të veçanta, si p.sh.: regjistrimin e zgjedhësve PZHBV ose fletë votimi për zgjedhësit në mungesë.”⁸⁸

PZHBV-të mund të përballen me sfida të shumta, përfshirë edhe pamundësinë për t’u kthyer në zonën e tyre zgjedhore të origjinës dhe barrën administrative për ndryshimin e adresës së tyre të regjistruar, gjë që mund të ndikojë tek regjistrimi i tyre si votues ose tek mundësia e tyre për të marrë pjesë në zgjedhje në ditën e zgjedhjeve në adresën e tyre *de facto*. Kur largohen me ngut nga komunitetet e tyre shumë persona të zhvendosur i humbasin dokumentet e identifikimit - ndërkohë që këto dokumente janë shpesh të domosdoshme për të votuar në qendrat e votimit. Gratë e zhvendosura, në veçanti, mund të ngurrojnë që të aplikojnë për dokumente të reja ose për t’u regjistruar nga e para nga frika se mos humbasin përfitimet ose të drejtat që kanë fituar apo për të shmangur kanosjen. Ndërlikime të tilla mund të parashikohen dhe të adresohen nga parlamentet dhe nga organet e administrimit të zgjedhjeve gjatë planifikimit të procedurave zgjedhore.

Çështjet që lidhen me identitetin gjinor dhe orientimin seksual mund të merren gjithashtu në konsideratë nga AVZ-të, në përputhje me

thotë: “Personat e zhvendosur brenda vendit, që janë kthyer në shtëpitë e tyre ose në vendet e banimit të zakonshëm apo që janë zhvendosur në një pjesë tjetër të vendit, nuk duhet të diskriminohen si rezultat i zhvendosjes së tyre. Ata kanë të drejtë të marrin pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në çështjet publike në të gjitha nivelet dhe të kenë akses të barabartë në shërbimet publike.” <<http://www.ohchr.org/EN/Issues/IDPersons/Pages/Standards.aspx>>.

88 Rekomandimi 1877 (2009) “Njerëzit e harruar të Evropës: mbrojtja e të drejtave të njeriut të personave të zhvendosur për një kohë të gjatë”, 24 qershor 2009, <<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806b5aae>>.

mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të gjithë individëve, promovimin e gjithëpërfshirjes në zgjedhje dhe në përputhje me axhendën e OZHQ-ve për të mos lënë askënd pas. Rëndësia e këtij vlerësimi po njihet gjithnjë e më shumë në nivel ndërkombëtar. Për shembull, në vitin 2010, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës rekomandoi që shtetet anëtare “të sigurohen që masat legislative dhe masat e tjera të miratohen dhe zbatohen në mënyrë efektive për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut të lezbikeve, personave homoseksualë, biseksualë dhe transgjinorë dhe për të promovuar tolerancën ndaj tyre”.⁸⁹ Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut ka pohuar të drejtën e personave trans për njohjen ligjore të identitetit të tyre gjinor dhe për ndryshimin e gjinisë në dokumentet zyrtare, pa iu nënshtruar kërkesave të vështira dhe abuzive, në përputhje me të drejtën për t’u njohur si person përpara ligjit.⁹⁰

Megjithatë, në praktikë, mund të ketë shqetësime se si e përkufizon dhe si e kategorizon shteti gjininë, si dhe vështirësi që lidhen me ndryshimet e statusit ose të emrit të individëve, që ndikojnë në mundësitë e tyre për të marrë pjesë në zgjedhje. Për shembull, mund të ketë kufizime ligjore ose administrative që e bëjnë të vështirë regjistrimin e ndryshimit të emrit dhe/ose gjinisë në një dokument identifikimi dhe në regjistrin zgjedhor, gjë që mund të krijojë pengesa për pjesëmarrjen si zgjedhës ose për regjistrimin si kandidatë. Kjo në fakt mund t’i detyrojë individët të zgjedhin midis identitetit të tyre dhe të drejtës së tyre për të votuar ose për t’u zgjedhur. Mund të ketë edhe qëndrime shoqërore negative që mund të pengojnë pjesëmarrjen në politikë të njerëzve, identiteti gjinor ose seksualiteti i të cilëve është i marxhinalizuar.

89 Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave mbi masat për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, 31 mars 2010 (CM/REC(2010)5), <https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=0900016805cf40a>. Shih gjithashtu “Lufta ndaj diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës”, Komiteti Drejtues i KiE-s për të Drejtat e Njeriut, 26-29 nëntor 2019, <<https://rm.coe.int/combating-discrimination-on-grounds-of-sexual-orientation-and-gender-i/16809fb2b8>>.

90 Fletushkë informuese për “Transgjinorët”, OKB-ja e Lirë dhe e Barabartë, Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut. <https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Discrimination/LGBT/FactSheets/UNFE_FactSheet_Transgender_EN.pdf>.

DISA NGA PYETJET QË MUND TË BËHEN

- ▶ A ka ndonjë dispozitë legislative që lehtëson pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, pakicave kombëtare, të rinjve dhe PZHBV-ve? A përfshihet në to ndonjë masë veçanërisht për gratë që janë pjesë e këtyre grupeve? Çfarë pikëpamjesh ka për këto dispozita legislative dhe sa efikase janë ato?
- ▶ A ka ndonjë boshllëk ligjor që mund t'i pengojë shtetasit të marrin pjesë në zgjedhje për shkak të orientimit të tyre seksual apo të identitetit gjinor?
- ▶ Kur ndërmerren reforma ligjore në lidhje me zgjedhjet, a zhvillohet ndonjë proces konsultativ me grupet që përfaqësojnë gjerësisht gratë me aftësi të kufizuara, pakicat kombëtare, të rinjtë, PZHBV-të dhe grupet e tjera më pak të përfaqësuara?
- ▶ Kur bëhen reforma zgjedhore, a konsultohen përfaqësuesit e grupeve të pafavorizuara?
- ▶ A promovon edukimi i zgjedhësve në mënyrë specifike pjesëmarrjen e grave nga komunitetet më pak të përfaqësuara? A vihen në dispozicion informacionet në një sërë formatesh duke i bërë ato të aksesueshme për gratë e pakicave etno-gjuhësore ose gratë me aftësi të kufizuara?
- ▶ A ka gra nga grupet e pafavorizuara që punojnë në administratën zgjedhore?
- ▶ A ka ndonjë dispozitë të veçantë të parashikuar me ligj për pjesëmarrjen në zgjedhje të grave nga komunitetet më pak të përfaqësuara?
- ▶ A ka ndonjë informacion mbi zotërimin ose aksesin në dokumentacionet personale të grave të zhvendosura?

- ▶ A ka administrata zgjedhore ndonjë politikë për identitetin gjinor? A ka ndonjë shqetësim rreth mënyrës se si i menaxhon administrata zgjedhore ndryshimet e emrit dhe identitetit si rezultat i ndryshimeve në identifikimin gjinor?
- ▶ A janë të dukshme gratë, që u përkasin komuniteteve më pak të përfaqësuara, në kandidaturat partiake, në strukturat drejtuese dhe/ose veprimtaritë dhe materialet publike? A ka ndonjë mekanizëm për financimin e kostove shtesë që lidhen me dëmet me të cilat përballen gratë me aftësi të kufizuara kur kandidojnë për funksione të zgjedhura?
- ▶ A ka çështje që lidhen me identitetin gjinor dhe orientimin seksual që janë të dëmshme për pjesëmarrjen në zgjedhje? A po merren masa nga shteti, partitë politike apo OSHC-të për tejkalimin e tyre?
- ▶ A ka ndonjë OSHC që promovon në mënyrë specifike të drejtat zgjedhore të grave nga komunitetet më pak të përfaqësuara?
- ▶ A e mundëson mjedisi pjesëmarrjen e grave nga komunitetet më pak të përfaqësuara në jetën publike dhe politike, përfshirë edhe në proceset zgjedhore?
- ▶ A i mbulojnë mediat e financuara nga shteti dhe/ose mediat private nevojat dhe prioritetet e grave nga komunitetet më pak të përfaqësuara? A ofron media mbulim të zgjedhjeve dhe informacione në gjuhët e pakicave dhe në formate të aksesueshme? A kanë burimet mediatike ndonjë politikë apo praktikë në lidhje me identitetin gjinor dhe diversitetin gjinor që mund të ndikojë në pjesëmarrjen në zgjedhje?



KAPITULLI 5

ROLI I MISIONEVE DHE VËZHguesve TË ODIHR-IT

Çështjet gjinore janë të rëndësishme për të gjitha aspektet e zgjedhjeve dhe për këtë arsye janë pjesë integrale e punës së AVZ-së. Të gjithë anëtarët e AVZ-së duhet të jenë të vetëdijshëm se si lidhen çështjet gjinore me fushat e tyre specifike të përgjegjësisë brenda një misioni nën përgjegjësinë e përgjithshme të Zëvendësshefit të Misionit dhe ta pasqyrojnë këtë në analizën e tyre. AVZ-të e ODIHR-it duhet të mbledhin informacion, të vlerësojnë shkallën në të cilën angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet e standardet e tjera ndërkombëtare përmbushen në ligj dhe në praktikë, dhe më pas të bëjnë rekomandime konstruktive për vendin pritës.⁹¹

A. MISIONET E VLERËSIMIT TË NEVOJAVE

ODIHR-i dërgon një mision të vlerësimit të nevojave (MVN) në shtetet pjesëmarrëse katër deri në gjashtë muaj përpara ditës së zgjedhjeve. MVN-ja vlerëson mjedisin dhe përgatitjet parazgjedhore dhe sugjeron

91 Vendimi nr. 14/05, Plani i Veprimit i OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore, i vitit 2004, Sofje, 7 dhjetor 2004, <<https://www.osce.org/files/f/documents/7/d/23295.pdf>>, e ngarkoi ODIHR-in që "...në kuadër të Misionit të tij të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, të vazhdojë të monitorojë dhe të raportojë mbi pjesëmarrjen e grave në proceset zgjedhore. Kur është e mundur, përveç kësaj, ODIHR-i duhet edhe të porosisë dhe të botojë raporte që analizojnë në mënyrë specifike situatën e grave në proceset zgjedhore."

llojin, formatin, kohëzgjatjen dhe objektin e një misioni që mund të dërgojë ODIHR-i për të vëzhguar zgjedhjet.⁹² Të gjitha raportet e MVN-së qarkullohen në shtetet pjesëmarrëse përkatëse të OSBE-së dhe bëhen publike në seksionin e faqes së internetit të OSBE-së kushtuar ODIHR-it. MVN-ja mund të rekomandojë që një AVZ të ngarkohet me analizimin e intensifikuar të pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore. Në praktikë, kjo mund të rezultojë në dërgimin e një analisti të çështjeve gjinore në një AVZ ose në dërgimin e një ekipi ekspertësh të çështjeve zgjedhore (EEZ) që të fokusohen në pjesëmarrjen e grave në zgjedhje.⁹³ Prandaj MVN-të janë kryesore për identifikimin e çështjeve që lidhen me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje dhe për rekomandimin e llojit të duhur të fokusit tek çështjet gjinore brenda një AVZ-je.

Pikat e veprimit të MVN-së:

- i. Përpara se të dërgojë në një vend një MVN, ekipi përgjegjës i ODIHR-it verifikon nëse ai vend e ka ratifikuar/aderon në KEDNG dhe nëse e ka miratuar atë me ndonjë rezervë ose duke bërë edhe ndonjë deklaratë. Ky ekip verifikon gjithashtu edhe raportet më të fundit nga organi përgjegjës i traktatit, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, dhe përgjigjet nga shteti përkatës. MVN-ja mund të verifikojë edhe nëse ekziston një strategji kombëtare ose një plan veprimi, që përfshin referenca ndaj barazisë gjinore, dhe nëse ka ndonjë ligj specifik kundër diskriminimit ose ndonjë ligj kundër gjuhës së urrejtjes që parashikon edhe barazinë gjinore. Këshilltari përgjegjës për zgjedhjet duhet të verifikojë edhe rekomandimet dhe aktivitetet e mëparshme të ODIHR-it në lidhje me barazinë gjinore, si dhe përfaqësimin aktual të grave të zgjedhura në nivele të ndryshme dhe brenda administratës zgjedhore (në varësi të disponueshmërisë së të dhënave).

92 Për më shumë informacion, shih Udhëzues për Vëzhgimin e Zgjedhjeve: Botimi i gjashtë, OSBE/ODIHR, 11 qershor 2010, Seksioni 4.2 <<https://www.osce.org/odihr/elections/68439>>.

93 *Po aty*, Seksioni 5.4.

- ii. Gjatë përgatitjes së axhendës së MVN-së, ekipi i inkurajon autoritetet që të dërgojnë ekipe të ekuilibruara gjinore me përfaqësues të institucioneve. Gjithashtu, ekipi i MVN-së organizon edhe takime me organizatat e shoqërisë civile që përfaqësojnë interesat e grave dhe, aty ku është e mundur, edhe me përfaqësues të *UN Women*.
- iii. Ekipi i MVN-së verifikon gjithashtu edhe nëse ka ndonjë dispozitë të parashikuar me ligj për të nxitur pjesëmarrjen e grave në zgjedhje dhe kur dhe si janë futur ato dispozita, dhe përpiqet të kuptojë se sa efikase janë ato në të vërtetë dhe si perceptohen. Ai gjithashtu vlerëson nëse ka pasur ndonjë kthim prapa, si legjislacion regresiv, tërheqje të kuotave ose masa që ndikojnë tek gratë në mënyrë të diferencuar në zgjedhje.
- iv. Gjatë MNV-së, ekipi mund t'i pyesë të gjithë bashkëbiseduesit për situatën në lidhje me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje. Disa nga çështjet më të rëndësishme mund të përfshijnë:
- ▶ Si është gjendja e përgjithshme e barazisë gjinore në vend? Nëse ekziston një plan veprimi për barazinë gjinore, si vlerësohet zbatimi i tij dhe a parashikon ai përfshirjen dhe pjesëmarrjen në politikë të grave?
 - ▶ A ka të dhëna të ndara sipas gjinisë për gratë në administratën zgjedhore, për kandidatet gra dhe për pjesëmarrjen e tyre si zgjedhëse? A ka detyrime të parashikuara me ligj për sigurimin e të dhënave të tilla?
 - ▶ Sa është përqindja aktuale e grave në parlament, në qeverinë qendrore, në pushtetin vendor (në varësi të zgjedhjeve) dhe në hartën politike? A ka një trajektore në rritje apo në rënie të grave në postet e zgjedhura dhe në politikë?
 - ▶ Çfarë masash të përkohshme të veçanta janë marrë dhe a konsiderohen ato efikase? A ka nga këto ndonjë

masë të re apo të modifikuar në njëfarë mënyre? A janë miratuar ato përmes një procesi gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e grupeve të grave?

- ▶ Çfarë po bën administrata zgjedhore për të promovuar pjesëmarrjen e grave brendapërbrenda dhe pjesëmarrjen e tyre si kandidatë dhe si zgjedhëse?
- ▶ Çfarë veprimesh po ndërmarrin partitë politike, përfshirë edhe partitë drejtuese apo partitë e tjera parlamentare, në lidhje me promovimin e gruas në politikë? A po përdorin ato ndonjë masë vullnetare për të promovuar gratë në strukturat dhe në listat e partive?
- ▶ A synojnë partitë të propozojnë kandidatë gra?
- ▶ A kushtëzohen mekanizmat e financimit të partive apo subvencioneve përkatëse nga përfshirja e grave në parti?
- ▶ A kanë marrë masa mediat publike ose mediat private kryesore për të promovuar pjesëmarrjen e grave në politikë?
- ▶ A ka ndonjë shqetësim lidhur me pjesëmarrjen e pa-penguar dhe autonome të grave në ditën e zgjedhjeve?
- ▶ A ka grupe të drejtave të grave ose OSHC-ë që fokusohen në mënyrë specifike tek të drejtat zgjedhore të grave? A e kanë ata hapësirën politike për të analizuar dhe për të nxitur mbështetjen? Cilat janë çështjet prioritare që identifikojnë ato? A janë konsultuar ato për çështje të reformës zgjedhore?

- v. Në raportin e MVN-së duhet të përfshihet edhe një vlerësim paraprak i përfaqësimit të grave në zgjedhje, përfshirë:

- ▶ Shkallën e zbatimit të rekomandimeve për barazinë gjinore të lëna nga AVZ-të e mëparshme të ODIHR-it;
 - ▶ Shkallën e përfshirjes së grave në reformën zgjedhore dhe të zbatimit të të gjitha rekomandimeve të mëparshme;
 - ▶ Ekzistencën e ndonjë politike dhe plani të ri veprimi për barazinë gjinore, përfshirë edhe pjesëmarrjen politike;
 - ▶ Kuadrin ligjor për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje, përfshirë edhe ndonjë ndryshim të bërë që nga zgjedhjet e fundit;
 - ▶ Disponueshmërinë e të dhënave të ndara sipas gjinisë;
 - ▶ Barazinë gjinore në përbërje të parlamentit dhe të administratës zgjedhore (në varësi të disponueshmërisë së të dhënave) dhe nëse kjo përbërje është përmirësuar apo ka pasur kthim prapa;
 - ▶ Informacionet e disponueshme për synimin e partive politike për të propozuar kandidatë gra apo kandidatë të njohura gra që garojnë si kandidatë të pavarura;
 - ▶ Pikëpamjet për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje, përfshirë edhe shqetësimet e shprehura nga politikanë gra, autoritete publike dhe organizata të shoqërisë civile;
 - ▶ Pikëpamjet mbi fokusin e AVZ-ve të ODIHR-it tek barazia gjinore dhe zgjedhjet.
- vi. Bazuar në këto kritere, MVN-ja mund të rekomandojë përfshirjen e një analisti të posaçëm të çështjeve gjinore në një mision të mëvonshëm. Herë pas here mund të rekomandohet një EEZ që të fokusohet ekskluzivisht te pjesëmarrja e grave në zgjedhje.

B. AKTIVITETET PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

Megjithëse pjesëmarrja e grave në zgjedhje duhet të vlerësohet nga AVZ-të e të gjitha llojeve, disa misione kanë një analist të posaçëm të çështjeve gjinore që fokusohet në mënyrë të intensifikuar te pjesëmarrja e grave. Megjithatë, zakonisht, të gjithë anëtarët e ekipit kryesor të misionit i trajtojnë çështjet gjinore në fushat e tyre përkatëse të aktivitetit nën mbikëqyrjen e përgjithshme të Zëvendëshefit të Misionit (ZSHM). ZSHM-ja është përgjegjës për të siguruar promovimin e pjesëmarrjes së grave në pjesët e ndryshme të të gjitha raporteve të botuara. Ka çështje që kërkojnë kontributin e kolegëve të ndryshëm të ekipit kryesor. Për shembull, analisti ligjor mund të japë informacion mbi kuadrin ligjor, kurse analisti i zgjedhjeve, ai politik ose ai i medias shohin se çfarë ndodh në praktikë. Në raportim përfshihen pothuajse gjithmonë edhe çështjet gjinore, d.m.th., mbulohe nga të gjitha këndvështrimet.

AVZ-të - pikat e veprimit:

- i. ZSHM-ja merr masa që manuali për vëzhgimin e zgjedhjeve të qarkullojë tek të gjithë dhe që ekspertët e ekipit kryesor t'i dinë përgjegjësitë që u takojnë.
- ii. SHM/ZSHM-ja kryeson takimet me organizatat përkatëse të shoqërisë civile.
- iii. Analistët hartojnë një listë me pyetje specifike, të lidhura me çështjet gjinore, për takimet e ardhshme.
- iv. ZSHM-ja punon me Koordinatorin e VAGJ-ve për t'u siguruar që vëzhguesit afatgjatë dhe ata afatshkurtër të informohen për pjesëmarrjen e grave dhe që modelet e raportimit të VAGJ-ve të krijohen në mënyrë të tillë që të kapin disa aspekte specifike të pjesëmarrjes së grave.
- v. ZSHM-ja punon me analistin e medias për të diskutuar se si do të monitorohet përfshirja e grave dhe mbulimi i veprimtarisë

së tyre zgjedhore në fushatë dhe si do të reflektohet kjo tek faktet e gjetura.

- vi. Nëse raporti nuk përmban ndonjë kapitull të posaçëm për pjesëmarrjen e grave, analiza e pjesëmarrjes së grave duhet të përfshihet në çdo seksion të raporteve të vëzhgimit. Për këtë, të gjithë analistët duhet të përgatisin nga një paragraf në portofolin e tyre tematik përkatës në lidhje me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje, që paraqitet së bashku me projektdeklaratën paraprake dhe raportin përfundimtar, që ZSHM-ja e ka hartuar dhe e ka ndarë me këshilltarin e zgjedhjeve.
- vii. ZSHM-ja përgatit paragrafët përmbledhës të raportit dhe rishikon të dhënat e raportimit nga kolegët e tjerë të ekipit kryesor mbi përfshirjen e grave.

Nëse aktivizohet një analist i posaçëm i çështjeve gjinore, ai ose ajo merr pjesë në takime me analistë të tjerë dhe mund të ndihmojë në përgatitjen e raporteve në lidhje me çdo aspekt të pjesëmarrjes së grave në zgjedhje. Ky analist duhet të jetë gjithashtu i përgatitur për të dhënë informacione më të plota për këtë çështje.

Të gjitha AVZ-të duhet të përpigën të marrin dhe të raportojnë të dhëna statistikore bazë. Këtu përfshihet numri përkatës i kandidatëve burra dhe gra; shifrat në parlamentet e porsazgjedhura dhe në parlamentet që u mbaron mandati (ose në organet e tjera për të cilat vëzhgohen zgjedhjet) dhe, për aq sa është e mundur, edhe në parlamentet e mëparshme; niveli i përfaqësimit të grave në organet e administrimit të zgjedhjeve dhe në postet drejtuese të atyre organeve; si dhe numri i mosmarrëveshjeve zgjedhore apo shkeljeve të raportuara në lidhje me pjesëmarrjen e grave.⁹⁴ Analiza e këtyre shifrave dhe e kontekstit do të ndihmojë në përcaktimin e tendencave të pjesëmarrjes dhe për-

94 Në Rekomandimin e Përgjithshëm 23, paragrafi 48 <<https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/recomm.htm>> theksohet se: “Shtetet palë duhet të përfshijnë të dhëna statistikore, të ndara sipas gjinisë, që tregojnë përqindjen e grave që i gëzojnë këto të drejta, krahasuar me burrat”. Shih edhe paragrafin 40.13 të Dokumentit të Moskës, të vitit 1991 <<https://www.osce.org/files/f/documents/2/3/14310.pdf>> i cili i angazhon shtetet pjesëmarrëse që “të marrin

faqësimit të grave. Statistikat zakonisht vihen në dispozicion përmes një sërë burimesh, përfshirë edhe ministritë, zyrat statistikore, OMZ-të, zyrat e vetëqeverisjes vendor, partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile. Nëse autoritetet nuk mbledhin informacione të ndara sipas gjinisë ose hezitojnë t'i ndajnë ato me të tjerë, AVZ-të duhet ta theksojnë këtë në raportimin e tyre dhe të përpiqen të marrin të dhëna nga burime të tjera si nga partitë politike dhe nga organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu, AVZ-të duhet të shohin përtej shifrave, duke marrë parasysh, për shembull, nëse prania e grave në parti, në parlament dhe në qeveri perceptohet si ndikim i rëndësishëm politik. Aty ku monitorimi i medias është një komponent i AVZ-së, monitorimi duhet të masë sasinë dhe tonin e mbulimit të veprimtarisë zgjedhore të kandidatëve gra.

VËZHguesit Afatgjatë (VAGJ-TË)

Koordinatori i VAGJ-ve është përgjegjës për marrjen e masave që VAGJ-të të jenë të vetëdijshëm për prioritetet e misionit në lidhje me gratë dhe zgjedhjet, dhe se ata duhet t'i raportojnë informacionet nga terreni që mund të jenë të dobishme për të bërë vlerësimin e këtyre çështjeve. Koordinatori i VAGJ-ve duhet të punojë ngushtë me analistin e çështjeve gjinore, ZSHM-në dhe me pikën fokale të çështjeve gjinore për të përcaktuar mënyrën më të mirë si t'u ngarkohen detyra specifike VAGJ-ve. Koordinatori i VAGJ-ve ndihmon edhe për të përcaktuar disa prioritete për Vëzhguesit Afatshkurtër (VASH-të) në lidhje me raportimin mbi pjesëmarrjen e grave gjatë ditës së zgjedhjeve.

VAGJ-të luajnë një rol qendror për të garantuar që fushëveprimi i misionit të shtrihet në të gjithë vendin. Si të tillë, ata janë në një pozicion kyç për të kontribuar në analizimin e roleve të grave në procesin zgjedhor në zonat zgjedhore. Për të kontribuar në mënyrë efikase, ata duhet të informohen për qasjen e përgjithshme të ODIHR-it ndaj çështjeve gjinore dhe zgjedhjeve, si dhe për situatën specifike në vend.

masa për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për të vlerësuar si duhet, për të monitoruar dhe për të përmirësuar situatën e grave.”

VAGJ-të duhet të jenë në gjendje të mbledhin një sërë informacionesh të dobishme për rolin e grave në procesin zgjedhor në zonat zgjedhore që u janë ngarkuar të mbulojnë. Ekipi kryesor duhet t'i sinjalizojë vazhdimisht të gjitha ekipet e VAGJ-ve për çështje apo për probleme specifike që mund të meritojnë vëmendje ose ndjekje të veçantë. Në të gjitha veprimtaritë dhe tubimet e fushatës të vëzhguara nga VAGJ-të, ekipi duhet të raportojë mbi pjesëmarrjen e grave, si folëse dhe si pjesëmarrëse, si dhe të reflektojë mbi përmbajtjen e fjalimeve ose të prezantimeve nga perspektiva gjinore.

DISA PYETJE QË MUND TË BËHEN NGA VAGJ-TË

- ▶ A ka gra që kandidojnë në zonën tuaj zgjedhore? Nëse po, si po e bëjnë ato fushatën? A kanë ato ndonjë shqetësim lidhur me barazinë gjinore në procesin zgjedhor?
- ▶ A kanë disa parti ndjeshëm më shumë kandidatë gra se të tjerat? A po bën ndonjë parti përpjekje të veçanta për të tërhequr zgjedhëset gra ose për të adresuar çështje me interes të veçantë për gratë?
- ▶ Sa për qind e grave marrin pjesë dhe paraqiten si folëse në tubime partiake apo në tubimet e fushatës së kandidatit? A janë ato në gjendje të marrin pjesë në mënyrë të sigurt dhe a ka ndonjë pengesë për pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë?
- ▶ A kanë kandidatet gra akses të mjaftueshëm në burimet e partisë? Nëse vetëfinancohen, a përballen ato me ndonjë sfidë shpërpjesëtimore në sigurimin e financimit për fushatat?
- ▶ Sa gra janë përfaqësuese të zgjedhura në nivel vendor?

- ▶ Sa gra janë anëtare të komisioneve zgjedhore rajonale dhe vendore? Sa nga komisionet drejtohen nga gra?
- ▶ A ka ndonjë OSHC në zonën tuaj që është aktive në promovimin e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje? Çfarë çështjesh ngrenë ato?
- ▶ A konsultohet administrata zgjedhore vendore me grupet që përfaqësojnë të drejtat e grave?
- ▶ Në zonën që mbulon, a janë regjistruar gratë si zgjedhëse në të njëjtat shifra si burrat? Nëse jo, çfarë arsyes jepen për këtë? A ka ndonjë aspekt specifik rajonal të regjistrimit të zgjedhësve që ndikon te regjistrimi i grave?
- ▶ A bëhet ndonjë fushatë për edukimin dhe nxitjen e zgjedhësve për të dalë e për të votuar që ka si objektive gratë?
- ▶ A ka shqetësime për dhunën ndaj grave në zgjedhje në zonën tuaj? Nëse po, a po bëhet ndonjë gjë nga autoritetet apo shoqëria civile për ta adresuar këtë?
- ▶ A raportojnë gratë në zonën tuaj probleme lidhur me ngacmimin, dezinformimin, imitimin, ndarjen e informacionit privat etj. me të tjerë në internet?
- ▶ A duket se marrin pjesë në zgjedhje gratë që i përkasin pakicave në zonën tuaj? A ka ndonjë faktor që e pengon pjesëmarrjen e tyre?
- ▶ A duket se gratë me aftësi të kufizuara po marrin pjesë aktive në zgjedhje? A ka ndonjë faktor që e pengon pjesëmarrjen e tyre?

- ▶ A ka ndonjë çështje tjetër në zonën që mbuloni që duket se ndikon në pjesëmarrjen e grave si zgjedhëse dhe/ose si kandidate, qoftë pozitivisht apo negativisht?

VËZHguesIT AFATSHKURTËR (VASH-TË)

VASH-të mund të vëzhgojnë pjesëmarrjen e grave në ditën e zgjedhjeve. Formularët e raportimit të VASH-ve përfshijnë pyetje në lidhje me numrin e burrave dhe të grave në çdo komision të qendrës së votimit dhe gjininë e kryetarit të secilit komision. Ata gjithashtu regjistrojnë incidente të votimit familjar, shkelje të tjera të fshehtësisë së votës, rastet e votimit të deleguar dhe probleme të tjera të ditës së zgjedhjeve që mund të prekin në mënyrë shpërpjesëtimore gratë. VASH-të gjithashtu duhet të përdorin formularët e posaçëm për të raportuar incidentet e dhunës ose kanosjes dhe për të shënuar ndikimin që kanë ato te pjesëmarrja e grave.

PYETJE QË MUND TË BËHEN NGA VASH-TË

- ▶ Sa burra dhe gra janë në komisionin e qendrës së votimit? A kryesohet komisioni i qendrës së votimit nga një grua apo nga një burrë?
- ▶ A keni vërejtur raste të votimit familjar, po ndonjë reagim nga personeli i qendrës së votimit? A keni vërejtur raste të votimit të deleguar dhe ndonjë reagim nga personeli i qendrës së votimit? A keni vërejtur incidente dhune apo kanosjeje? A kanë ndikuar këto incidente në mënyrë të veçantë në pjesëmarrjen e grave?
- ▶ Sa është përqindja e përgjithshme e grave që shërbejnë si vëzhguese të grupit të vëzhgimit qytetar dhe si vëzhguese të partive politike?

- ▶ A keni vërejtur ndonjë gjë që lidhet me qendrat e votimit, që mund të ketë ndikuar në mënyrë shpërpjesëtimore në pjesëmarrjen e grave?

C. HARTIMI I REKOMANDIMEVE DUKE PASUR PARASYSH BARAZINË GJINORE

AVZ-të e ODIHR-it raportojnë për një numër të madh problemesh zgjedhore, kështu që misionet duhet t'i përmbledhin dhe t'i rendisin sipas përparësisë pikat e forta dhe mangësitë kryesore sa i takon pjesëmarrjes së grave. Pikat kryesore në lidhje me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje duhet të përfshihen në deklaratën e gjetjeve dhe konkluzioneve paraprake që prezantohen ditën pas zgjedhjeve. Më pas, në raportin përfundimtar bëhet një analizë e plotë e të drejtave zgjedhore të grave. Ky raport publikohet zakonisht rreth dy muaj pas përfundimit të procesit zgjedhor. Pjesëmarrja e grave duhet të përmendet në përmbledhjen ekzekutive të të gjitha raporteve dhe veçanërisht në raportin përfundimtar. Këtu duhet të përfshihet një përfundim i përgjithshëm, ndërkohë që raportimi dhe rekomandimet për pjesëmarrjen e grave duhet të përfshihen në kapituj të ndryshëm. Në AVZ-të ku ka një analist të posaçëm të çështjeve gjinore, në raport mund të futet një seksion i veçantë për pjesëmarrjen e grave.

Duke pasur parasysh numrin e kufizuar të rekomandimeve që japin misionet në çdo cikël zgjedhor, mund të ketë vetëm pak rekomandime që lidhen posaçërisht me pjesëmarrjen e grave. Prandaj misionet duhet t'u japin përparësi rekomandimeve për çështjet gjinore, sipas situatës në vend, dhe të kujdesen që ato të jenë të formuluar qartë, të konkretizuara sipas kontekstit dhe të jenë të rëndësishme dhe të zbatueshme.

Nëse një vend e ka nënshkruar, por nuk e ka ratifikuar KEDNG-në, ata mundet që t'i referohen konventës prapëseprapë, duke pasur parasysh që ai vend ka shprehur interesin për t'u bërë pjesë e traktatit dhe veprimet e

tij duhet të jenë në përputhje me traktatin. Prandaj rekomandimet mund të bëhen në kuadrin e atij traktati, që mund të shërbejë si bazë.

Rekomandimet duhet të ngrenë çështje specifike që janë të zbatueshme dhe të matshme. Disa shembuj rekomandimesh mund të jenë: marrja në konsideratë nga shteti e marrjes së disa masave të mundshme të përkohshme; vendosja e detyrimeve për mbledhjen dhe publikimin sistematik të të dhënave të ndara sipas gjinisë; masat statutore ose vullnetare nga partitë politike; mbulimi përpjesëtimor dhe i paanshëm i veprimtarisë zgjedhore të kandidatëve gra nga transmetuesit e medias; rritja e mbrojtjes për gratë nga ngacmimet ose kërcënimet përmes internetit; përmirësimi i aksesit në zgjedhje në rastet kur janë ndryshuar emrat ose identiteti gjinor; dhe roli drejtues i grave në administratën zgjedhore. Misionet nuk duhet të bëjnë rekomandime që janë urdhëruese me tepri, sepse shtetet e kanë vetë deri diku në dorë që të vlerësojnë masat që duhet të marrin për të përmbushur angazhimet e tyre, përfshirë këtu edhe natyrën e sistemit të tyre zgjedhor ose miratimin e ndonjë kuote. Megjithatë në hartimin e rekomandimeve duhet të merret parasysh dhe t'i jepet përgjigje çdo efekti shpërpjesëtimor që mund të ketë shkaktuar ndërtimi apo zbatimi i një sistemi ose kuote zgjedhore në pjesëmarrjen e grave në zgjedhje.

D. NDJEKJA E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE PËR ZGJEDHJET NGA KËNDVËSHTRIMI GJINOR

Në Dokumentin e Stambollit, të vitit 1999, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan “të zbatojnë në mënyrë të menjëhershme vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet”. Që atëherë, ndjekja e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet është bërë gjithnjë e më e rëndësishme për shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, si dhe për punën e ODIHR-it në mbështetjen e shteteve në përpjekjet e tyre për të përmirësuar më tej proceset e tyre zgjedhore.⁹⁵

95 Shih Udhëzuesin e ODIHR-it për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve për Zgjedhjet, 2016. Gjendet në: <<http://www.osce.org/odihr/elections/119893>>.

Pas botimit të raportit përfundimtar për vëzhgimin e zgjedhjeve, një ekip i ODIHR-it zakonisht udhëton për në shtetin pjesëmarrës për t'ia paraqitur atë aktorëve të interesuar për zgjedhjet. Këto vizita janë hapi i parë në procesin vijues dhe shërbejnë si një kujtesë për shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së për detyrimin e tyre për të përmirësuar proceset e tyre zgjedhore në përputhje me angazhimet e OSBE-së. Për më tepër, këto vizita shërbejnë për të kuptuar më të mirë rreth vullnetit dhe aftësisë së shteteve për të adresuar çështje të veçanta.

Nëse kërkohet nga shteti pjesëmarrës, ODIHR-i mund të ndërmarrë edhe aktivitete vijuese. Këtu mund të përfshihen rishikimet ligjore, asistenca me ekspertizë ligjore në hartimin e legjislacionit, vlerësimet e thelluara të komponentëve të veçantë zgjedhorë (në shumë raste komponentë që lidhen me pjesëmarrjen e grave), këshilla teknike, mbështetja për organizatat e shoqërisë civile, vizitat afatmesme për analiza, lehtësimi dhe koordinimi.

ODIHR-i promovon pluralizmin politik dhe pjesëmarrjen e grupeve më pak të përfaqësuara në proceset për ndjekjen e ecurisë në kuadër të inkurajimit të mundësive të barabarta për pjesëmarrje në zgjedhje. Kështu, ODIHR-i përpigjet të konsultohet dhe të përfshijë politikane gra dhe organizata të shoqërisë civile që punojnë për përfshirjen e grave në aktivitetet e veta për ndjekjen e ecurisë. ODIHR-i i inkurajon gjithashtu shtetet pjesëmarrëse që t'i përfshijnë gratë në diskutimet dhe në aktivitetet për ndjekjen e ecurisë, në përputhje me angazhimet e KEDNG-së.

Gjatë prezantimit të raportit përfundimtar, ekipi i ODIHR-it duhet:

- i. Të takohet me politikane kryesore gra dhe me grupe për të drejtat e grave, si dhe me organizata ndërkombëtare që punojnë për të drejtat e grave, p.sh.: *UN Women*, Këshilli i Evropës dhe misionet në terren të OSBE-së.
- ii. Të përfshijë edhe disa rekomandime për përfshirjen e grave në diskutimet e tij me aktorë të ndryshëm.

- iii. Të promovojë përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile që punojnë për barazinë gjinore në aktivitetet për ndjekjen e ecurisë dhe në të gjitha aspektet e reformës zgjedhore.
- iv. T'u ofrojë ndihmë shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së për promovimin e grave në procesin zgjedhor, përfshirë edhe një rishikim të legjislacionit zgjedhor dhe praktikave të mira për pajtueshmërinë me detyrimet dhe standardet ndërkombëtare.

SHTOJCA A STANDARDE NDËRKOMBËTARE TË PËRZGJEDHURA

ANGAZHIMET E OSBE-SË

Dokumenti i Kopenhagenit, i vitit 1990

(5) [Shtetet pjesëmarrëse] deklarojnë në mënyrë solemne se ndër ato elemente të drejtësisë,

që janë thelbësorë për shprehjen e plotë të dinjitetit të qenësishëm dhe të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjitha qenieve njerëzore, janë këto:

(5.1) - zgjedhjet e lira, që do të mbahen në intervale të arsyeshme, me votim të fshehtë ose sipas një procedure të barasvlershme të votimit të lirë, në kushte që, në praktikë, garantojnë shprehjen e lirë të mendimit të zgjedhësve në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre;....

(5.7) - të drejtat e njeriut dhe liritë themelore garantohen me ligj dhe në përputhje me detyrimet e tyre, në bazë të së drejtës ndërkombëtare;....

(5.9) - të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë, pa u diskriminuar, të mbrohen njëjloj nga ligji. Në këtë aspekt, ligji ndalon çdo diskriminim për të gjithë njerëzit dhe garanton mbrojtje të barabartë dhe efektive nga diskriminimi për çfarëdo shkak;....

(5.20) - duke pasur parasysh kontributin e rëndësishëm të instrumenteve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut deri tek sundimi i ligjit në nivel kombëtar, shtetet pjesëmarrëse riafirmojnë se do të

marrin në shqyrtim miratimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore, si dhe të instrumenteve të tjera të rëndësishme ndërkombëtare, në rast se ende nuk e kanë bërë këtë;

(5.21) - për të plotësuar mjetet juridike të brendshme dhe për të garantuar më mirë që shtetet pjesëmarrëse të respektojnë detyrimet ndërkombëtare, që kanë marrë përsipër, shtetet pjesëmarrëse do të marrin në shqyrtim miratimin e një konvente ndërkombëtare rajonale ose globale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo Protokolli Fakultativ i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, që përcaktojnë procedurat për rekurs individual në organizmat ndërkombëtarë.

(7) Për të garantuar që vullneti i popullit të shërbejë si themel i autoritetit të qeverisë, shtetet pjesëmarrëse:

(7.1) — do të mbajnë zgjedhje të lira në intervale të arsyeshme, siç parashikohet në ligj;

(7.2) — do të lejojnë që të gjitha vendet, në të paktën një nga dhomat e legjislativit kombëtar, t'i nënshtrohen votimit të lirë popullor;

(7.3) — do të garantojnë të drejtën universale dhe të barabartë për të votuar për shtetasit që kanë arritur moshën madhore;

(7.4) — do të garantojnë që votat të hidhen me votim të fshehtë ose me procedurë të barasvlershme të votimit të lirë, dhe që votat të numërohen dhe të pasqyrohen me ndershmëri në rezultatet zyrtare, që publikohen;

(7.5) — do të respektojnë, pa diskriminim, të drejtën e shtetasve që të kërkojnë funksione politike ose publike, si individë ose si përfaqësues të partive apo organizatave politike,;

(7.6) — do të respektojnë të drejtën e individëve dhe grupeve që të krijojnë lirisht partitë e tyre politike apo organizata të tjera politike, dhe

këtyre partive dhe organizatave politike do t'u japin garancitë ligjore të nevojshme që të kenë mundësi të konkurrojnë me njëra-tjetrën mbi bazën e trajtimit të barabartë përpara ligjit dhe nga autoritetet;

(7.7) — do të garantojnë që ligji dhe politika shtetërore të p kontribuojnë që fushatat politike të lejohet të zhvillohen në një klimë të paanshme dhe të lirë, në të cilën as veprimet administrative dhe as dhuna apo kanosja të mos i pengojnë partitë dhe kandidatët të shprehin lirisht pikëpamjet dhe cilësitë e tyre, ose t'i pengojnë zgjedhësit që të informohen për to dhe t'i diskutojnë ato, apo ta hedhin votën e tyre pa frikën se mos ndëshkohen;

(7.8) — do të kujdesen që të mos ketë asnjë pengesë ligjore ose administrative në aksesin e lirë në media, mbi baza jodiskriminuese, e të gjitha grupimeve politike dhe individëve, që kanë dëshirë të marrin pjesë në procesin zgjedhor;

(7.9) — do të garantojnë që kandidatët, të cilët fitojnë numrin e nevojshëm të votave që kërkohet me ligj, të marrin sipas rregullit funksionet e tyre dhe të lejohen që të mbeten në atë detyrë derisa mandati i tyre të mbarojë ose, përndryshe, të ndërpritet, në një mënyrë që rregullohet me ligj, në përputhje me procedurat demokratike parlamentare dhe kushtetuese.

Karta për Sigurinë Evropiane, Stamboll, i vitit 1999

23. Ushtrimi i plotë dhe i barabartë nga gratë i të drejtave të tyre të njeriut është thelbësor për të arritur një zonë më paqësore, më të begatë dhe demokratike të OSBE-së. Ne jemi të përkushtuar për ta bërë barazinë midis burrave dhe grave pjesë integrale të politikave tona....
24. Ne do të marrim masa për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit ndaj grave dhe për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave...

Dokumenti i Moskës, i vitit 1991

40. Shtetet pjesëmarrëse pranojnë se barazia e plotë dhe e vërtetë midis burrave dhe grave është një aspekt themelor i një shoqërie të drejtë dhe demokratike, bazuar në sundimin e ligjit. Ato pranojnë se zhvillimi i plotë i shoqërisë dhe mirëqenia e të gjithë anëtarëve të saj kërkon mundësi të barabarta për pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë të burrave dhe grave. Në këtë kontekst, ato:
- 40.1 – do të garantojnë që të gjithë angazhimet e KSBE-së në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të zbatohen plotësisht dhe pa diskriminim për shkak të gjinisë;
- 40.2 – do t'i përmbahen Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDNG), në rast se janë palë;....
- 40.3 – do të afirmojnë se synimi i tyre është që të arrijnë jo vetëm barazinë *de jure* por edhe barazinë *de facto* të mundësive midis burrave dhe grave dhe të promovojnë masa efikase për këtë qëllim;...
- 40.8 – do të inkurajojnë dhe promovojnë mundësi të barabarta për pjesëmarrje të plotë të grave në të gjithë aspektet e jetës politike dhe publike, në proceset vendimmarrëse dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar në përgjithësi; ...
- 40.13 – do të sigurojnë mbledhjen dhe analizën e të dhënave për të vlerësuar në mënyrë adekuate, monitoruar dhe përmirësuar situatën e grave....

STANDARDET DHE DETYRIMET E KOMBEVE TË BASHKUARA

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Neni 2. Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh për sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër...

Neni 7. Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji....

Neni 21.

1. Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.
2. Gjithkush ka njëlloj të drejtë të hyjë në shërbimet publike në vendin e tij.
3. Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të vërteta, të cilat duhet të jenë me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe duhet të mbahen me votim të fshehtë ose me procedura ekuivalente të votimit të lirë.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Neni 3. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrit dhe gruas lidhur me gëzimin e të gjitha të drejtave civile dhe politike të përcaktuara në këtë Pakt.

Neni 25. Çdo qytetar ka të drejtën dhe mundësi...

- (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;
- (b) Të votojë dhe të zgjidhet gjatë zgjedhjeve periodike të vërte-ta, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve.

Neni 26. Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

Neni 2. Shtetet palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë një politikë të eliminimit të diskriminimit kundrejt grave dhe për këtë arsye zotohen:

- (a) Ta përfshijnë në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ndonjë dispozitë tjetër ligjore të përshtatshme, parimin e barazisë mes burrit dhe gruas, po qe se ende nuk është bërë, dhe të sigurojnë nëpërmjet legjislacionit dhe masave të tjera të përshtatshme zbatimin praktik të këtij parimi;
- (b) Të miratojnë masa ligjore dhe masa të tjera të përshtatshme, duke përfshirë edhe sanksione, po qe se është e nevojshme, duke ndaluar çdo formë të diskriminimit ndaj grave.

Neni 7. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe në mënyrë të veçantë u sigurojnë grave, në të njëjtat kushte me burrat, të drejtën:

- (a) Për të votuar në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike, si dhe për t'u zgjedhur në të gjitha organet e zgjedhura publikisht;
- (b) Për të marrë pjesë në hartimin e politikës së shtetit dhe në zbatimin e saj; për të mbajtur poste publike dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes;
- (c) Për të marrë pjesë në organizatat dhe shoqatat joqeveritare që merren me jetën publike dhe politike të vendit....

STANDARDET DHE DETYRIMET E KËSHILLIT TË EVROPËS

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 14 – Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe, të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Protokolli nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Neni 1 – Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe, të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore (Komisioni i Venecias, 2002)

2.5 Barazia dhe raportet mes gjinive

24. Nëse ekziston një bazë kushtetuese specifike, mund të miratohen disa rregulla që garantojnë njëfarë ekuilibri apo edhe barazi mes dy gjinive në organet e zgjedhura. Në mungesë të një baze të tillë kushtetuese, dispozita të tilla mund të konsiderohen në kundërshtim me parimin e barazisë dhe lirisë së organizimit.

25. Përveç kësaj, fusha e zbatimit të këtyre rregullave varet nga sistemi zgjedhor. Në sistemet e listave partiake fikse, respektohet parimi i paritetit nëse numri i burrave dhe grave, që kanë të drejtë për të kandiduar, është i njëjtë. Megjithatë, nëse është i mundur votimi preferencial ose votimi i kandidatëve të palës kundërshtare, zgjedhësit mund të mos zgjedhin detyrimisht kandidatë nga të dyja gjinitë dhe kjo mund të rezultojë në një përbërje të pabalancuar të organit të zgjedhur, të zgjedhur nga zgjedhësit.

SHTOJCA B BURIME TË DOBISHME SHITESË

Manuale të ODIHR-it për zgjedhjet <<https://www.osce.org/odihr/elections/handbooks>>

Fjalorth i OSBE-së për termat që lidhen me gjininë <<https://www.osce.org/files/f/documents/1/2/26397.pdf>>

Udhëzues i OSBE-së për Promovimin e Pjesëmarrjes së Grave në Partitë Politike, 2014, <<https://www.osce.org/odihr/120877>>

Barazia gjinore në postet e zgjedhura: një plan veprimi i OSBE-së me gjashtë hapa, 2011, <<https://www.osce.org/odihr/78432>>

OSBE/ODIHR - Udhëzime të Përbashkëta të Komisionit të Venecias për Rregullimin e Partive Politike <<https://www.osce.org/files/f/documents/2/b/77812.pdf>>

Legjislacioni online <<http://www.legislationline.org/>>

Përmbledhje në internet e ODIHR-it e normave dhe standardeve ndërkombëtare si dhe e legjislacioneve vendase në lidhje me dimensionin njerëzor Qendra “Carter”, Standardet Demokratike të Zgjedhjeve, <<https://eos.cartercenter.org/>>

Bashkimi Evropian, Përmbledhje e Standardeve Ndërkombëtare për Zgjedhjet <http://eeas.europa.eu/human_rights/election_observation/docs/compendium_en.pdf>

Barazia Gjinore dhe Organet e Administrimit të Zgjedhjeve:
Udhëzues i Praktikës më të Mirë, IFES, <<https://www.ifes.org/issues/gender-equality>>

Baza e të dhënave për kuotat gjinore, *International IDEA*, <<https://www.idea.int/data-tools/data/gender-quotas>>

Fito bashkë me Gratë: Ndërtimi i Partive Gjithëpërfshirëse të Shekullit 21, IKD, <<https://www.ndi.org/win-with-women-building-inclusive-21st-century-parties>>

Faqja e internetit e Rrjetit Ndërkombëtar të Njohurive të Gratë në Politikë <www.iknowpolitics.org>

Baza e të dhënave për gratë në politikë, Unioni Ndërparlamentar, <<https://www.ipu.org/our-impact/gender-equality/women-in-parliament/ipu-knowledge-hub-women-in-politics>>

Raporti i UNP-së për Gratë në Parlament: 1995 – 2020 – 25 vjet në shqyrtim, <<https://www.ipu.org/resources/publications/reports/2020-03/women-in-parliament-1995-2020-25-years-në-shqyrtim>>

UN Women, Entiteti i OKB-së për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave, <<https://www.unwomen.org/en>>

Dokument i IFES-ë mbi financat politike dhe barazinë gjinore, <https://www.ifes.org/sites/default/files/political_finance_and_gender_equality.pdf>

Raporti i përbashkët i UNP-së dhe AP-së së KiE-s mbi seksizmin, ngacmimin dhe dhunën ndaj grave në parlamentet në Evropë, <<https://www.ipu.org/resources/publications/issue-briefs/2018-10/sexism-harassment-and-violence-against-women-in-parliaments-in-europe>>

IFES, “Dhuna ndaj grave në zgjedhje” <<https://www.ifes.org/VAWE>>

IKD, “Vota pa dhunë: vëzhgimi çështjeve gjinore dhe dhuna zgjedhore”, <https://www.ndi.org/sites/default/files/Violence_Against_Women_in_Elections_Overview.pdf>

UN Women, “Parandalimi i dhunës ndaj grave në zgjedhje”, Udhëzues për programimin <<https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2017/11/preventing-violence-against-women-in-elections>>

Udhëzues i OSBE/ODIHR-it për Promovimin e Pjesëmarrjes Politike të Personave me Aftësi të Kufizuara <<https://www.osce.org/odihr/414344>>

PIKAT KRYESORE PËR VËZHGIMIN E PJESËMARRJES SË GRAVE NË ZGJEDHJE NGA VËZHGUESIT E OSBE/ODIHR-IT

“Të ndalohet çdo diskriminim dhe t’u garantohet të gjithë njerëzve mbrojtje e barabartë dhe efikase nga diskriminimi për çfarëdolloj shkak”.

Në KEDNG shteteve palë u kërkohet që **“të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit”**. Në të identifikohen nevojat për masa të veçanta të përkohshme për të përshpejtuar arritjen e barazisë, të cilat nuk duhet të konsiderohen si diskriminim, dhe theksohet se të drejtat duhet të gëzohen si *de jure* ashtu edhe *de facto*.

Përveç kësaj, organizmat shtetërore duhet të marrin në konsideratë pikëpamjet e grupeve përfaqësuese të grave dhe duhet të ketë barazi të përfaqësimit të grave në hartimin e politikës së shtetit. Qeveritë duhet të raportojnë të dhëna statistikore që tregojnë përqindjen e grave, në raport me burrat, që gëzojnë të drejta politike dhe duhet t’i inkurajojnë partitë politike që të marrin masa efikase për të promovuar pjesëmarrjen e grave.

Në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, të vitit 2011, mbi Gratë dhe Pjesëmarrjen Politike u bëhet thirrje shteteve që **“të shqyrtojnë ndikimin e ndryshëm që kanë sistemet e tyre zgjedhore në pjesëmarrjen politike të grave dhe në përfaqësimin e tyre në organet e zgjedhura dhe t’i përshtatin ose t’i reformojnë ato sisteme, sipas rastit”**.

OZHQ 5 për barazinë gjinore i referohet **“pjesëmarrjes së plotë dhe efikase të grave dhe mundësive të barabarta për të luajtur role drejtuese në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike”**. OZHQ 16 për paqen, drejtësinë dhe institucionet e forta përfshin një tregues të vendimmarrjes reaguese, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet.

Dhuna ndaj grave në zgjedhje përfshin akte ose kërcënime për dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike. Përveç kompromentimit të së drejtës së individëve për të marrë pjesë, kjo mund të ketë një efekt shtrembërues në procesin demokratik në përgjithësi. Kanosja përmes internetit mund të ndikojë në mënyrë shpërpjesëtimore tek gratë.

